



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË



Viti: 2024 – Numri: 196

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Tiranë – E mërkurë, 20 nëntor 2024

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 706, datë 13.11.2024	Për rishpërndarje fondesh në buxhetin e miratuar për vitin 2024, ndërmjet Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe Ministrisë së Drejtësisë..... 21289
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 707, datë 13.11.2024	Për kushtet e posaçme, dokumentacionin shoqërues, procedurën, afatet për dhënien e autorizimit, si dhe për mënyrën e kriteret e ndarjes së kuotave vjetore të importit të hidrofluorokarboneve dhe/ose pajisjeve të parambushura me hidrofluorokarbone..... 21289
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 708, datë 13.11.2024	Për përcaktimin e skemës së certifikimit dhe të kërkesave për procesin e certifikimit të personit, që ushtron veprimtarinë me pajisje, që përmbajnë gaze serrë të fluoruara..... 21294
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Brendshëm dhe i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 1, datë 7.11.2024	Për mënyrën e bashkëpunimit mes Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile për çregjistrimin e shtetasve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në listën e zgjedhësve brenda vendit..... 21305
Udhëzim i përbashkët i ministrit të Brendshëm dhe i ministrit të Financave nr. 221, datë 8.11.2024	Për masën, kriteret dhe procedurat për tarifat financiare për veprimtarinë e lejuar me armët..... 21307
Udhëzim i ministrit të Brendshëm nr. 225, datë 12.11.2024	Për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin e ministrit të Brendshëm nr. 64, datë 12.5.2022, “Për përcaktimin e kriterëve të veçanta të dhënies së certifikatës për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit privat në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” 21309
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 255, datë 5.11.2024	Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e parashikimeve, për pajisjet e avionëve të kërkuar, për përdorimin e hapësirës ajrore të Qiellit të Vetëm Evropian dhe rregullat e operimit, në lidhje me përdorimin e hapësirës ajrore të Qiellit të Vetëm Evropian” 21317
Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 281, datë 11.11.2024	Për miratimin e rregullores “Për njësitë e matjes që përdoren në operimet në tokë dhe ajër” 21322

Urdhër i ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë nr. 282, datë 11.11.2024	Për disa shtesa në urdhrin e ministrit nr. 170, datë 13.9.2022, “Për miratimin e rregullores për përcaktimin e kërkesave dhe procedurave administrative, që lidhen me aerodromet në Republikën e Shqipërisë”	21343
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 24.10.2024	Çështja Shkjezi kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 82151/17</i>)	21345
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 24.10.2024	Çështja Kleoniqi Sovjani kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 42684/15</i>)	21347
Vendim i Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut datë 24.10.2024	Çështja Nikoll Dobrozi kundër Shqipërisë (<i>kërkesa nr. 41592/14</i>)	21349



VENDIM

Nr. 706, datë 13.11.2024

**PËR RISHPËRNDARJE FONDESH NË
BUXHETIN E MIRATUAR PËR VITIN
2024, NDËRMJET KOMISIONIT TË
PAVARUR TË KUALIFIKIMIT DHE
MINISTRISË SË DREJTËSISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 44, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 97/2023, “Për buxhetin e vitit 2024”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2024 bëhet rishpërndarja e fondeve, si më poshtë vijon:

a) Ministrisë së Drejtësisë i shtohet fondi prej 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekësh, në programin buxhetor “Planifikimi, menaxhimi dhe administrimi” (01110), artikulli 602, i cili do të përdoret nga Arkivi Shtetëror i Sistemit të Drejtësisë për arkivimin e dokumentacionit të rivlerësimit kalimtar të magjistratëve;

b) Komisionit të Pavarur të Kualifikimit i pakësohet fondi prej 15 000 000 (pesëmbëdhjetë milionë) lekësh, në programin buxhetor 03330, artikulli 602.

2. Ngarkohen Ministria e Drejtësisë, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYEMINISTËR
Edi Rama**

VENDIM

Nr. 707, datë 13.11.2024

**PËR KUSHTET E POSAÇME,
DOKUMENTACIONIN SHOQËRUES,
PROCEDURËN, AFATET PËR DHËNIEN
E AUTORIZIMIT, SI DHE PËR
MËNYRËN E KRITERET E NDARJES SË
KUOTAVE VJETORE TË IMPORTIT TË
HIDROFLUOROKARBONEVE DHE/OSE
PAJISJEVE TË PARAMBUSHURA ME
HIDROFLUOROKARBONE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 2 e 3, të nenit 20, të ligjit nr. 2/2023, “Për gazet serrë të fluoruara”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton:

a) kushtet e posaçme, dokumentacionin shoqërues, procedurën, afatet për dhënie e autorizimit të ndarjes së kuotës vjetore të importit të hidrofluorokarboneve dhe/ose pajisjeve të parambushura me hidrofluorokarbone, sipas përcaktimeve në kreun II, të këtij vendimi;

b) mënyrën e ndarjes së kuotave vjetore të importit të hidrofluorokarboneve dhe/ose pajisjeve të parambushura me hidrofluorokarbone, si dhe kriteret për ndarjen e tyre, sipas përcaktimeve në kreun III, të këtij vendimi.

2. Përveç përkufizimeve të dhëna në ligjin në fuqi për gazet serrë të fluoruara dhe në legjislacionin në fuqi për akreditimin, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) **“Sipërmarrës i vjetër”**, çdo person fizik/tregtar ose juridik, i regjistruar në regjistrin tregtar, që ka një historik të vendosjes në treg të gazeve të fluoruara, për një periudhë kohore 3 (tre) ose më shumë vjet;

b) **“Sipërmarrës i ri”**, çdo person fizik/tregtar ose juridik, i regjistruar në regjistrin tregtar, që hyn në treg për herë të parë ose që ka filluar të vendosë në treg gaze të fluoruara, për një periudhë kohore më pak se 3 (tre) vjet;

c) **“Vite bazë”** ka kuptimin e një periudhe specifike, që përdoret nga institucioni përgjegjës për mjedisin për të llogaritur dhe për të përcaktuar



aktivitetin historik në treg të sipërmarrësit. Të dhënat e këtyre viteve përdoren si bazë për ndarjen e kuotave për vitet e ardhshme;

ç) **“Kuotë rezervë”** i referohet një pjese të kuotës totale të disponueshme, që është lënë rezervë nga institucioni përgjegjës për mjedisin, për qëllime specifike, të tilla, si importi i pajisjeve që përmbajnë gaze të fluoruara ose për menaxhimin e një rritjeje të papritur të kërkesës.

II. KUSHTET E POSAÇME, DOKUMENTACIONI SHOQËRUES, PROCEDURA, AFATET PËR DHËNIEN E AUTORIZIMIT PËR NDARJEN E KUOTËS VJETORE TË IMPORTIT TË HIDROFLUOROKARBONEVE DHE/OSE PAJISJEVE TË PARAMBUSHURA ME HIDROFLUOROKARBONE

1. Kushtet e posaçme, që plotëson sipërmarrësi për marrjen e autorizimit për kuotën vjetore të importit të hidrofluorokarboneve dhe/ose pajisjeve të parambushura me hidrofluorokarbone janë, si më poshtë vijon:

a) të jetë person fizik/tregtar ose juridik, i regjistruar në regjistrin tregtar;

b) të jetë i pajisur me licencë për import, eksport, magazinim të gazeve serrë të fluoruara, të pajisjeve që përmbajnë gaze serrë të fluoruara ose funksionimi i të cilave mbështetet në këto gaze.

2. Pas plotësimit të kushteve, sipas pikës 1, sipërmarrësi aplikon në portalin unik qeveritar “*e-Albania*” dhe plotëson elektronikisht formularin e aplikimit për pajisjen me kuotë për importin e hidrofluorokarboneve dhe/ose pajisjeve të parambushura me hidrofluorokarbone, sipas shtojcës I, që i bashkëlidhet këtij vendimi, duke specifikuar:

a) numrin unik të identifikimit të subjektit (NUIS);

b) numrin e identifikimit të licencës përkatëse;

c) të dhënat e importit për vitet bazë, nëse ka eksperiencë të mëparshme;

ç) raportet për importet e realizuara vitin e fundit, shoqëruar me deklaratat doganore, nëse ka kryer import.

3. Periudha për depozitimin e kërkesave për pajisje me kuotë është nga data 1 shtator deri në datën 30 nëntor të çdo viti, për importe që do të kryhen në vitin pasardhës.

4. Struktura përgjegjëse për gazet serrë të fluoruara në ministri është përgjegjëse për shqyrtimin e aplikimit, sigurimin e dokumentacionit

sipas pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, dhe kthimin e përgjigjes me nënshkrim elektronik.

5. Procedura për vlerësimin dhe miratimin e kërkesës për pajisje me autorizim për ndarjen e kuotës vjetore të importit të hidrofluorokarboneve dhe/ose pajisjeve të parambushura me hidrofluorokarbone është, si më poshtë vijon:

a) Struktura përgjegjëse për gazet serrë të fluoruara në ministri, brenda 5 (pesë) ditëve nga data e administrimit të kërkesës, shqyrton dhe verifikon kërkesën dhe, në rast se konstaton pasaktësi apo mosplotësim, sipas formatit të kërkuar, ministria njofton sipërmarrësin përmes portalit unik qeveritar “*e-Albania*”, duke kërkuar plotësimin e të metave të konstatuara brenda 7 (shtatë) ditëve;

b) Mosplotësimi i të metave brenda afatit të parashikuar në shkronjën “a” përbën shkak për mospranimin e kërkesës. Ministria njofton aplikuesin përmes portalit unik qeveritar “*e-Albania*” për arsyet e refuzimit, si dhe për të drejtën e ankimit brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së njoftimit;

c) Në rast se kërkesa dhe dokumentacioni i siguruar nga struktura përgjegjëse, sipas pikës 4, të këtij kreu, janë të plota, struktura përgjegjëse për gazet serrë të fluoruara në ministri, në bashkëpunim me Njësinë Kombëtare të Ozonit, nga data 1 dhjetor deri në datën 20 dhjetor, i propozon ministrit ndarjen e kuotës vjetore të importit të hidrofluorokarboneve dhe/ose pajisjeve të parambushura me hidrofluorokarbone;

ç) Ministri, brenda datës 31 dhjetor, miraton ndarjen e kuotës dhe lëshon autorizimet për importin e hidrofluorokarboneve dhe/ose pajisjeve të parambushura me hidrofluorokarbone, për vitin pasardhës;

d) Në rast se kërkesat për pajisje me kuotë janë më pak se vlera e kuotës vjetore të lejuar, ministria hap fazën e dytë për pajisje me autorizim për ndarjen e pjesës së mbetur të kuotës vjetore të importit të hidrofluorokarboneve dhe/ose pajisjeve të parambushura me hidrofluorokarbone, si dhe/ose kuotës vjetore rezervë dhe ndiqet e njëjta procedurë për aplikim, sipas këtij kreu;

dh) Autorizimi për ndarjen e kuotës vjetore është i vlefshëm vetëm për vitin kalendarik, për të cilin është dhënë.



III. MËNYRA DHE KRITERET E NDARJES SË KUOTAVE VJETORE TË IMPORTIT TË HIDROFLUOROKARBONEVE DHE/OSE PAJISJEVE TË PARAMBUSHURA ME HIDROFLUOROKARBONE

1. Kuota vjetore bazohet në sasinë maksimale të lejuar për vendosjen në treg të hidrofluorokarboneve në Republikën e Shqipërisë, sipas tabelës nr. 1, të pjesës A, të shtojcës II, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe ndahet, si më poshtë vijon:

a) 80% e kuotës vjetore totale për sipërmarrësit e vjetër;

b) 10% e kuotës vjetore totale për sipërmarrësit e rinj;

c) 10% e kuotës totale vjetore, si kuotë rezervë.

2. Mënyra e ndarjes së kuotës për çdo sipërmarrës përcaktohet sipas pjesës B, të shtojcës II, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe në asnjë rast, kuota e plotë e importit nuk i ndahet një sipërmarrësi të vetëm.

3. Kuota vjetore e importit përdoret vetëm për vitin kalendarik, për të cilin është lëshuar autorizimi.

4. Pajisjet nuk do të vendosen në treg, në rast se gazet HFC, me të cilat ato janë mbushur, nuk janë llogaritur si pjesë e kuotës vjetore, me përjashtim të parashikimeve sipas pikës 3, të nenit 15, të ligjit nr. 2/2023, “Për gazet serrë të fluoruara”.

5. Çdo sipërmarrës, i cili është pajisur me kuota vjetore, mund të transferojë plotësisht apo pjesërisht kuotën e tij në një tjetër sipërmarrës në Shqipëri, i cili përmbush të njëjtat kritere, vetëm pas miratimit të ministrit përgjegjës për mjedisin.

6. Kërkesa për transferimin e kuotës depozitohet elektronikisht në portalin unik qeveritar “e-Albania”, së bashku me marrëveshjen kontraktuale ndërmjet palëve. Procedura për shqyrtimin e aplikimit është e njëjtë me atë të përcaktuar në kreun II, të këtij vendimi. Kuota që transferohet nuk lejohet të transferohet për herë të dytë.

7. Për ndarjen e kuotës vjetore të importit, ministria mbështetet në:

a) raportimin nga sipërmarrësi për sasitë e importuara, sipas parashikimeve të ligjit nr. 2/2023, “Për gazet serrë të fluoruara”;

b) deklarimin doganor për çdo sasi të importuar.

IV. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Procedurat e aplikimit për pajisjen me autorizim për ndarjen e kuotës vjetore të importit të hidrofluorokarboneve dhe/ose pajisjeve të parambushura me hidrofluorokarbone, nëpërmjet portalit unik qeveritar “e-Albania”, si dhe procedura e shqyrtimit të kërkesave për kuota vjetore importi zbatohet në momentin që sistemi i integruar mjedisor do të implementohet dhe do të jetë funksional. Deri në funksionimin e tij, dorëzimi i kërkesës dhe dokumentacionit përkatës, që vërteton përmbushjen e parashikimeve, sipas shkronjave “c” dhe “ç”, të pikës 2, të kreut II, të këtij vendimi, si dhe tërheqja e autorizimit bëhen në ministrinë përgjegjëse për mjedisin, sipas procedurës së parashikuar në këtë vendim.

2. Për vitin aktual, periudha për depozitimin e kërkesave është 20 (njëzet) ditë nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

3. Zbatimi i pikës 6, të kreut III, të këtij vendimi, fillon 3 (tre) vjet nga data e hyrjes në fuqi të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Njësia Kombëtare e Ozonit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR

Edi Rama

SHTOJCA I

Formulari i aplikimit për pajisjen me autorizimin për ndarjen e kuotës vjetore të importit të hidrofluorokarboneve

Seksioni 1: Informacioni i kompanisë

1. Emri i kompanisë:

- Emri i plotë ligjor: _____

2. Adresa e kompanisë:

- Adresa e rrugës: _____

- Qyteti: _____



- Kodi postar: _____
 - Shteti: _____

3. Numri i regjistrimit të kompanisë:

- NUIS: _____

4. Personi i kontaktit:

- Emri: _____
 - Pozicioni: _____
 - Numri i telefonit: _____
 - Adresa e email-it: _____

Seksioni 2: Të dhënat e importit

Përdorimi historik (3 vitet e fundit):

- Viti 1 (20__): _____
 - Sasia e importuar (në ton CO₂ ekuivalent): _____
 - Viti 2 (20__) _____
 - Sasia e importuar (në ton CO₂ ekuivalent): _____
 - Viti 3 (20__) _____
 - Sasia e importuar (në ton CO₂ ekuivalent): _____
 - Viti aktual (gjendja në magazinë)
 - Sasia e importuar (në ton CO₂ ekuivalent): _____
 - Sasia gjendje (në ton CO₂ ekuivalent): _____

Seksioni 3: Deklarata

Deklaroj se informacioni i dhënë në këtë aplikim është i vërtetë dhe i saktë. E kuptoj që dhënia e informacionit të rremë ose të gabuar mund të rezultojë në pezullimin e kuotës së alokuar dhe/ose në masa të tjera ndëshkuese.

- Emri i personit të autorizuar: _____
 - Pozicioni: _____
 - Nënshkrimi: _____
 - Data: _____

SHTOJCA II

Pjesa A

Sasia maksimale e lejuar e vendosjes në treg të hidrofluorokarboneve në Republikën e Shqipërisë, sipas Amendamentit të Kigalit.

Tabela 1. Sasia maksimale e hidrofluorokarbureve, që lejohet të vendoset në tregun e Republikës së Shqipërisë në një vit të caktuar është, si më poshtë vijon:

Vitet	Sasia maksimale në ton ekuivalent CO ₂
2024–2028	883,849 çdo vit
2029	795,464 (reduktuar 10%)
2030–2034	795,464 çdo vit
2035	618,694 (reduktuar 30%)
2036–2039	618,694 çdo vit
2040	441,924 (reduktuar 50%)
2041–2044	441,924 çdo vit
2045	176,770 (reduktuar 80%)



Pjesa B. Mënyra e përlllogaritjes së kuotave për çdo sipërmarrës.

1.

- Për të përcaktuar kuotën e vitit 2024, 2025, 2026 do të merren në konsideratë importet e kryera gjatë viteve 2020–2022;

- Për të përcaktuar kuotën e vitit 2027, 2028, 2029 do të merren në konsideratë importet e kryera gjatë viteve 2024–2026.

2. Përcaktimi i vlerave të referencës dhe shpërndarjes së kuotave për vendosjen në treg të hidrofluorokarbureve llogaritet, si më poshtë vijon:

Për sipërmarrësit e vjetër do të ndahet 80% e kuotës vjetore:

a) të paktën çdo 3 vjet ministria përgjegjëse për mjedisin, në bashkëpunim me Njësinë Kombëtare të Ozonit, do të përcaktojë vlerat e referencës për importuesit për vendosjen në treg të hidrofluorokarbureve;

b) vlerat referencë për të gjithë importuesit përcaktohen bazuar në importet e hidrofluorkarboneve gjatë 3 viteve të mëparshme.

Për të llogaritur vlerën e referencës për vendosjen e hidrofluorokarbureve (HFC) në treg bazuar në mesataren vjetore të sasive të vendosura ligjërisht në treg gjatë 3 viteve, të përcaktuara si vlerë bazë, do të përdoret formula e mëposhtme:

$$VR = \frac{(Q1+Q2+Q3)}{3}$$

Ku:

VR = Vlera e referencës për vendosjen e HFC-ve në treg (në ton ekuivalent CO₂);

Q1, Q2, Q3 = Sasitë e hidrofluorokarbureve të vendosura në mënyrë të ligjshme në treg gjatë 3 viteve, të përcaktuara si vitet bazë (në ton ekuivalent CO₂).

Mekanizmi i alokimit

Përcaktimi i kuotës që do t'u ndahet sipërmarrësve për të cilët janë përcaktuar vlerat e referencës llogaritet, si më poshtë vijon:

$$K = \left(\frac{VR}{VRt} \times \text{sasia maksimale} \times 0.8 \right)$$

Ku:

K = Kuota e alokuar për sipërmarrësin (në ton ekuivalent CO₂);

VR = Vlera referencë e sipërmarrësit (në ton ekuivalent CO₂);

VRt = Shuma e vlerave të referencës të të gjithë sipërmarrësve.

Sasia maksimale = Sasia maksimale e HFC-ve të alokuara për vitin (në ton ekuivalent CO₂).

b) 10% e kuotës do t'u ndahet sipërmarrësve të rinj:

10% e kuotës vjetore prej në ton ekuivalent CO₂ do të shpërndahet në mënyrë të barabartë midis sipërmarrësve, që kanë paraqitur kërkesë për t'u pajisur me kuotë.



VENDIM

Nr. 708, datë 13.11.2024

**PËR PËRCAKTIMIN E SKEMËS SË
CERTIFIKIMIT DHE TË KËRKESAVE
PËR PROCESIN E CERTIFIKIMIT
TË PERSONIT, QË USHTRON
VEPRIMTARINË ME PAJISJE,
QË PËRMBAJNË GAZE SERRË
TË FLUORUARA¹**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr. 2/2023, “Për gazet serrë të fluoruara”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim ka si objekt përcaktimin e skemës së certifikimit për personat që ushtrojnë veprimtarinë me pajisje, që përmbajnë gaze serrë të fluoruara, si dhe të kërkesave për certifikimin e tyre.

2. I nënshtrohen procesit të certifikimit personat, që ushtrojnë veprimtaritë e mëposhtme:

a) testimin e rrjedhjeve të pajisjeve, që përmbajnë gaze serrë të fluoruara në sasi të barabarta ose më të mëdha se 5 (pesë) tonë ekuivalentë CO₂, përveç rasteve kur pajisja është e mbyllur hermetikisht (e etiketuar si e tillë) e që përmban gaze serrë të fluoruara në sasi më pak se 10 tonë CO₂ ekuivalentë;

b) rikuperimin;

c) instalimin;

ç) riparimin, mirëmbajtjen ose shërbimin;

d) çmontimin.

3. Veprimtaritë e përcaktuara në pikën 2, të kreut I, ushtrohen në:

a) dhomat frigoriferike të kamionëve dhe të rimorkiove frigoriferike, pajisjet e palëvizshme ftohëse, pajisjet e palëvizshme të ajrit të kondicionuar dhe pompave të palëvizshme të nxehtësisë, që përmbajnë gaze serrë të fluoruara;

b) pajisjet e mbrojtjes nga zjarri, që përmbajnë gaze serrë të fluoruara;

c) kutitë elektrike të shpejtësisë (*electric switchgear*), që përmbajnë gaze serrë të fluoruara;

ç) pajisjet stacionare të tretësve (solventëve) të bazuar në gazet serrë të fluoruara.

4. Përveç përkufizimeve të dhëna në ligjin në fuqi për gazet serrë të fluoruara dhe në legjislacionin në fuqi për akreditimin, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “**Skema e certifikimit**”, tërësia e rregullave dhe e proceseve në lidhje me certifikimin e personit, tek i cili zbatohen të njëjtat kërkesa;

b) “**Organi për certifikimin e personit**”, organi i vlerësimit të konformitetit, i akredituar sipas legjislacionit në fuqi për akreditimin, në përputhje me standardin ISO/IEC 17024;

c) “**Certifikimi i personit**”, procesi, në të cilin një individ u nënshtrohet vlerësimit dhe verifikimit nga një organ certifikues i akredituar, për të vërtetuar se ai ka aftësitë, njohuritë dhe kompetencat e nevojshme për të kryer veprimtaritë, sipas pikës 2, të kreut I, të këtij vendimi.

**II. SKEMA E CERTIFIKIMIT DHE
KËRKESAT PËR PROCESIN E CERTIFI-
KIMIT TË PERSONIT**

1. Certifikata, që vërteton përshtatshmërinë e personit për të kryer një ose më shumë nga veprimtaritë e parashikuara, sipas pikës 2, të kreut I, u lëshohet personave sipas kategorive të mëposhtme:

a) personi i certifikuar sipas kategorisë I ka të drejtë të kryejë të gjitha veprimtaritë e përcaktuara në pikën 2, të kreut I, të këtij vendimi;

b) personi i certifikuar sipas kategorisë II ka të drejtë të kryejë:

i. veprimtarinë e përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 2, të kreut I, të këtij vendimi, me kushtin që të mos kryejë ndërhyrje në qarqet ftohëse, që përmbajnë gaze serrë të fluoruara;

ii. veprimtaritë e përcaktuara në shkronjat “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të pikës 2, të kreut I, të këtij vendimi, në pajisjet e përmendura në pikën 3, të

¹ Ky vendim përafron pjesërisht rregulloren e zbatimit të Komisionit (BE) 2015/2067, datë 17 nëntor 2015, që përcakton, në përputhje me rregulloren (BE) nr. 517/2014, të Parlamentit Evropian dhe Këshillit, kërkesat minimale dhe kushtet për njohjen reciproke për certifikimin e personat në lidhje me pajisjet e ftohjes të palëvizshme, të ajrit të kondicionuar dhe të pompës së nxehtësisë, si dhe Faqe | 21294

njësitë ftohëse të kamionëve frigoriferikë dhe rimorkiove, që përmbajnë gaze serrë të fluoruar dhe për certifikimin e kompanive, në lidhje me pajisjet ftohëse të palëvizshme, klimatizimin dhe pompat e nxehtësisë, që përmbajnë gaze serrë të fluoruar. CELEX nr. 32015R2067.



kreut I, të këtij vendimi, të cilat përmbajnë më pak se 3 (tri) kg gaze serrë të fluoruara, ose, në rastin e sistemeve të mbyllura hermetikisht të etiketuara si të tilla, që përmbajnë më pak se 6 (gjashtë) kg gaz serrë të fluoruar;

c) personi i certifikuar sipas kategorisë III ka të drejtë të kryejë veprimtarinë sipas shkronjës “b”, të pikës 2, të kreut 1, të këtij vendimi, që kryhet në pajisjet e përcaktuara në pikën 3, të kreut I, të këtij vendimi, dhe që përmbajnë më pak se 3 (tre) kg gaze serrë të fluoruara ose, në rastin e sistemeve të mbyllura hermetikisht të etiketuara si të tilla, që përmbajnë më pak se 6 (gjashtë) kg gaze serrë të fluoruara;

ç) personi i certifikuar sipas kategorisë IV ka të drejtë të kryejë veprimtarinë, sipas shkronjës “a”, të pikës 2, të kreut I, të këtij vendimi, me kushtin që ai të mos kryejë ndërhyrje në qarqet ftohëse, që përmbajnë gaze serrë të fluoruara.

2. Një person, edhe nëse nuk është i pajisur me certifikatën përkatëse, ka të drejtë të kryejë, për një periudhë jo më shumë se 24 (njëzet e katër) muaj, një nga veprimtaritë e pikës 2, të kreut I, të këtij vendimi, nëse plotëson kushtet e mëposhtme:

a) të jetë i regjistruar në një kurs trajnimi për marrjen e një certifikate, që mbulon veprimtarinë përkatëse; dhe

b) të ushtrojë veprimtarinë nën mbikëqyrjen e një personi, i cili është i pajisur me certifikatën, që mbulon atë veprimtari, dhe mban përgjegjësi për ushtrimin e veprimtarisë.

3. Çdo person, që kërkon të certifikohet për kryerjen e veprimtarive për operimin e funksionimin teknik të pajisjeve, që përmbajnë gaze serrë të fluoruara ose funksionimi i të cilave mbështetet në këto gaze, plotëson kërkesat, si më poshtë vijon:

a) të ketë përfunduar të paktën studimet e arsimit të mesëm të lartë;

b) të ketë të paktën 2 (dy) vjet eksperiencë në punë me pajisje, që përmbajnë gaze serrë të fluoruara ose funksionimi i të cilave mbështetet në këto gaze, në veprimtaritë e parashikuara në pikën 2, të kreut I, të këtij vendimi;

c) të ketë kryer programin e trajnimeve, sipas parashikimeve të këtij vendimi;

ç) të jetë kualifikuar në testimin e kryer, sipas nënplikës 6.2, të kreut II, të këtij vendimi.

3.1. Aplikanti, nëse plotëson kërkesat e përcaktuara sipas pikës 3, të këtij kreu, paraqet

fizikisht, pranë organit certifikues, dokumentacionin e mëposhtëm për certifikim:

a) kërkesën për certifikimin për kategorinë përkatëse, sipas shtojcës II, bashkëlidhur këtij vendimi;

b) dokumentin e identifikimit;

c) të paktën diplomën e arsimit të mesëm të lartë;

ç) librezën e punës;

d) certifikatën e lëshuar nga organi, që vërteton ndjekjen e programit të trajnimit, në përputhje me kërkesat e këtij vendimi.

4. Personi që do të certifikohet kryen fillimisht trajnimin pranë një subjekti të licencuar, në përputhje me legjislacionin për arsimin dhe formimin profesional për modulën përkatës.

4.1 Kërkesat minimale për programet e trajnimit specifikojnë për secilin lloj të pajisjeve aftësitë dhe njohuritë e nevojshme praktike e teorike. Programet e trajnimit për personat, që kërkojnë të certifikohen për kryerjen e veprimtarive me gazet serrë të fluoruara përfshijnë:

a) rregulloret e aplikueshme dhe standardet teknike;

b) njohuritë për parandalimin e shkarkimeve;

c) njohuritë për rikuperimin e gazeve serrë të fluoruara;

ç) trajtimin e sigurt të pajisjeve të llojit e të madhësisë së përfshirë në certifikatë;

d) informacion për teknologjitë përkatëse për të zëvendësuar ose për të zvogëluar përdorimin e gazeve serrë të fluoruara dhe trajtimin e tyre të sigurt.

4.2 Subjekti i licencuar, për të ofruar trajnimin, pas përfundimit të kryerjes së programit të trajnimit, pajis personin me certifikatën, që vërteton ndjekjen e programit të trajnimit për marrjen e njohurive dhe të aftësive për kategorinë e certifikimit, për të cilën personi kërkon të certifikohet.

5. Programet e trajnimit hartohen në bazë të kërkesave minimale të njohurive dhe aftësive për skemën e certifikimit, të përcaktuar në modulet përkatëse I, II, III dhe IV, si më poshtë vijon:

a) Moduli I: Kërkesat minimale të trajnimit për qarqet ftohëse të frigoriferëve të palëvizshëm, të pajisjeve stacionare me ajër të kondicionuar dhe pajisjeve stacionare të pompave të nxehtësisë të mbushura me gaze serrë të fluoruara;

b) Moduli II: Kërkesat minimale të trajnimit për pajisjet e palëvizshme për mbrojtjen nga zjarri dhe fikësit e zjarrit të mbushura me gaze serrë të fluoruara;



c) Moduli III: Kërkesat minimale të trajnimit për rutinë elektrike të shpejtësisë;

ç) Moduli IV: Kërkesat minimale të trajnimit për pajisjet e palëvizshme, që përmbajnë tretës me bazë gaze serrë të fluoruara.

5.1. Përmbajtja e programeve të trajnimit I, II, III dhe IV përcaktohet në shtojcën II, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6. Për qëllime të certifikimit të personit, organi certifikues organizon kryerjen e testimit, sipas kërkesave të standardit ISO/IEC 17024.

6.1. Organi certifikues njofton datën, kohën dhe vendin e kryerjes së testimit, nëpërmjet publikimit të njoftimit në *website*-in e organit certifikues ose komunikimit të drejtpërdrejtë të kandidatëve nëpërmjet postës elektronike/fizike.

6.2. Testimi për secilën kategori certifikimi përfshin:

a) një testim teorik me shkrim, që përmban pyetje lidhur me njohuritë sipas skemës përkatëse të certifikimit, të përcaktuara në modulet e parashikuara në shtojcën II, që i bashkëlidhet këtij vendimi;

b) një testim praktik, ku personi do të kryejë detyrën përkatëse për materialet, mjetet dhe pajisjet përkatëse, të hartuar në bazë të aftësive dhe njohurive të marra për skemat përkatëse të certifikimit, të përcaktuara në modulet e parashikuara në shtojcën II, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6.2.1. Kandidati vlerësohet se ka kaluar testimin për person të certifikuar, nëse ka siguruar më shumë se një minimum prej 60 (gjashtëdhjetë) % të pikëve maksimale në secilin nga testimet e përcaktuara në këtë pikë. Kandidati, që nuk siguron minimumi 60 (gjashtëdhjetë) % të pikëve në testimin me shkrim, nuk ka të drejtë t'i nënshtrohet testimit praktik.

6.2.2. Pas përfundimit të testimit, organi certifikues lëshon një vërtetim për rezultatin e testimit brenda 7 (shtatë) ditëve nga data e kryerjes së testimit, sipas formatit të përcaktuar në shtojcën III, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

6.2.3. Në rast se kandidati ka siguruar më shumë se një minimum prej 60 (gjashtëdhjetë) % të pikëve maksimale në secilin nga testimet e përcaktuara në nënpikën 6.2.1, pajiset nga organi certifikues me certifikatë personi, sipas formatit të përcaktuar në shtojcën V, të këtij vendimi, të shoqëruar edhe me kartën përkatëse, e cila shërben si dokument identifikues i personit të pajisur me certifikatë.

III. VLEFSHMËRIA E CERTIFIKATËS

1. Afati i vlefshmërisë së certifikatës së personit të certifikuar është 10 (dhjetë) vjet nga data e regjistrimit të personit në regjistrin e personave të certifikuar të ministrisë përgjegjëse për mjedisin.

1.1. Pas regjistrimit në regjistrin e organit certifikues, personit të certifikuar i lëshohet karta e personit të certifikuar nga organi certifikues, sipas formatit të përcaktuar në shtojcën VI, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

1.2. Në rastin e humbjes ose të dëmtimit të “Certifikatës së personit të certifikuar” ose të kartës së personit të certifikuar, me kërkesën e tij, organi certifikues lëshon një dublikatë të certifikatës ose të kartës së personit të certifikuar.

1.3. Ministria përgjegjëse për mjedisin i njeh certifikatën personit të certifikuar nga një organ certifikues personi, i regjistruar si subjekt ligjor në një shtet tjetër dhe i akredituar nga një organizëm akreditues i atij shteti, në përputhje me pikën 1, të kreut II, të këtij vendimi. Certifikata dhe modulet dorëzohen pranë ministrisë përgjegjëse të përkthyer dhe të noterizuara në gjuhën shqipe.

2. Personat e certifikuar ricertifikohen nga organi certifikues pas kalimit të afatit 10-vjeçar. Procesi përfshin në mënyrë të përshtatshme edhe elementet e certifikimit fillestar.

2.1. Rinovimi i certifikatës kryhet nga organi certifikues vetëm nëse personi i certifikuar paraqet pranë saj certifikatën e trajnimit, që vërteton rifreskimin e njohurive, në trajnime të ndryshme të së njëjtës tematikë, të organizuara nga institucione ndërkombëtare të njohura nga organi certifikues, si dhe nga institucione të arsimit të lartë, që ofrojnë programe studimi të formimit të vazhduar në fushën e gazeve serrë të fluoruara, në përputhje me ligjin nr. 80/2015, “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”.

3. Në rastet kur aftësitë nuk janë ushtruar për më shumë se 2 (dy) vjet, personi i certifikuar kryen trajnim përditësues para se të lejohet të ushtrojë aftësitë e njohura me certifikatën e personit.

3.1. Në rastin e shfuqizimit të “Certifikatës së personit të certifikuar”, emri i tij hiqet nga Regjistri i Personave të Certifikuar dhe personi nuk ka të drejtë të kryejë veprime për operimin e funksionimin teknik të pajisjeve, që përmbajnë gaze serrë të fluoruara ose funksionimi i të cilave mbështetet në këto gaze.



IV. PUBLIKIMI

1. Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit publikon në faqen zyrtare listën e organeve certifikuese, që ofrojnë skemën e certifikimit.

1.1 Organet certifikuese njoftojnë ministrinë përgjegjëse për mjedisin për personat e certifikuar dhe njoftimi bëhet sipas formatit në shtojcën IV, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

1. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

SHTOJCA I
FORMULARI I APLIKIMIT PËR CERTIFIKIMIN E PERSONIT

- Testi për të cilin aplikoni: Person i certifikuar
- Kandidati: I sponsorizuar nga kompania I vetësponsorizuar
- Emri i aplikuesit: _____
- Emri i babait: _____
- Adresa aktuale e aplikuesit: rruga/qyteti/ kodi postar _____
- Adresa e përhershme e aplikuesit: rruga/qyteti/ kodi postar ____...
- Kombësia: _____
- Data e lindjes: data/muaji/viti _____
- Statuti i punësimit: i punësuar; i vetëpunësuar; i papunë ☐
- Emri dhe adresa e kompanisë: _____
- Detaje të kontaktit: telefon zyre _____; celular _____; e-mail _____
- Eksperiencia e punës në total: vite _____ muaj _____
- Nivel arsimor

Nr.	Emri i diplomës	Program studimi	Viti i diplomimit	Institucion i arsimit të lartë
1*				
2				
3				
4				

14. Përvoja e punës për zbatimin e kriterëve të kualifikimit

Nr.	Emri i punëdhënësit/ organizata	Pozicioni	Vitet nga/deri	Përshkrim i shkurtër i punës (deri 50 karaktere)
1*				
2				
3				
4				
5				
6				

Deklaratë e kandidatit: Deklaroj se i gjithë informacioni i dhënë në formularin e aplikimit është i vërtetë sipas njohurive të mia. Jam dakord me kushtin që, nëse ndonjë informacion apo ndonjë gjë është gjetur pasaktë, pranimi im në provim do të anulohet. Unë, gjithashtu, do të informoj organin e certifikatave për çdo ndryshim të adresës, numrit të telefonit dhe e-mail-it tim.

Vendi: _____

Të dhënat: _____; firma _____



SHTOJCA II PROGRAMET E TRAJNIMIT

MODULI I

Kërkesat minimale në lidhje me aftësitë dhe njohuritë, që mbulohen nga organet e vlerësimit të konformitetit, që certifikojnë personat që kryejnë veprimtaritë e parashikuara në pikën 2, të kreut I

1. Testimi për secilën nga kategoritë e përmendura në pikën 1, të kreut II, do të përbëhet nga sa vijon:
 - a) një test teorik me një ose më shumë pyetje, që testojnë atë aftësi ose njohuri, siç tregohet në kolonat e kategorisë T;
 - b) një test praktik, ku aplikanti do të kryejë detyrën përkatëse me materialin, mjetet dhe pajisjet përkatëse, siç tregohet në kolonat e kategorisë P.
2. Provimi do të përfshijë secilin nga grupet e aftësive dhe njohurive 1, 2, 3, 4, 5, 10 dhe 11.
3. Provimi përfshin të paktën një nga grupet e aftësive dhe njohurive 6, 7, 8 dhe 9. Kandidati nuk informohet para provimit se për cilën nga këta katër komponentë do të testohet.
4. Nëse ka vetëm një kuti në kolonat e kategorive, që korrespondon me disa kuti (disa aftësi dhe njohuri) në kolonën e aftësive dhe të njohurive, kjo do të thotë se jo domosdoshmërisht të gjitha aftësitë dhe njohuritë testohen gjatë provimit.

AFTËSI DHE NJOHURI		KATEGORITË			
		I	II	III	IV
1	Termodinamika bazë				
1.01	Njohuri për standardin ISO, si për temperaturën, presionin, masën, dendësinë, energjinë	T	T	-	T
1.02	Njohuri për teorinë bazë të sistemeve të ftohjes: termodinamikën bazë (termat kryesorë, parametrat dhe proceset, si: tejnxehja, ana e presionit të lartë, nxehësia e komprimimit, entalpia, efekti i ftohjes, ana e presionit të ulët, tejftohja), vetitë dhe transformimet termodinamike të ftohësve, duke përfshirë identifikimin e përzierjeve zeotrope dhe gjendjet e lëngëta.	T	T	-	-
1.03	Përdorni tabelat e diagramet përkatëse dhe interpretoni ato në kontekstin e kontrollit indirekt të rrjedhjeve (përfshirë kontrollin e funksionimit të mirë të sistemit): diagrami presion-entalpi, tabelat e ngopjes së një ftohësi, diagrami i një cikli ftohjeje me kompresim.	T	T	-	-
1.04	Përshkruani funksionin e komponentëve kryesorë në sistem (kompresori, avulluesi, kondensuesi, valvulat e zgjerimit termostatik) dhe transformimet termodinamike të ftohësit.		T	-	-
1.05	Njohuri për funksionin bazë të komponentëve të mëposhtëm të përdorur në një sistem ftohjeje, rolin dhe rëndësinë e tyre për parandalimin e identifikimin e rrjedhjeve të ftohësit: a) valvulat e ndryshme; b) kontrollat e temperaturës e të presionit; c) treguesi prej qelqi dhe treguesit e lagështisë; d) kontrollat e shkrirjes; e) mbrojtëset e sistemit; f) pajisjet matëse si grupi i manometrave; g) sistemet e kontrollit të vajit; h) marrësit; i) ndarësit e lëngjeve dhe të vajit.	T	-	-	-
2	Ndikimi mjedisor i ftohësve dhe rregulloret përkatëse mjedisore				
2.01	Të ketë njohuri bazë për ndryshimet klimatike, duke përfshirë protokollin e Montrealit (amendamentin e Kigalit).	T	T	T	T
2.02	Të ketë njohuri bazë për konceptin e Potencialit të Ngrohjes Globale (GWP), përdorimin e gazeve serrë të fluoruara dhe substancave të tjera ftohëse, ndikimin e emetimeve të gazeve serrë të fluoruara në klimë (rendin e madhësisë së GWP-së së tyre). Të njohë dispozitat përkatëse të ligjit nr. 2/2023, “Për gazet serrë të fluoruara”, dhe aktet e tjera nënligjore, në zbatim të këtij ligji.	T	T	T	T
3	Kontrollet që duhen bërë përpara vënies në punë të një impianti ftohjeje, pas një periudhe të gjatë mospërdorimi, pas ndërhyrjes së mirëmbajtjes ose riparimit ose gjatë funksionimit				
3.01	Kryeni një test presioni për të kontrolluar forcën e sistemit.				
3.02	Kryeni një test presioni për të kontrolluar mosrrjedhjen e sistemit.				
3.03	Përdorni një pompë vakum.				
3.04	Bëni vakumin e sistemit për të hequr ajrin dhe lagështinë sipas praktikës standarde.				
3.05	Plotësoni të dhënat në regjistrat e pajisjeve dhe plotësoni një raport për provat dhe kontrollet e kryera gjatë ekzaminimit.	T	T	-	-
4	Kontrollet për rrjedhje				



4.01	Të njihni pikat e mundshme të rrjedhjeve të pajisjeve të ftohjes, të ajrit të kondicionuar dhe të pompës së nxehtësisë.	T	T	-	T
4.02	Kontrolloni të dhënat e pajisjeve përpara kontrollit të rrjedhjeve dhe identifikoni informacionin përkatës për çdo çështje të përsëritur ose zonë problematike për t'i kushtuar vëmendje të veçantë.	T	T	-	T
4.03	Të bëhet një inspektim vizual dhe manual i të gjithë sistemit në përputhje me ligjin nr. 2/2023, "Gazet serrë të fluoruara", dhe udhëzimet e përbashkëta për kërkesat standarde të kontrollit të rrjedhjeve për pajisjet e ftohjes të palëvizshme, të ajrit të kondicionuar dhe të pompës së nxehtësisë, që përmbajnë gaze serrë të fluoruara.	P	P	-	P
4.04	Kontrolloni sistemin për rrjedhje, duke përdorur një metodë matëse indirekte, në përputhje me udhëzimet e dhëna nga prodhuesi në instruksionin (libretin) e sistemit.	P	P	-	P
4.05	Përdorni pajisje matëse portative si grupe manometrash, termometra dhe multimetra për matjen e Volt/Amp/Ohm, në kontekstin e metodave indirekte për kontrollin e rrjedhjeve dhe interpretoni parametrat e matur.	P	P	-	P
4.06	Kontrolloni sistemin për rrjedhje, duke përdorur një nga metodat e matjes direkte, në përputhje me udhëzimet e dhëna nga prodhuesi në instruksionin (libretin) e sistemit.	P	-	-	-
4.07	Kontrolloni sistemin për rrjedhje, duke përdorur një nga metodat e matjes direkte, që nuk përfshin ndërhyrje në qarqet e ftohjes.	-	P	-	P
4.08	Përdorni një pajisje elektronike për zbulimin e rrjedhjeve.	P	P	-	P
4.09	Plotësoni të dhënat në regjistrat e pajisjeve.	T	T	-	T
5 Trajtimi miqësor ndaj mjedisit i sistemit dhe i ftohësit gjatë instalimit, mirëmbajtjes, servisit ose rikuperimit					
5.01	Lidhni dhe shkëputni matësit dhe linjat, duke pasur emetime minimale.	P	P	-	-
5.02	Zbrazni dhe mbushni një cilindër ftohës në gjendje të lëngët dhe të gaztë.	P	P	P	-
5.03	Përdorni një pajisje rikuperimi për të rikuperuar ftohësin dhe për të lidhur e për të shkëputur grupin e rikuperimit, duke pasur emetime minimale.	P	P	P	-
5.04	Tërhiqni nga sistemi vajin e kontaminuar me gaz të fluoruar.	P	P	P	-
5.05	Identifikoni gjendjen e ftohësit (të lëngshëm, të gaztë) dhe gjendjen e tij (i tejftohur, i ngopur ose i tejnxehur) përpara karikimit, në mënyrë që të zgjidhni metodën e duhur dhe vëllimin e saktë të ngarkesës. Mbushni sistemin me ftohës (si në fazën e lëngshme, ashtu edhe në atë të avullit) pa shkaktuar rrjedhje.	P	P	-	-
5.06	Përdorni peshore për të peshuar ftohësin.	P	P	P	-
5.07	Plotësoni të dhënat e pajisjeve me të gjithë informacionin përkatës në lidhje me ftohësin e rikuperuar ose të shtuar.	T	T	-	-
5.08	Njihni kërkesat e procedurat për trajtimin, ruajtjen dhe transportin e ftohësve dhe të vajrave të kontaminuara.	T	T	T	-
6 Komponenti: instalimi, vënia në punë dhe mirëmbajtja e kompresorëve me piston, me vidë dhe me rrotullim (scroll), me një dhe dy faza komprimimi					
6.01	Shpjegoni funksionimin bazë të një kompresori (përfshirë kontrollin e kapacitetit dhe sistemin e lubrifikimit) dhe rreziqet e rrjedhjes ose të lëshimit të ftohësit, që lidhen me të. Shpjegoni funksionimin bazë të një kompresori (përfshirë rregullimin e fuqisë dhe sistemin e lubrifikimit), si dhe rreziqet që lidhen me humbjen ose rrjedhjen e ftohësit.	T	T	-	-
6.02	Instaloni saktë një kompresor, duke përfshirë pajisjet e kontrollit dhe të sigurisë, në mënyrë që të mos ketë rrjedhje, si dhe të mos ketë rrjedhje edhe pasi sistemi të vihet në punë.	P	-	-	-
6.03	Rregulloni çelësat e sigurisë dhe të kontrollit.	P	-	-	-
6.04	Rregulloni valvulat e thithjes dhe të shkarkimit.				
6.05	Kontrolloni sistemin e kthimit të vajit.				
6.06	Ndizni dhe fikni një kompresor e kontrolloni kushtet e mira të punës së kompresorit, duke përfshirë matjet gjatë funksionimit të kompresorit.	P	-	-	-
6.07	Hartoni një raport për gjendjen e kompresorit, duke treguar çdo problem funksionimi, që ndikon në dëmtimin e sistemit në afat të gjatë, dhe të shkaktojë rrjedhje të ftohësit në mungesë të ndërhyrjeve.	T	-	-	-
7 Komponenti: instalimi, vënia në punë dhe mirëmbajtja e kondensatorëve me ftohje me ajër dhe me ujë					
7.01	Shpjegoni funksionimin bazë të një kondensatori dhe rreziqet e rrjedhjeve që lidhen me të.	T	T	-	-
7.02	Rregulloni kontrollin e presionit të shkarkimit të kondensatorit.	P	-	-	-
7.03	Instaloni një kondensator, siç duhet, duke përfshirë pajisjet e kontrollit e të sigurisë, në mënyrë që të mos ketë rrjedhje ose lëshim të madh, kur sistemi është vënë në punë.	P	-	-	-
7.04	Rregulloni çelësat e sigurisë dhe të kontrollit.	P	-	-	-
7.05	Kontrolloni linjat e shkarkimit dhe të lëngjeve.				
7.06	Pastroni gazet, që nuk kondensohen nga kondensatori, duke përdorur një pajisje ftohëse pastrimi.	P	-	-	-



7.07	Ndizni dhe fikni një kondensator dhe kontrolloni gjendjen e mirë të punës së kondensatorit, duke përfshirë matjet gjatë funksionimit.	P	-	-	-
7.08	Kontrolloni sipërfaqen e kondensatorit.	P	-	-	-
7.09	Shkruani një raport rreth gjendjes së kondensatorit, i cili identifikon çdo problem në funksionim, që dëmton sistemin dhe që çon në rrjedhje ose lëshim të ftohësit, nëse nuk ndërmerren veprime.	T	-	-	-
8 Komponenti: instalimi, vënia në punë dhe mirëmbajtja e avulluesit me ftohje me ajër dhe me ujë					
8.01	Shpjegoni funksionimin bazë të një avulluesi (përfshirë sistemin e shkrirjes) dhe rreziqet e rrjedhjeve që lidhen me të.	T	T	-	-
8.02	Rregulloni pajisjet e kontrollit të presionit të avullimit të një avulluesi.	P	-	-	-
8.03	Instaloni saktë një avullues, duke përfshirë pajisjet e kontrollit dhe të sigurisë, në mënyrë që të mos ketë rrjedhje edhe pasi sistemi të vihet në punë.	P	-	-	-
8.04	Rregulloni çelësat e sigurisë dhe të kontrollit.	P	-	-	-
8.05	Kontrolloni që tubat e lëngut dhe ato të dërgimit të jenë në pozicionin e duhur.				
8.06	Kontrolloni linjën e shkrirjes me gaz të nxehtë.				
8.07	Rregulloni valvulën e rregullimit të presionit të avullimit.	P	-	-	-
8.08	Ndizni dhe fikni një avullues dhe kontrolloni gjendjen e mirë të funksionimit të avulluesit, duke përfshirë matjen gjatë funksionimit.				
8.09	Kontrolloni sipërfaqen e avulluesit.				
8.10	Hartoni një raport për gjendjen e avulluesit, duke treguar çdo problem funksional, që dëmton sistemin në periudhë afatgjatë ose që shkakton rrjedhje të ftohësit, nëse nuk ndërmerren veprime.	T	-	-	-
9 Komponenti: instalimi, vënia në punë dhe riparimi i valvulave të zgjerimit termostatike (TEV) dhe komponentëve të tjerë					
9.01	Shpjegoni funksionimin bazë të llojeve të ndryshme të rregullatorëve të zgjerimit (valvulat e zgjerimit termostatik, tubat kapilarë) dhe rreziqet e rrjedhjeve, që lidhen me të. Shpjegoni funksionimin bazë të llojeve të ndryshme të rregullatorëve të zgjerimit (valvulat e zgjerimit termostatike ose tubat kapilarë) dhe rreziqet e lidhura me rrjedhjet.	T	T	-	-
9.02	Instaloni valvulat në pozicionin e duhur.	P	-	-	-
9.03	Rregulloni një valvul zgjerimi termostatike, qoftë mekanike ose elektronike	P	-	-	-
9.04	Rregulloni termostetet mekanike dhe elektronike.				
9.05	Rregulloni një valvul, që aktivizohet me presion.				
9.06	Rregulloni kufizuesit e presionit mekanik dhe elektronik.	P	-	-	-
9.07	Kontrolloni funksionimin e një ndarësi vaji.				
9.08	Kontrolloni gjendjen e një filtri tharës.	P	-	-	-
9.09	Shkruani një raport rreth gjendjes së këtyre komponentëve, ku të identifikohet çdo problem në funksionim, që dëmton sistemin dhe përfundimisht çon në rrjedhje të ftohësit, nëse nuk ndërmerren veprime. Hartoni një raport për gjendjen e këtyre komponentëve, duke treguar çdo problem funksional, që dëmton sistemin ose shkakton rrjedhje të ftohësit, nëse nuk ndërmerren veprime.	T	-	-	-
10 Tubacionet: ndërtimi i një sistemi tubacionesh të papërshkueshme nga rrjedhjet në një impiant ftohës					
10.01	Kryeni saldim dhe ngjitje të papërshkueshme në tuba metalikë, si dhe në tubacione dhe komponentë të tjerë të përdorur në sistemet e ftohjes, të ajrit të kondicionuar ose në pompat e nxehtësisë.	P	P	-	-
10.02	Përgatitni dhe kontrolloni mbështetëset e tubave dhe komponentëve të tjerë të sistemit.	P	P	-	-
11 Informacion për teknologjitë përkatëse për zëvendësimin e gazeve serrë të fluoruar ose reduktimin e përdorimit të tyre dhe për trajtimin e sigurt të këtyre teknologjive					
11.01	Të njihni teknologjitë alternative përkatëse, që ju lejojnë të zëvendësoni gazrat serrë të fluoruar ose të reduktoni përdorimin e tyre dhe të dini se si t'i trajtoni ato në mënyrë të sigurt.	T	T	T	T
11.02	Të njihni karakteristikat përkatëse të projektimit të një impianti për të zvogëluar madhësinë e ngarkesës së gazit serrë të fluoruar dhe për të rritur efikasitetin e energjisë.	T	T	-	-
11.03	Të njihni normativat përkatëse dhe rregullat e sigurisë në lidhje me përdorimin, ruajtjen dhe transportin e ftohësve të ndezshëm ose toksikë ose ftohësve, që kërkojnë presion më të lartë të funksionimit.	T	T	-	-
11.04	Të njihni avantazhet dhe disavantazhet përkatëse, veçanërisht në lidhje me eficiencën e energjisë, të ftohësve alternativë, bazuar në aplikimin e synuar dhe kushtet klimatike të rajoneve të ndryshme	T	T	-	-



MODULI II

Kërkesat minimale në lidhje me aftësitë dhe njohuritë, që mbulohen nga organet e vlerësimit për personat, që kryejnë aktivitetet në sistemet e palëvizshme të mbrojtjes nga zjarri dhe fikësit e zjarrit

Testimi i përmendur në pikën 6, të kreut II, të këtij vendimi, do të përbëhet nga sa vijon:

- a) një test teorik me një ose më shumë pyetje, që testojnë atë aftësi ose njohuri, siç tregohet në kolonën “Lloji i testit” nga T;
- b) një test praktik, ku aplikanti do të kryejë detyrën përkatëse me materialin, mjetet dhe pajisjet përkatëse, siç tregohet në kolonën “Lloji i provës” nga P.

Njohuri dhe aftësi minimale		Lloji i testit
1	Njohuri bazë për çështjet mjedisore. Të ketë njohuri bazë për ndryshimet klimatike, duke përfshirë protokollin e Montrealit (amandamentin e Kigalit)	T
2	Njohuri bazë të standardeve teknike përkatëse	T
3	Të ketë njohuri bazë për konceptin e Potencialit të Ngrohjes Globale (GWP), përdorimin e gazeve serrë të fluoruara, ndikimin e emetimeve të gazeve serrë të fluoruara në klimë (rendin e madhësisë së GWP-së së tyre), të njohë dispozitat përkatëse të ligjit nr. 2/2023, “Për gazet serrë të fluoruara”, dhe aktet e tjera nënligjore në zbatim të këtij ligji.	T
4	Njohuri të mira për llojet e ndryshme të pajisjeve të mbrojtjes nga zjarri, që përmbajnë gaze serrë të fluoruara në treg	T
5	Njohuri të mira të llojeve të valvulave, mekanizmave të aktivizimit, trajtimit të sigurt, parandalimit të shkarkimit dhe rrjedhjeve	T
6	Njohuri të mira për pajisjet dhe mjetet e nevojshme për trajtimin e sigurt dhe praktikën e punës	T
7	Aftësi për të instaluar kontejnerë të sistemit të mbrojtjes nga zjarri të krijuar për të mbajtur gaze serrë të fluoruara	P
8	Njohuri të praktikave të sakta për lëvizjen e kontejnerëve nën presion, që përmbajnë gaze serrë të fluoruara	T
9	Aftësi për të kontrolluar të dhënat e sistemit përpara një kontrolli për rrjedhje dhe për të identifikuar informacionin përkatës për çdo çështje të përsëritur ose fushë problematike që duhet t’i kushtohet vëmendje	T
10	Aftësi për të bërë një kontroll vizual e manual të sistemit për rrjedhje, në përputhje me udhëzuesin për kërkesat standarde të kontrollit të rrjedhjeve për sistemet e palëvizshme të mbrojtjes nga zjarri, që përmbajnë gaze serrë të fluoruara ⁽¹⁾	P
11	Njohuri për praktikën miqësore me mjedisin për rikuperimin e gazeve serrë të fluoruara dhe ngarkimin e sistemeve të mbrojtjes nga zjarri	T

⁽¹⁾ OJ L 333, 19.12.2007, f. 4.

MODULI III

Kërkesat minimale në lidhje me aftësitë dhe njohuritë, që mbulohen nga organet e vlerësimit për personin që ushtron veprimtarinë me instalimin, shërbimin, mirëmbajtjen, riparimin ose nxjerrjen nga përdorimi të stabilimenteve elektrike, që përmbajnë gaze serrë të fluoruara ose rikuperimin e gazeve serrë të fluoruara nga pajisja, kutia e shpejtësisë elektrike e palëvizshme

Testimi i përmendur në pikën 6, të kreut II, të këtij vendimi, do të përbëhet nga sa vijon:

- a) një test teorik me një ose më shumë pyetje që testojnë atë aftësi ose njohuri, siç tregohet në kolonën “Lloji i testit” nga T;
- b) një test praktik ku aplikanti do të kryejë detyrën përkatëse me materialin, mjetet dhe pajisjet përkatëse, siç tregohet në kolonën “Lloji i testit” nga P.



Nr.	Njohuri dhe aftësi minimale	Lloji i testit
1	Të ketë njohuri bazë për konceptin e Potencialit të Ngrohjes Globale (GWP), ndikimin e emetimeve të gazeve serrë të fluoruara në klimë (rendin e madhësisë së GWP-së së tyre), të njohë dispozitat përkatëse të ligjit nr. 2/2023, “Për gazet serrë të fluoruara”, dhe aktet tjera nënligjore në zbatim të këtij ligji	T
2	Karakteristikat fizike, kimike dhe mjedisore të SF ₆	T
3	Përdorimi i SF ₆ në pajisjet e energjisë elektrike (izolim, komutues etj.)	T
4	Cilësia e SF ₆ , sipas standardeve përkatëse industriale	T
5	Njohuri për projektimin e pajisjeve të energjisë elektrike	T
6	Kontrolli i cilësisë së SF ₆	P
7	Rikuperimi SF ₆ dhe i përzierjeve të SF ₆ dhe pastrimi i tyre	P
8	Ruajtja dhe transporti i SF ₆	T
9	Funksionimi i pajisjeve të rikuperimit të SF ₆	P
10	Përdorimi i sistemeve të ngushta të shpimit, nëse është e nevojshme	P
11	Ripërdorimi i SF ₆ dhe kategori të ndryshme ripërdorimi	T
12	Punë në dhomëzat e hapura të SF ₆	P
13	Neutralizimi i nënprodukteve të SF ₆	T
14	Monitorimi i SF ₆ dhe detyrimet për regjistrimin e të dhënave, sipas legjislacionit kombëtar ose të Bashkimit Evropian, ose marrëveshjeve ndërkombëtare	T
15	Reduktimi i rrjedhjeve dhe kontrollat e rrjedhjeve	T
16	Njohuri bazë për teknologjitë përkatëse për të zëvendësuar ose reduktuar përdorimin e gazeve serrë të fluoruara dhe trajtimin e tyre të sigurt	T

MODULI IV

Kërkesat minimale në lidhje me aftësitë dhe njohuritë, që mbulohen nga organet e vlerësimit për personin që kryen rikuperimin e disa solventëve me bazë gaz serrë të fluoruar nga pajisjet

Testimi i përmendur në pikën 6, të kreut II, të këtij vendimi, do të përbëhet nga sa vijon:

a) një test teorik me një ose më shumë pyetje, që testojnë atë aftësi ose njohuri, siç tregohet në kolonën “Lloji i testit” nga T;

b) një test praktik, ku aplikanti do të kryejë detyrën përkatëse me materialin, mjetet dhe pajisjet përkatëse, siç tregohet në kolonën “Lloji i provës” nga P.

Nr.	Njohuri dhe aftësi minimale	Lloji i testit
1	Të ketë njohuri bazë për konceptin e Potencialit të Ngrohjes Globale (GWP), ndikimin e emetimeve të gazeve serrë të fluoruara në klimë (rendin e madhësisë së GWP-së së tyre), të njohë dispozitat përkatëse të ligjit nr. 2/2023, “Për gazet serrë të fluoruara”, dhe aktet e tjera nënligjore, në zbatim të këtij ligji	T
2.	Karakteristikat fizike, kimike dhe mjedisore të gazeve serrë të fluoruara, që përdoren si solventë	T
3	Përdorimi i gazeve serrë të fluoruara si solventë	T
4	Rikuperimi i solventëve me bazë gaz serrë të fluoruar	P
5	Ruajtja dhe transportimi i solventëve me bazë gaz serrë të fluoruar	T
6	Funksionimi i pajisjeve të rikuperimit në lidhje me pajisjet, që përmbajnë solvent me bazë gaz serrë të fluoruar	P

SHTOJCA III
VËRTETIM I REZULTATIT TË TESTIMIT

Emri i institucionit/organizatat:

Adresa:

Numri i telefonit:

E-mail:

Data: [Data e lëshimit]

Vërtetim i rezultatit të testimit për gazet e fluoruara

Ky dokument vërteton se [emri i personit], me adresën [adresa e personit], ka përfunduar testimin për t'u pajisur me certifikatë të kategorisë____, në përputhje me standardet e përcaktuara.

Detajet e testimit:

- **Data e testimit:** [data e testimit]- **Metoda e testimit:** [përshkrimi i metodës së përdorur me shkrim/gojë/praktikë]- **Rezultati:** [shpjegim i rezultateve të arritura]

Bazuar në rezultatin e testimit, vërtetojmë se [emri i personit] plotëson/nuk plotëson kërkesat dhe njohuritë e duhura për t'u pajisur me certifikatë.

Lëshuar në datën _____ nga organi certifikues.

Nënshkrimi:
[emri i përgjegjësit]
[pozita]
[data]
(firma dhe vula)

SHTOJCA IV
FORMATI I NJOFTIMIT MBI PERSONAT E CERTIFIKUAR

____ (DD.MM.20VV)			
A	Informacion mbi certifikatën		
1	Emri i personit të certifikuar		Fotografia
2	Emri i babait		
3	Numri i regjistrimit për testim		
4	Numri i certifikatës së regjistruar		
5	Data e hyrjes në regjistër		
6	Të dhënat e lëshimit të certifikatës		
7	Të dhënat e rinovimit të certifikatës	1.	
		2.	
		3.	

B	Të dhënat e komunikimit	
1	Adresa postare	
2	Adresa e e-mail-it	
3	Numra të telefonit	

C	Përvoja e punës për punën e kritereve të kualifikimit					
	Nga		Në		Përshkrim i shkurtër i eksperiencës së punës	
	Muaji	Viti	Muaji	Viti	Emri dhe adresa e punëdhënësit	Unë, i vetëpunësuar Përmbajtja e punës/eksperiencia
1						
2						
3						
4						



D	Informacion personal		
1	Data e lindjes	DD.MM.VV	
2	Kombësia		
3	Niveli arsimor		
Diplomë/kualifikim		Institucioni i arsimit të lartë	Viti
1			
2			
3			
4			
1			
2			
3			
4			


E	Shënime

SHTOJCA V
FORMATI I CERTIFIKATËS SË PERSONIT TË CERTIFIKUAR

ORGANI CERTIFIKUES

Tiranë

PERSONI I CERTIFIKUAR



Numri i certifikatës: _____

Emri: _____

Adresa: _____

Nr. personal _____

Certifikohet për _____, kategoria _____

Data e lëshimit: _____ deri në: _____

Autoriteti që e lëshon

Emri: _____

Pozicioni: _____

Adresa zyrtare: _____

Firma dhe vula: _____

SHTOJCA VI
FORMATI I KARTËS SË PERSONIT TË CERTIFIKUARORGANI CERTIFIKUES
Tiranë

PERSONI I CERTIFIKUAR

Fotografia

Numri i certifikatës: _____

Emri: _____

Certifikohet për _____, kategoria _____

Firma e personit të certifikuar

Data e lëshimit: _____ deri në: _____

Autoriteti që e lëshon

Emri: _____

Pozicioni: _____

Adresa zyrtare: _____

Firma dhe vula: _____

UDHËZIM I PËRBASHKËT

Nr. 1, datë 7.11.2024

**PËR MËNYRËN E BASHKËPUNIMIT
MES KOMISIONIT QENDROR TË
ZGJEDHJEVE DHE DREJTORISË SË
PËRGJITHSHME TË GJENDJES CIVILE
PËR ÇREGJISTRIMIN E SHTETASVE
QË VOTOJNË JASHTË TERRITORIT TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË
LISTËN E ZGJEDHËSVE BREND
VENDIT**

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; të pikës 2 të nenit 19, të pikës 13, të nenit 25, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; si dhe të ligjit nr. 10129, datë 11.5.2009, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar, ministri i Brendshëm dhe Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

UDHËZOJNË:

I. Rregulla të përgjithshme

1. Zgjedhësi që ndodhet jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe dëshiron të ushtrojë të drejtën e votës për zgjedhjet në Kuvendin e Shqipërisë duhet të regjistrohet në listën e zgjedhësve jashtë vendit, në përputhje me përcaktimet e bëra në Kodin Zgjedhor dhe aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.

2. Lista e zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë është një listë e vetme në nivel zone zgjedhore dhe përmban listën e shtetasve shqiptarë që kanë shprehur vullnetin të votojnë nga jashtë vendit dhe që janë regjistruar në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (në vijim “RKGJC”) në territorin e zonës zgjedhore përkatëse.

3. Lista e zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë hartohet dhe përdoret rishtazi për çdo proces zgjedhor për



Kuvendin e Shqipërisë, sipas kritereve, procedurave dhe afateve të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe aktet normative të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (në vijim “KQZ”) dhe është e vlefshme vetëm për zgjedhjet për të cilat është hartuar.

4. Në çdo rast, KQZ-ja dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile (në vijim “DPGJC”) ruajnë bazën e të dhënave të zgjedhësve që votojnë nga jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë për çdo proces zgjedhor.

5. Të dhënat për adresën dhe dokumentacioni që konfirmojnë qëndrimin e zgjedhësve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë miratohen me vendim të Rregullatorit.

II. Mënyra e bashkëpunimit dhe e shkëmbimit të informacionit, me qëllim hartimin e listës së zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë dhe çregjistrimi i këtyre zgjedhësve nga lista e zgjedhësve brenda vendit ndërmjet institucioneve shtetërore të përfshirë.

1. Regjistrimi i zgjedhësve nga jashtë vendit dhe përgatitja e listës së këtyre zgjedhësve bëhet sipas rregullave të përcaktuara me akt normativ të Komisionit Rregullator.

2. Kërkesat për regjistrim kryhen përmes Platformës Elektronike të Regjistrimit (në vijim referuar si “PER”), sipas përcaktimeve të Kodit Zgjedhor.

3. Gjatë periudhës së hartimit të listës së zgjedhësve jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, KQZ-ja komunikon me DPGJC-në përmes ndërveprimit automatik elektronik në kohë reale midis PER-së dhe RKGJC-së.

4. Të dhënat e identitetit të shtetasit, të marra gjatë procesit të paraqitjes së kërkesës për regjistrim në PER, verifikohen nga KQZ-ja në RKGJC. Nëse ato janë të njëjta, DPGJC-ja bën regjistrimin në RKGJC të adresës së shtetasit që voton jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë në një rubrikë të veçantë.

5. Të dhënat për adresën e banimit që do të kërkojnë gjatë procesit të regjistrimit nga ana e zgjedhësit dhe që do të transmetohen në RKGJC janë: shteti, qyteti, emërtesa e rrugës, numri i banesës, elemente të tjera të adresës (nëse ka), dhe kodi postar.

6. Çdo informacion që Komisioni Qendror i Zgjedhjeve transmeton te Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, si pjesë e procedurave për

përgatitjen e listës së zgjedhësve nga jashtë vendit, do të përdoret nga DPGJC-ja vetëm për qëllime që lidhen me mundësimin e votimit për këta zgjedhës.

7. Në përfundim të procesit të regjistrimit të kërkesave të zgjedhësve për të votuar nga jashtë vendit, sipas afateve të përcaktuara me vendim të Komisionit Rregullator, DPGJC-ja nxjerr nga RKGJC-ja listën paraprake të zgjedhësve nga jashtë vendit dhe ia dërgon atë në format elektronik Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, jo më vonë se 63 ditë para datës së zgjedhjeve.

8. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, 63 ditë para datës së zgjedhjeve, publikon listën paraprake të zgjedhësve që votojnë jashtë vendit, me qëllim që zgjedhësit, brenda 48 orëve nga publikimi i saj, të mund të kërkojnë regjistrimin apo rregullimin e pasaktësive të regjistrimit të tyre në PER-në.

9. Në përfundim të procesit të përmendur në pikat 7 dhe 8 të kreut II të këtij udhëzimi, DPGJC-ja nxjerr nga RKGJC listën përfundimtare të zgjedhësve nga jashtë vendit dhe ia dërgon atë në format elektronik KQZ-së menjëherë, por jo më vonë se 61 ditë para datës së zgjedhjeve.

10. Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, 60 ditë para datës së zgjedhjeve, miraton dhe publikon në faqen zyrtare të internetit të KQZ-së, listën përfundimtare të zgjedhësve që votojnë jashtë vendit.

11. Shtetasit shqiptarë që janë regjistruar në listën e zgjedhësve jashtë vendit, pas përfundimit të procedurës së regjistrimit sipas këtij udhëzimi dhe miratimit e publikimit të listës përfundimtare të zgjedhësve që votojnë jashtë vendit nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, çregjistrohen nga lista e zgjedhësve brenda vendit që shpallet sipas nenit 56 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

12. DPGJC-ja monitoron dhe merr masa për zbatimin e veprimtarisë së pasqyrit të ndryshimeve përkatëse në listën e zgjedhësve, për çregjistrimin dhe heqjen nga kjo listë të zgjedhësve që votojnë jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

13. Ndryshimet në listën e zgjedhësve pasqyrohen në ekstraktin e parë të listës së zgjedhësve, që del pas publikimit të listës përfundimtare të zgjedhësve që votojnë jashtë vendit, nga Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve.

**III. Mbikëqyrja dhe kontrolli i procesit**

1. Auditët teknikienë, të miratuar sipas nenit 61 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, kryejnë verifikimin e veprimeve të kryera nga KQZ për regjistrimin e shtetasve që votojnë nga jashtë vendit, duke filluar 120 ditë përpara datës së zgjedhjeve.

IV. Dispozita të fundit

1. Ngarkohen me zbatimin e këtij udhëzimi Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Bashkitë, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi administrative, si dhe institucionet e tjera shtetërore të parashikuara nga Kodi Zgjedhor.

2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, për ndjekjen e zhvillimeve të nevojshme teknike në RKGJC, që lindin nga zbatimi i këtij udhëzimi.

3. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Ervin Hoxha

KOMISIONERI SHTETËROR
I ZGJEDHJEVE
Ilirjan Celibashi

UDHËZIM I PËRBASHKËT
Nr. 221, datë 8.11.2024**PËR MASËN, KRITERET DHE
PROCEDURAT PËR TARIFAT
FINANCIARE PËR VEPRIMTARINË
E LEJUAR ME ARMËT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar; ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, “Për menaxhimin e financave dhe

kontrollin”, të ndryshuar; nenit 48, të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar; dhe vendimit nr. 432, datë 28.6.2006, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore”,

UDHËZOJMË:

1. Miratimin e tarifave për veprimtaritë e lejuara me armët në zbatim të ligjit nr. 74/2014, datë 10.7.2014, “Për armët”, të ndryshuar, sipas tabelës nr. 1, bashkëlidhur dhe që është pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

2. Të ardhurat që realizohen nga shërbimet që ofrohen nga Policia e Shtetit në zbatim të ligjit nr. 74/2014, “Për armët”, të ndryshuar, do të trajtohen si të ardhura nga veprimtaria kryesore të cilat realizohen nga institucioni buxhetor, gjatë kryerjes së detyrave të tyre funksionale. Këto të ardhura derdhen tërësisht në buxhetin e shtetit dhe shpenzohen si pjesë e totalit të të ardhurave të këtij buxheti.

3. Me këtë udhëzim të njihen gjithë punonjësit e Policisë së Shtetit, si dhe personat e interesuar për veprimtarinë e lejuar me armët.

4. Udhëzimi i përbashkët i ministrit të Brendshëm dhe i ministrit të Financave nr. 264/1, datë 29.6.2015, “Për masën, kriteret dhe procedurat për tarifat financiare për veprimtarinë e lejuar me armët”, shfuqizohet.

5. Me zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen strukturat në varësi të Ministrisë së Brendshme dhe strukturat në varësi të Ministrisë së Financave.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Ervin Hoxha

MINISTËR I FINANCAVE
Petrit Malaj



Tabela nr. 1

TARIFAT E SHËRBIMEVE TË POLICISË SË SHETËTIT NDAJ TË TRETËVE PËR VEPRIMTARINË
E LEJUAR ME ARMË

Nr.	Emërtimi i veprimtarive të lejuara me armët	Tarifa që aplikohet (në lekë)
1	Tarifë për dhënie licence për tregtim të armëve të kategorisë B, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre.	100 000
2	Tarifë për dhënie licencë për import dhe tregtim të armëve të kategorisë C dhe D, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre.	100 000
3	Tarifë për pajisjen me licencë për transportin e armëve, pjesëve kryesore dhe municioneve të tyre.	200 000
4	Tarifë për pajisjen me licencë për poligon civil qitjeje të hapur, të mbyllur, me pjatel.	300 000
5	Tarifë për pajisjen me licence për aftësimin teorik dhe praktik të personave për armët.	100 000
6	Tarifë për subjektet e licencuara për aftësimin teorik dhe praktik për komisionin e testimit për veprimtarinë e lejuar me armë, për punonjës të Policisë së Shtetit anëtar të komisionit (në ditë).	1 000
7	Tarifë për pajisjen me certifikatë për drejtues tekniko-administrativ për veprimtaritë e licencuar sipas ligjit për armët.	45 000
8	Tarifë për pajisjen me autorizim për mbajtje arme për personat juridikë.	2 000
9	Tarifë për pajisjen me autorizim të posaçëm për mbajtje arme.	10 000
10	Tarifë për pajisjen me autorizim për mbajtje arme gjahu, sportive dhe armët e tjera të këtij lloji.	2 000
11	Tarifë për pajisjen me autorizim për blerje/mbajtje arme gjahu mbi numrin e lejuar.	5-fishi i vlerës së tarifës së përcaktuar për armë gjahu
12	Tarifë për pajisjen me autorizim për mbajtje në vendbanim, për armët e kategorisë B1	10 000
13	Tarifë për pajisjen e personave fizik/juridik me autorizim provizor për futjen e armëve në territorin e Republikës së Shqipërisë nga shtetasit e huaj për gjueti turistike (për çdo armë).	5 000
14	Tarifë për pajisjen me autorizim për përdorim skenik të armës të dhëna nga policia (për çdo armë) dhe për koleksionim armësh.	1 000
15	Tarifë për pajisjen me autorizim për mbajtje arme gjahu për shtetasit e huaj.	2 000
16	Tarifë për pajisjen me licencë për çaktivizimin e armëve të zjarrit për përdorim civil.	100 000
17	Tarifë për çaktivizimin e armëve të zjarrit të shkurtra (pistoletat me një shkrepje të vetme, gjysmautematike).	3000
18	Tarifë për çaktivizimin e armëve të zjarrit të shkurtra (revolverët, duke përfshirë ato me mulli/cilindër).	2000
19	Tarifë për çaktivizimin e armëve të zjarrit të gjata me një shkrepje të vetme (përfshi ato me veprim me ndërprerje).	4000
20	Tarifë për çaktivizimin e armëve të zjarrit të gjata e të shkurtra me veprim me ndërprerje (me ose pa vjaska, me mekanizëm të mbylljes së fishekut me ulje poshtë ose me rrotullim).	4000
21	Tarifë për çaktivizimin e armëve të zjarrit të gjata me përsëritje (me rimbushje, me ose pa vjaska).	4000
22	Tarifë për çaktivizimin e armëve të zjarrit të gjata gjysmautematike (me ose pa vjaska).	4000
23	Tarifë për çaktivizimin e armëve të zjarrit automatike (automatik të ndryshëm, mitraloza, pistoletat automatike).	7000
24	Tarifë për çaktivizimin e armëve të zjarrit që mbushen nga gryka, me një shkrepje.	2000



UDHËZIM

Nr. 225, datë 12.11.2024

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË UDHËZIMIN E MINISTRIT TË
BRENDSHËM NR. 64, DATË 12.5.2022,
“PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE TË
VEÇANTA TË DHËNIES SË
CERTIFIKATËS PËR USHTRIMIN E
AKTIVITETIT TË EKSPERTIT PRIVAT
NË FUSHËN E MBROJTJES Nga
ZJARRI DHE SHPËTIMIN”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, pikës 4, të nenit 49, të ligjit nr. 152/2015, “Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin”,

UDHËZOJ:

I. Në udhëzimin e ministrit të Brendshëm nr. 64, datë 12.5.2022, “Për përcaktimin e kriterëve të veçanta të dhënies së certifikatës për ushtrimin e aktivitetit të ekspertit privat në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Në kreun I, shkronja “c”, e pikës 1, riformulohet si më poshtë:

c) “Kryerja e trajnimeve bazike në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”;

2. Në kreun 1, pika 1, pas shkronjës “c” shtohet shkronja “ç” me përmbajtje si vijon:

“ç) “Kryerja e trajnimeve të avancuara në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”.”.

3. Në kreun I, shkronjat “a” dhe “c”, të pikës 2 dhe pika 2.1 shfuqizohen.

4. Në kreun I, në shkronjën “a”, të pikës 3, shtohet togfjalëshi “Inxhinieri Pyjore”, “Inxhinieri Gjeodezi”.

5. Në kreun I, shkronja “b”, e pikës 3, riformulohet si më poshtë vijon:

“b) Të ketë 2 vite përvojë në fushën e projektimit të objekteve dhe të disponojë licencë profesionale individuale, studim e projektim në ndërtim, sipas përcaktimeve të nenit 17, pika 1, shkronja “a”, të VKM-së nr. 759, datë 12.11.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrjnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e

kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim”, të ndryshuar.”.

6. Në kreun I, pika 4 riformulohet si vijon:

“4. Subjektet, për t’u pajisur me certifikatë për “Kryerjen e trajnimeve bazike në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, duhet të plotësojnë të paktën njërin nga kriteret e mëposhtme:

a) të kenë eksperiencë jo më pak se 3 vjet në shërbimin zjarrfikës, si punonjës të strukturave vendore të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;

b) të disponojnë një certifikatë që provon se kanë kryer programin për trajnues për aktivitete me rrezik të ulët për trajnues, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së;

c) të jenë të certifikuar në një nga qendrat e akredituara të trajnimit zjarrfikës jashtë vendit. Certifikata duhet të jetë e shoqëruar me programin e kursit të trajnimit për sigurinë nga zjarri.”.

7. Në kreun I, pikat 4.1 dhe 4.2 shfuqizohen.

8. Në kreun I, shtohen pikat 5, 6 dhe 6.1, me përmbajtje si vijon:

“5. Subjektet, për t’u pajisur me certifikatë për “Kryerjen e trajnimeve të avancuara në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, duhet të plotësojnë të paktën njërin nga kriteret e mëposhtme:

a) të kenë eksperiencë jo më pak se 5 vjet në shërbimin zjarrfikës, si punonjës të nivelit të mesëm dhe të lartë në strukturat e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;

b) të disponojnë një certifikatë që provon se kanë kryer programin për trajnues për aktivitete me rrezik të mesëm dhe të lartë, të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së;

c) të jenë certifikuar në një nga qendrat e akredituara të trajnimit zjarrfikës jashtë vendit. Certifikata duhet të jetë e shoqëruar me programin e kursit të trajnimit për trajnues për aktivitete me rrezik të mesëm dhe të lartë.

6. Subjekti fizik i huaj, mund të aplikojë për certifikatë sipas shkronjave “c” dhe “ç”, të pikës 1 të këtij kreu, duke plotësuar kriteret e përcaktuara në pikat 4 dhe 5 të këtij kreu, të ketë njësuar pranë ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe diplomën ekuivalente të lëshuar nga institucionet përkatëse të huaja.

6.1 Subjekti juridik vendas apo i huaj, mund të aplikojë për certifikatë sipas shkronjave “c” dhe “ç”, të pikës 1 të këtij kreu, në emër të drejtuesit



teknik të shoqërisë, i cili plotëson kriteret e përcaktuara në pikat 4 dhe 5 të këtij kreu.

9. Në kreun II, pika 3, riformulohet si vijon:

“3. Eksperti zjarrfikës i certifikuar për “Kryerjen e trajnimeve bazike në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” kryen trajnime që lidhen me dhënien e njohurive bazike në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin për subjektet fizike dhe juridike që kryejnë një aktivitet të caktuar, të klasifikuar si aktivitet me rrezik të ulët zjarri.”.

10. Në kreun II, pas pikës 3 shtohet pikat 4, 5, 6 dhe 7, me përmbajtje si vijon:

“4. Eksperti zjarrfikës i certifikuar për “Kryerjen e trajnimeve të avancuara në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin” kryen trajnime që lidhen me dhënien e njohurive të avancuara për subjektet fizike dhe juridike që kryejnë një aktivitet të caktuar, të klasifikuar si aktivitete me rrezik të mesëm dhe të lartë zjarri.

5. Njohuritë, aftësitë dhe kompetencat e ekspertit, të përcaktuara në pikat 3 dhe 4 të këtij kreu, bazohen në kriteret për menaxhimin e vendeve të punës, vlerësimin e rrezikut nga zjarri në funksionim dhe në raste emergjente, dhe karakteristikat specifike për parandalimin dhe mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, kryesisht në:

a) respektimin e standardeve ligjore, tekniko-strukture në lidhje me pajisjet, sistemet, vendet e punës, agjentët kimikë, fizikë të aktivitetit;

b) aktivitetet e identifikimit, vlerësimit të rrezikut dhe përgatitjen e masave të parandalimit dhe mbrojtjes pasive, aktive;

c) informimin e punonjësve dhe aktivitetet e trajnimit për sigurinë nga zjarri;

ç) aktivitetet mbikëqyrëse në lidhje masat e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;

d) analizimin e dokumentacionit tekniko-ligjor për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin, dhe certifikimet e kërkuara;

dh) kontrollet periodike të aplikimit dhe efektivitetit të procedurave të miratuara për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.

6. Ekspertët e përcaktuar në germën “c”, të pikës 3 të këtij kreu, lejohen të trajnojnë aktivitete me numër punonjësish deri në 15 persona. Ekspertët e përcaktuar në germën “ç”, të pikës 3, të këtij kreu, lejohen të trajnojnë një numër të pakufizuar punonjësish.

7. Programi minimal i kursit të trajnimit për sigurinë nga zjarri për aktivitete me rrezik të ulët, të mesëm dhe të lartë (modulet) janë sipas shtojcës 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi.”.

11. Në kreun III, shkronjat “e” dhe “f”, të pikës 1 shfuqizohen.

12. Në kreun III, pika 4 riformulohet si më poshtë:

“4. Të certifikuarit duhet të kryejnë trajnime ose seminare në fushën e parandalimit të zjarrit, të detyrueshme çdo pesë vjet, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të MZSH-së ose në një nga qendrat e akredituara, me një kohëzgjatje totale prej të paktën dyzet orësh, duke filluar nga data e hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi. Në rast mospërmbushjeje të këtij detyrimi, certifikata e subjekteve do të pezullohet.”.

13. Në kreun IV, pika 2 ndryshon me përmbajtje si vijon:

“2. Regjistri profesional është dokument fizik dhe elektronik, në përgjegjësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, ku regjistrohen të dhënat e certifikimit të subjekteve fizike dhe juridike, sa herë që ato trajtohen dhe u miratohet certifikimi, me të paktën parametrat:

- a) emërtimi i subjektit të certifikuar;
- b) numri unik i certifikatës profesionale;
- c) data e lëshimit të certifikatës;
- ç) adresa elektronike dhe numri i telefonit;
- d) emërtimi i diplomës;
- dh) rezidenca e subjektit.

Sekretariati Teknik i ngritur për mbështetjen e Komisionit të Posaçëm bën përditësimin e të dhënave në Regjistrin Profesional.”.

14. Në kreun IV, shtohen pikat 3, 4 dhe 5 me përmbajtje si vijon:

“3. Në Regjistrin profesional publikohen vetëm të dhënat e të certifikuarve që përmbushin detyrimet e përcaktuara në këtë udhëzim.

4. Regjistri publik elektronik i të certifikuarve, sipas klasifikimit të pikës 1, të kreut I, afishohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Brendshme, përditësohet sipas vendimmarjes së Komisionit të Posaçëm dhe mundësohet aksesimi në të, i çdo subjekti publik apo privat.

5. Formularët e certifikatës, sipas lidhjeve nr. 1, nr. 2, nr. 3 dhe nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi, hartohen në dy kopje të njëjta. Kryetari i Komisionit të Posaçëm i vendos si element sigurie



“QR code”, i cili përmban (emër, mbiemër dhe numrin unik të regjistrimit të aplikuesit, si dhe emri i institucionit që lëshon këtë certifikatë, emërtimin e kategorisë së certifikatës). Drejtori i përgjithshëm i MZSH-së nënshkruan certifikatat në përputhje me vendimmarrjen e Komisionit të Posaçëm. Njëra nga certifikatat mbahet në arkivin e sekretariatit dhe kopja tjetër dorëzohet në arkiv-protokollin e institucionit të ministrisë, së bashku me njërin nga kopjet e vendimit të Komisionit të Posaçëm. Formulari me vulën elektronike i dorëzohet përfituesit/aplikuesit brenda afatit të përcaktuar në pikën 8 të udhëzimit.”.

15. Kreu V riformulohet si më poshtë:

“V. DISPOZITA KALIMTARE DHE TË FUNDIT

1. Certifikatat e miratuara dhe të lëshuara nga Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së, para hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi, do të konsiderohen të vlefshme. Subjektet fizike dhe juridike për të cilëve u janë miratuar këto certifikata, por që nuk figurojnë të regjistruar në regjistrin e përcaktuar në pikën 2 të këtij kreu, duhet të aplikojnë për pajisjen me formatin e miratuar bashkëlidhur këtij udhëzimi, pasi të kenë plotësuar më parë kriteret e përcaktuara në kreun I dhe III të këtij udhëzimi, brenda afatit 12-mujor, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi. Pas këtij afati, certifikatat e parinovuara do të jenë të pavlefshme.

2. Subjektet fizike dhe juridike të cilëve u janë miratuar certifikatat sipas kriterëve të veçanta dhe figurojnë të regjistruar në regjistrin e ekspertëve zjarrfikës privat, konsiderohen të vlefshme. Këto subjekte duhet të aplikojnë për t'u pajisur me formatet e miratuara (lidhjet) bashkëlidhur këtij udhëzimi brenda afatit 6-mujor, nga momenti i hyrjes në fuqi të këtij udhëzimi. Komisioni i Posaçëm i parashikuar në pikën 2, të kreut III të udhëzimit, pajis subjektet me formatin e miratuar të certifikatave, bashkëlidhur këtij udhëzimi, duke rivlerësuar aplikimin në përputhje edhe me parashikimet e pikës 13 po të kreut III të tij.”.

3. Udhëzimi nr. 11, datë 10.12.2002, i ministrit të Pushtetit Vendor dhe Decentralizimit “Për kriteret profesionale të dhënies së lejes për ushtrimin e ekspertit privat zjarrfikës”, shfuqizohet.

II. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e

Përgjithshme e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BRENDSHËM
Ervin Hoxha

SHTOJCA 1

PROGRAMI MINIMAL I KURSIT TË TRAJNIMIT PËR SIGURINË NGA ZJARRI PËR AKTIVITETE ME RREZIK TË ULËT, TË MESËM DHE TË LARTË (MODULET), I DETYRUESHËM PËR EKSPERTËT E CERTIFIKUAR “PËR KRYERJEN E TRAJNIMEVE NË FUSHËN E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN”

A. PROGRAMI I KURSIT TË TRAJNIMIT PËR SIGURINË NGA ZJARRI PËR AKTIVITETE ME RREZIK TË ULËT

Moduli 1: Zjarri dhe parandalimi (1 orë)

- parimet e djegies;
- produktet e djegies;
- substancat shuarëse në lidhje me llojin e zjarrit;
- efektet e zjarrit te njerëzit;
- ndalimet dhe kufizimet e ushtrimit;
- masat e sjelljes.

Moduli 2: Procedurat dhe mbrojtjet për parandalimin e zjarrit që do të miratohen në rast zjarri (1 orë)

- masat kryesore të mbrojtjes nga zjarri;
- evakuimi në rast zjarri;
- thirrje për ndihmë.

Moduli 3: Ushtrime praktike (2 orë)

Rishikimi dhe sqarimi mbi aparatet e fikjes së zjarrit:

- ushtrime për përdorimin e aparateve lëvizshme për shuarjen e zjarrit.

B. PROGRAMI I KURSIT TË TRAJNIMIT PËR SIGURINË NGA ZJARRI PËR AKTIVITETE ME RREZIK TË MESËM

Moduli 1: Zjarri dhe parandalimi (2 orë) në aktivite me rrezik të mesëm

- parimet e djegies;
- substancat shuarëse;
- trekëndëshi i djegies;



- shkaqet kryesore të zjarrit;
- rreziqet për njerëzit në rast zjarri;
- masat specifike të parandalimit të zjarrit;
- masat e sjelljes për të parandaluar zjarret.

Moduli 2: Procedurat dhe mbrojtjet për parandalimin e zjarrit që do të miratohen në rast zjarri (3 orë)

- masat kryesore të mbrojtjes nga zjarri;
- rrugët e eksodit;
- procedurat që duhet të merren kur zbulohet një zjarr ose në rast alarmi;
- procedurat për evakuim;
- marrëdhëniet me zjarrfikësen;
- pajisjet dhe sistemet e shuarjes;
- sisteme alarmi;
- shenjat e sigurisë;
- ndriçimi emergjent.

Moduli 3: Ushtrime praktike (3 orë)

- metodat më të zakonshme të shuarjes;
- rishikimi dhe sqarimet mbi pajisjet mbrojtëse personale;
- ushtrime për përdorimin e aparateve për fikjen e zjarrit dhe mënyrën e përdorimit të tubave dhe hidrantëve.

C. PROGRAMI I KURSIT TË TRAJNIMIT PËR SIGURINË NGA ZJARRI PËR AKTIVITETE ME RREZIK TË LARTË

Moduli 1: Zjarri dhe parandalimi (4 orë)

- parimet e djegies;
- shkaqet kryesore të zjarrit në lidhje me mjedisin specifik të punës;
- substancat shuarëse;

- rreziqet për njerëzit dhe mjedisin;
- masa specifike për parandalimin e zjarrit;
- masat e sjelljes për të parandaluar zjarret;
- rëndësia e kontrollit të vendit të punës;
- rëndësia e kontrolleve dhe mirëmbajtjes në pajisjet kundër zjarrit.

Moduli 2: Mbrojtja nga zjarri (4 orë)

- masat e mbrojtjes pasive;
- rrugët e arratisjes, ndarjet, distancat;
- pajisje dhe sistemet shuarëse - sisteme alarmi;
- shenjat e sigurisë;
- sisteme të sigurisë elektrike;
- ndriçimi i sigurisë.

Moduli 3: Procedurat që do të miratohen në rast zjarri (4 orë)

- procedurat që duhen marrë kur zbulohet një zjarr;
- procedurat që do të miratohen në rast alarmi;
- mënyra e evakuimit;
- si të telefononi shërbimet e urgjencës;
- bashkëpunimi me zjarrfikësen në rast ndërhyrjeje;
- ilustrimi i një situatë emergjente dhe metodave procedurale-operacionale.

Moduli 4: Ushtrime praktike (4 orë)

- pajisjet dhe sistemet kryesore të shuarjes;
- pasi të keni lexuar pajisjet mbrojtëse personale (maska, aparate frymëmarrjeje të pavarura, kostume, etj.);
- ushtrime për përdorimin e pajisjeve për shuarjen e zjarrit dhe mbrojtjen individuale.



Lidhja nr.1.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT
KOMISIONI I POSAÇËM

Nr. ____ prot.

Tiranë, më ____ .2024

CERTIFIKATË
EKSPERT ZJARRFIKËS PRIVAT
(Për kryerjen e aktekspertimeve për zjarret e rëna)

Nr. Vendimi ____, datë ____ .2024

NR.REGJ. PROFESIONAL ____

Mbiemri	
Emri	
Atësia	
Datëlindja	
Vendbanimi	
Diplomuar më datë:	
Titulli	
Regjistruar në regjistrin profesional:	



Fotografia

Z. Emër Mbiemër, certifikuar nga Komisioni i Posaçëm për klasifikimin e parashikuar nga shkronja "a" e pikës 1 të kreut I, të udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.64, datë 12.05.2022 "Për kriteret e veçanta të dhënies së certifikatës, për ushtrimin e aktivitetit të Ekspertit Privat në fushën MZSH mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", i ndryshuar.

KRYERJA E AKT-EKSPERTIMEVE PËR ZJARRET E RËNA

- Detyrat e ekspertit për përcaktimin e origjinës dhe shkakut të zjarrit bazohen në aspektin procedural, kryesisht në parashikimet e: Seksionin VI (Ekspertimi) të Kodit të Procedurës Penale dhe Kreu VI (Eksperti dhe Ekspertimi) të Kodit të Procedurës Civile.
- Funksionet kryesore të ekspertit të caktuar nga organi procedues, në kuadër të hetimit të zjarrit janë: studimi, hulumtimi, analiza për vlerësimin e shkaqeve të zjarrit, me qëllim sigurimin e mbështetjes kryesish për organet kompetente të policisë gjyqësore për aktivitetet hetimore në lidhje me ndodhjen e aksidenteve të karakterizuara nga zjarri.
 - Vlerësimi dhe analiza e vendit të ngjarjes: Eksperti i caktuar inspekton dhe dokumenton vendin ku ka ndodhur zjarri për të përcaktuar origjinën dhe mënyrën e përhapjes së tij.
 - Vlerësimi i provave: analizon prova fizike nga vendi i ngjarjes (zjarrit/shpërthimit) si mbetje, materiale djegëse, dhe sende të tjera që mund të ndihmojnë në përcaktimin e shkakut të zjarrit.
 - Fotografimi për të dokumentuar vendin dhe kushtet pas zjarrit, analizimi i procesverbaleve hetimore dhe dëshmi dhe palëve të përfshira, që mund të kenë informacione të rëndësishme për zjarren.
 - Analiza e shkakut të zjarrit, për të analizuar burimin e zjarrit dhe faktorët që kanë kontribuar në shpërthimin dhe përhapjen e tij.
 - Bashkëpunon me shërbimet e Policisë, shërbimet zjarrfikëse dhe agjencitë e sigurisë për të dhënë raportime dhe dëshmi teknike.
 - Përgatitja e raporteve për origjinën dhe shkakun e zjarrit, të cilat përdoren nga organet ligjore.
 - Në raste kur vlerësohet e nevojshme, eksperti mund të thirret për të dhënë dëshmi si ekspert në gjykatë, duke shpjeguar vlerësimet e tij teknike në lidhje me zjarren.
 - Përcaktimi i saktë i origjinës dhe shkakut të zjarrit, bazuar në prova dhe analiza shkencore.
 - Dokumentimi i saktë dhe i detajuar për çdo aspekt, duke përfshirë fotografitë, diagramet e vendit të zjarrit, dhe raportet e shkruara.
 - Përdorimi i standardeve dhe metodave shkencore, për të siguruar një hetim të paanshëm dhe të saktë.
 - Përgjegjësia për të qëndruar i përditësuar me teknologjitë dhe metodat e reja në fushën e hetimeve të zjarrit për të përmirësuar efikasitetin e punës.
 - Njohuri të thella teknike të thelluara mbi dinamikën e zjarrit, përfshirë mënyrën e përhapjes së tij, materialet djegëse, dhe faktorët që ndikojnë në shkaktimin dhe përhapjen e zjarreve.
 - Aftësi analitike dhe kritike, për të nxjerrë përfundime të sakta lidhur me origjinën dhe shkakun e zjarrit.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM



Lidhja nr.2,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BRENDSHMË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT
KOMISIONI I POSAÇËM

Nr. _____, prot.

Tiranë, më _____, 2024

CERTIFIKATË

EKSPERT ZJARRFIKËS PRIVAT

(Për hartimin e projekteve të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin)

Nr. Vendimi _____, datë _____, 2024

NR.REGJ. UNIK _____

Mbiemri	
Emri	
Atësia	
Datëlindja	
Vendbanimi	
Diplomuar më datë	
Titulli	
Regjistruar në Regjistrin profesional:	



Fotografia

Z. Emër Mbiemër, certifikuar nga Komisioni i Posaçëm për klasifikimin e parashikuar nga shkronja "b" e pikës 1 të kreut I, të udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.64, datë 12.05.2022 "Për kriteret e veçanta të dhënies së certifikatës, për ushtrimin e aktivitetit të Ekspertit Privat në fushën MZSH mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", i ndryshuar.

HARTIM I PROJEKTEVE TË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN

- Shërbimet që ofrohen nga ekspertë që pajisjen me certifikatë të tipit: "Për hartimin e dokumentacionit të projekteve teknike për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin" konsistojnë në:
- Hartimi i dokumentacionit të projektit dhe vizatimeve grafike (dizajni);
 - Studimet e fizibilitetit, buxhetet e investimeve për parandalimin, monitorimin dhe sistemet aktive dhe pasive të mbrojtjes nga zjarri në impiantet industriale;
 - Llogaritjet bazë të sistemeve të monitorimit dhe zbulimit të tymit, gazit dhe zjarrit, mbrojtjes aktive dhe pasive të zjarrit;
 - Vlerësimi i shkallës së sigurisë funksionale në lidhje me sistemet e zjarrit dhe gazit në lidhje me standardet e referencës (IEC IEC 61508 / CEI IEC 61511-1:2016);
 - Përkufizimi i planeve dhe ndërhyrjes sipas skenarëve të zjarrit të identifikuar nga analiza e rrezikut të zjarrit ose nga analiza e rrezikut të aksidenteve të mëdha;
 - Përgatitja e specifikimeve teknike për kërkesën e furnizimit të materialeve dhe pajisjeve për sistemet e mbrojtjes nga zjarri, si dhe asistencë teknike për vlerësimin teknik të ofertave;
 - Auditimet e projektit dhe përputhshmëria me rregulloret kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me sistemet e mbrojtjes nga zjarri;
 - Kontrolle praktike për efikasitetin dhe pajtueshmërinë me projektimin e sistemeve të mbrojtjes nga zjarri me ujë dhe shkumë, si dhe verifikimi hidraulik i rrjeteve hidrike dhe sistemeve të spërkatës (me mbështetjen e kodeve të llogaritjes së specializuara);
 - Asistencë për testet praktike të evakuimit nga aktivitetet me frekuentim të konsiderueshëm banorësh dhe zonat operative me referencë të veçantë në skenarët hipotetik të aksidenteve;
 - Analizat dhe aktivitetet e simulimit me kodet e llogaritjes së avancuar (p.sh. CFD) për verifikimin e performancës në rast zjarri si pjesë e qasjes së performancës ndaj Inxhinierisë së Zjarrit në përputhje me dispozitat e rregullave kombëtare dhe sipas standardeve ndërkombëtare referuese;
 - Kryerja e kontrolleve specifike për të përcaktuar rrezikun e zjarrit me qëllim identifikimin e "skenarëve të projektit", si dhe vlerësimi i rrezikut të zjarrit përmes sesioneve të analizave me aplikimin e metodologjive bashkëkohore;
 - Analizat dhe aktivitetet e simulimit me kodet llogaritëse të avancuara të ecurisë së sistemit të eksodit në kushtet e emergjencave;
 - Aktiviteti i analizës, simulimi me kodet specifike llogaritëse dhe verifikimi i performancës së sistemit të ndriçimit të zonave të aktivitetit të procesit dhe mjedisve të punës, me qëllim të verifikimit të operueshmërisë (gjithashtu në përputhje me standardet referuese) dhe me qëllim të verifikimit të disponueshmërisë së ndriçimit në kushtet e evakuimit emergjent;
 - Verifikimi i qëndrueshmërisë së ekipit emergjent të zjarrit në lidhje me skenarët e referencës së aksidentit dhe auditimi i planifikimit emergjent të zjarrit;
 - Aktivitetet e ekspertëve të zjarrit dhe mbështetja për përgatitjen e dokumentacionit teknik për qëllime të parandalimit të zjarrit kryhen edhe me përdorimin e Rregullave Teknike Horizontale, vertikale, në përputhje me standardet teknike për parandalimin e zjarrit;
 - Certifikimi i rezistencës ndaj zjarrit, pajtueshmëria rregullatore

DREJTORI I PËRGJITHSHËM



Lidhja nr.3,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E BRENDSHME

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT
KOMISIONI I POSAÇËM

Nr. _____ prot.

Tiranë, më _____, 2024

CERTIFIKATË

EKSPERT ZJARRFIKËS PRIVAT

(Për kryerjen e trajnimeve bazike në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin)

Nr. Vendimi _____, datë _____, 2024

NR.REGJ. PROFESIONAL _____

Mbiemri	
Emri	
Atësia	
Datëlindja	
Vendbanimi	
Diplomuar, më datë	
Titulli	
Regjistruar në regjistrin profesional:	



Fotografia

Z. Emër Mbiemër, certifikuar nga Komisioni i Posaçëm për klasifikimin e parashikuar nga shkronja "c" e pikës 1 të kreut I, të udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.64, datë 12.05.2022 "Për kriteret e veçanta të dhënies së certifikatës, për ushtrimin e aktivitetit të Ekspertit Privat në fushën MZSH mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", i ndryshuar.

TRAJNUES PËR NJOHURI BAZIKE NË FUSHËN E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN

Programi minimal i detyrueshëm i kursit të sigurisë nga zjarri është i bazuar në rrezikun e treguar në një fazë analize fillestare nëpërmjet "Hartimit të Dokumentit të Vlerësimit të Riskut (DVR). Klasifikimi në aktivitete me rrezik të ulët, të mesëm dhe të lartë. Përmbajtja minimale e kursit duhet të përfshijë trajtimin dhe parandalimin e zjarreve, mbrojtjen nga zjarri dhe procedurat që duhen miratuar në rast zjarri, sipas moduleve:

Moduli 1. Parandalimi i zjarrit

- Parimet e djegies
- Shkaqet kryesore të zjarrit në lidhje me mjedisin specifik të punës
- Substancat shuarëse
- Rreziqet për njerëzit dhe mjedisin
- Masat specifike të parandalimit të zjarrit
- Masat e sjelljes për parandalimin e zjarreve
- Rëndësia e kontrollit të mjediseve të punës
- Rëndësia e kontrolleve dhe mirëmbajtjes së pajisjeve kundër zjarrit

Moduli 2. Mbrojtja nga zjarri

- Masat e mbrojtjes pasive
- Rrugët e arratisjes, ndarjet, ndarjet
- Pajisjet dhe sistemet e fikjes
- Sistemet e alarmit
- Shenjat e sigurisë
- Sistemet elektrike të sigurisë
- Ndriçimi i sigurisë

Moduli 3. Procedurat që duhen miratuar në rast zjarri

- Procedurat që duhen miratuar kur zbulohet një zjarr
- Procedurat që duhen miratuar në rast alarmi
- Metodat e evakuimit
- Si të telefononi shërbimet e urgjencës
- Bashkëpunimi me zjarrfikësit në rast ndërhyrjeje
- Shembulli i një situatë emergjente dhe metodave procedurale-operacionale

Moduli 4. Ushtrime praktike

- Rishikim dhe sqarime mbi pajisjet dhe sistemet kryesore të fikjes së zjarrit.
- Pas ekzaminimit të pajisjeve mbrojtëse personale (maska, aparate të frymëmarrjes, kominoshe, etj.)
- Ushtrime për përdorimin e pajisjeve të fikjes së zjarrit dhe mbrojtjes personale

DREJTORI I PËRGJITHSHËM



Lidhja nr.4,



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN
KOMISIONI I POSAÇËM

Nr. _____, prot.

Tiranë, më _____, 2024

CERTIFIKATË**EKSPERT ZJARRFIKËS PRIVAT**

(Për kryerjen e trajnimeve të avancuara në fushën e sigurisë nga zjarri)

Nr. Vendimi _____, datë _____, 2024

NR.REGJ. PROFESIONAL _____

Mbiemri	
Emri	
Atësia	
Datëlindja	
Vendbanimi	
Diplomuar më datë	
Titulli	
Regjistruar në regjistrin profesional:	



Fotografia

Z/Znj. Emër Mbiemër, certifikuar nga Komisioni i Posaçëm për klasifikimin e parashikuar nga shkronja "ç" e pikës 1 të kreut I, të udhëzimit të Ministrit të Brendshëm nr.64, datë 12.05.2022 "Për kriteret e veçanta të dhënies se certifikatës, për ushtrimin e aktivitetit të Ekspertit Privat në fushën MZSH mbrojtjes nga zjarri dhe për shpëtimin", i ndryshuar.

TRAJNUES PËR NJOHURI TË AVANCUARA NË FUSHËN E MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIN

Programi minimal i detyrueshëm i kursit të sigurisë nga zjarri është i bazuar në rrezikun e treguar në një fazë analize fillestare nëpërmjet "Hartimit të Dokumentit të Vlerësimit të Riskut (DVR). Klasifikimi në aktivitete me rrezik të ulët, të mesëm dhe të lartë. Përmbajtja minimale e kursit duhet të përfshijë trajtimin dhe parandalimin e zjarreve, mbrojtjen nga zjarri dhe procedurat që duhen miratuar në rast zjarri, sipas moduleve:

Moduli 1. Parandalimi i zjarrit

- Parimet e dëgjies
- Shkaqet kryesore të zjarrit në lidhje me mjedisin specifik të punës
- Substancat shuarëse
- Rreziqet për njerëzit dhe mjedisin
- Masat specifike të parandalimit të zjarrit
- Masat e sjelljes për parandalimin e zjarreve
- Rëndësia e kontrollit të mjediseve të punës
- Rëndësia e kontrolleve dhe mirëmbajtjes së pajisjeve kundër zjarrit

Moduli 2. Mbrojtja nga zjarri

- Masat e mbrojtjes pasive
- Rrugët e arratisjes, ndarjet, ndarjet
- Pajisjet dhe sistemet e fikjes
- Sistemet e alarmit
- Shenjat e sigurisë
- Sistemet elektrike të sigurisë
- Ndriçimi i sigurisë

Moduli 3. Procedurat që duhen miratuar në rast zjarri

- Procedurat që duhen miratuar kur zbulohet një zjarr
- Procedurat që duhen miratuar në rast alarmi
- Metodat e evakuimit
- Si të telefononi shërbimet e urgjencës
- Bashkëpunimi me zjarrfikësit në rast ndërhyrjeje
- Shembulli i një situatë emergjente dhe metodave procedurale-operacionale

Moduli 4. Ushtrime praktike

- Rishikim dhe sqarime mbi pajisjet dhe sistemet kryesore të fikjes së zjarrit.
- Pas ekzaminimit të pajisjeve mbrojtëse personale (maska, aparate të frymëmarrjes, kominoshe, etj.)
- Ushtrime për përdorimin e pajisjeve të fikjes së zjarrit dhe mbrojtjes personale.

DREJTORI I PËRGJITHSHËM



URDHËR
Nr. 255, datë 5.11.2024

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR PËRCAKTIMIN E
PARASHIKIMEVE, PËR PAJISJET E
AVIONËVE TË KËRKUAR, PËR
PËRDORIMIN E HAPËSIRËS AJRORE
TË QIELLIT TË VETËM EVROPIAN
DHE RREGULLAT E OPERIMIT, NË
LIDHJE ME PËRDORIMIN E
HAPËSIRËS AJRORE TË QIELLIT TË
VETËM EVROPIAN”²**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, të nenit 81, pika 2, të ligjit nr. 96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”, në përputhje me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe në përputhje me ligjin nr. 9658, datë 18.12.2006, “Për ratifikimin e marrëveshjes shumëpalëshe ndërmjet Komunitetit Evropian dhe shteteve anëtare të tij, Republikës së Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Bullgarisë, Republikës së Kroacisë, Republikës së Maqedonisë, Republikës së Islandës, Republikës së Malit të Zi, Mbretërisë së Norvegjisë, Republikës së Rumanisë, Republikës së Serbisë dhe Misionit Administrativ të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, “Për krijimin e një zone të përbashkët të aviacionit evropian”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për përcaktimin e parashikimeve, për pajisjet e avionëve të kërkuar, për përdorimin e hapësirës ajrore të QIELLIT të Vetëm Evropian dhe rregullat e operimit, në lidhje me përdorimin e hapësirës ajrore të QIELLIT të Vetëm Evropian”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku**

RREGULLORE
PËR PËRCAKTIMIN E PARASHIKIMEVE,
PËR PAJISJET E AVIONËVE TË KËRKUAR,
PËR PËRDORIMIN E HAPËSIRËS AJRORE
TË QIELLIT TË VETËM EVROPIAN DHE
RREGULLAT E OPERIMIT NË LIDHJE ME
PËRDORIMIN E HAPËSIRËS AJRORE TË
QIELLIT TË VETËM EVROPIAN

Neni 1
Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Kjo rregullore përcakton rregullat e operimit, në lidhje me përdorimin e hapësirës ajrore dhe kërkesat për pajisjet e avionit të kërkuara për operimin e sigurt dhe uniform brenda hapësirës ajrore të QIELLIT të Vetëm Evropian.

2. Kjo rregullore do të zbatohet për operatorët e avionëve të përmendur në nenin 2(1), pikat “b”/“i” dhe “ii” dhe nenin 2(1), pika “c”, të VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, që përaftron rregulloren (BE) 2018/1139, që janë të angazhuar në trafikun ajror të përgjithshëm dhe operojnë në brenda ose jashtë hapësirës ajrore të QIELLIT të Vetëm Evropian.

Neni 2
Përkufizimet

Për qëllimet e kësaj rregulloreje, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:

1. “Njësia e kontrollit të trafikut ajror” (njësia ATC) nënkupton një term të përgjithshëm që tregon në mënyra të ndryshme, qendrën e kontrollit të

² Ky urdhër përaftron plotësisht rregulloren zbatuese të Komisionit (BE) 2023/1770, të datës 12 shtator 2023, për përcaktimin e parashikimeve për pajisjet e avionëve të kërkuar për përdorimin e hapësirës ajrore të QIELLIT të Vetëm Evropian dhe rregullat e operimit, në lidhje me përdorimin e hapësirës ajrore të QIELLIT të Vetëm Evropian dhe që

shfuqizon rregulloret (KE) nr. 29/2009 dhe rregulloret zbatuese (BE) nr. 1206/2011, (BE) nr. 1207/2011 dhe (BE) nr. 1079/2012, botuar në Fletoren Zyrtare të BE-së nr. 228, datë 15.9.2023.



zonës, njësinë e kontrollit të afrimit ose kullën e kontrollit të aerodromit;

2. “Shërbimi i lidhjes së të dhënave – shërbimi *data-link*” nënkupton një grup ndërveprimesh të lidhura me menaxhimin e trafikut ajror, të mbështetura nga komunikimet e *data-link* ajrore-tokësore, të cilat kanë një qëllim operacional të përcaktuar qartë dhe që fillojnë dhe përfundojnë në një ngjarje operationale;

3. “Operimi me transmetues sinjali shtesë të zhvendosur - *offset carrier operation*” nënkupton një rast kur mbulimi i caktuar operacional nuk mund të sigurohet nga një transmetues i vetëm tokësor dhe ku sinjalet me prejardhje nga dy ose më shumë transmetues tokësorë janë të zhvendosur nga frekuenca e qendrës së kanalit nominal për të minimizuar problemet e ndërhyrjes.

Neni 3

Pajisjet e avionit dhe rregullat e operimit

Operatorët e avionëve duhet të sigurojnë që avionët e tyre janë të pajisur dhe operohen në përputhje me rregullat dhe procedurat e përcaktuara në aneksin I (pjesa-COM) dhe aneksin II (pjesa-SUR).

Neni 4

Mjetet e përputhshmërisë

1. Agjencia zhvillon mjete të pranueshme të përputhshmërisë (AMC) që mund të përdoren për të përcaktuar pajtueshmërinë me rregulloren zbatuese të Komisionit (BE) 2023/1770, që përafrohet përmes kësaj rregulloreje, rregulloren (BE) 2018/1139, përafuar përmes VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil”, dhe aktet në zbatim të tij. Autoriteti i Aviacionit Civil pranon dhe publikon mjetet e pranueshme të përputhshmërisë të zhvilluara dhe nxjerra nga Agjencia, që mund të përdoren për të përcaktuar pajtueshmërinë me këtë rregullore, VKM-së nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe aktet në zbatim të tij ose mund të nxjerrë mjetet e tij të përputhshmërisë.

2. Mjetet alternative të përputhshmërisë mund të përdoren për të përcaktuar pajtueshmërinë me këtë rregullore.

3. Autoriteti i Aviacionit Civil krijon një sistem për të vlerësuar në mënyrë të vazhdueshme nëse mjetet alternative të përputhshmërisë të përdorura nga vetë ai ose nga organizatat nën mbikëqyrjen e tij përputhen me VKM-në nr. 1095, datë 24.12.2020, “Për miratimin e kërkesave thelbësore në fushën e aviacionit civil” dhe aktet në zbatim të tij.

4. Kur është e zbatueshme, Autoriteti i Aviacionit Civil informon Agjencinë për çdo mjet alternativ të përputhshmërisë të përdorur nga personat fizikë ose juridikë nën mbikëqyrjen e tij ose nga vetë ai për të përcaktuar pajtueshmërinë me këtë rregullore.

ANEKS I Komunikimi (Pjesa-COM)

AUR.COM.1001 Qëllimi

Kjo pjesë përcakton kërkesat për pajisjet e avionit dhe rregullat e operimit, në lidhje me përdorimin e hapësirës ajrore, duke mbuluar kërkesat e zbatueshme për shërbimet e *data-link* dhe hapësirën e kanaleve zanore.

KREU 1 – SHËRBIMET E LIDHJES SË TË DHËNAVE – *DATA-LINK*

AUR.COM.2001 Fushëveprimi

Ky kre zbatohet vetëm për fluturimet që operohen si trafik ajror i përgjithshëm, në përputhje me rregullat e fluturimit me instrument mbi FL 285 brenda hapësirës ajrore të Qiellit të Vetëm Evropian, duke përjashtuar hapësirën ajrore që nuk është pjesë e rajonit EUR të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO) dhe rajonit të Informacionit të Fluturimit të Lartë të Finlandës (UIR) në veri të 61°30', dhe UIR i Suedisë në veri të 61°30'.

AUR.COM.2005 Kërkesat për pajisjet e avionëve

1. Operatori i avionit duhet:

a) të sigurojë që çdo avion që operon të ketë aftësinë për të operuar shërbimet e mëposhtme të lidhjes së të dhënave:

i. Aftësia e Inicimit të Komunikimeve të Lidhjes së të Dhënave – *data-link*;

ii. Menaxhimi i Komunikimeve të Kontrollit të Trafikut Ajror (ATC);

iii. Autorizimi dhe informacioni i ATC-së;

iv. Kontrolli i mikrofonit ATC;



b) të marrë masat e duhura për të siguruar që shkëmbimi i të dhënave të mund të vendoset ndërmjet avionit të tij që ka aftësi lidhjeje të të dhënave dhe të gjitha njërive ATC që mund të kontrollojnë fluturimet që ai kryen, duke pasur parasysh kufizimet e mundshme të mbulimit, në lidhje me teknologjinë e komunikimit të përdorur.

2. Pika 1 nuk zbatohet për:

a) avionët me certifikatë individuale të vlefshmërisë ajrore të lëshuar për herë të parë përpara datës 1 janar 1995;

b) avionët me një certifikatë individuale të vlefshmërisë ajrore të lëshuar për herë të parë përpara datës 1 janar 2018 dhe të pajisur para kësaj date me një pajisje *data-link* që siguron ndërveprimin e aplikacioneve ATS mbi rrjetin ajror-tokësor të Sistemit të Adresimit dhe Raportimit të Komunikimit të Avionëve (ACARS), i përdorur kryesisht kur mbikëqyrja e radarit nuk është e praktikueshme;

c) avionët me kapacitet maksimal të certifikuar ndenjësesh prej 19 pasagjerësh ose më pak, dhe një kapacitet maksimal të certifikuar ngritjeje prej 45 359 kg (100 000 lb) ose më pak, dhe me një certifikatë individuale të vlefshmërisë ajrore të lëshuar për herë të parë përpara datës 5 shkurt 2020;

d) avionët që fluturojnë për testim, dorëzim ose për qëllime mirëmbajtjeje, ose me përbërës të lidhjes së të dhënave përkohësisht jofunksionale sipas kushteve të specifikuara në listën minimale të pajisjeve të zbatueshme;

e) kombinimet e llojeve dhe modeleve të avionëve të renditur në shtojcën I;

f) kombinimet e llojeve dhe modeleve të avionëve të renditur në shtojcën II, që kanë certifikatën e parë individuale të vlefshmërisë ajrore të lëshuar përpara datës 5 shkurt 2020.

AUR.COM.2010 Procedurat operative dhe trajnimi DLS

Operatorët e avionëve duhet të marrin masat e nevojshme për të siguruar që:

a) procedurat e tyre të operimit janë në përputhje me këtë kre dhe pasqyrohen në manualët e tyre të operimit; dhe

b) personeli që menaxhon pajisjet e lidhjes së të dhënave është informuar siç duhet në lidhje me këtë kre dhe është trajnuar në mënyrë të përshtatshme për funksionet e tyre të punës.

KREU 2 – HAPËSIRA E KANALIT ZANOR AUR.COM.3001 Fushëveprimi

Ky kre zbatohet vetëm për fluturimet që operohen si trafik ajror i përgjithshëm brenda hapësirës ajrore të Qiellit të Vetëm Evropian që është pjesë e rajonit EUR ICAO dhe ku ofrohen shërbimet e radiokomunikimit zanor ajër–tokë dhe tokë–tokë në brezin e frekuencave 117,975-137 MHz. Rajoni i Informacionit të Fluturimit Ishujt Kanarie (FIR)/UIR përjashtohet nga fusha e zbatimit.

AUR.COM.3005 Kërkesat për pajisjet e avionit

1. Operatorët e avionëve duhet të sigurojnë që të gjitha pajisjet e komunikimit zanor të vënë në shërbim pas datës 17 nëntor 2013, të përfshijnë aftësinë e ndarjes së kanaleve 8,33 kHz dhe të jenë në gjendje të sintonizohen në kanalet me distancë 25 kHz.

2. Përjashtimet nga detyrimi për të operuar një avion ku radioja kërkohet me pajisjet e saj radio që kanë aftësinë e ndarjes së kanaleve 8,33 kHz për rastet me ndikim të kufizuar në rrjet, të dhëna në përputhje me udhëzimin e ministrit nr. 21, datë 5.10.2010, “Mbi kriteret për ndarjet në kanale të komunikimeve zanore për Qiellin e Vetëm Evropian” apo të dhëna nga vendet anëtare të BE-së në përputhje me nenin 14(2) të rregullores zbatuese (BE) nr. 1079/2012, që i janë komunikuar Komisionit mbeten të vlefshme.

SHTOJCË I

Përjashtimet e përmendura në pikën “e” të AUR.COM.2005 (2)

Lloji i avionit/seria/modeli	Prodhuesi	Përcaktuesi i tipit ICAO
AN-12 të gjitha	Antonov	AN12
AN-124 100	Antonov	A124
IL-76 të gjitha	Ilyushin	IL76
A300 të gjitha	Airbus	A30B A306 A3ST



A310 të gjitha	Airbus	A310
A-319/-320/-321 me një certifikatë të parë të vlefshmërisë ajrore, të lëshuar midis 1 janarit 1995 dhe 5 korrikut 1999, përfshirëse	Airbus	A319 A320 A321
A340 të gjitha	Airbus	A342 A343 A345 A346
A318-112	Airbus	A318
AVROLINER (RJ-100)	AVRO	RJ1H
AVROLINER (RJ-85)	AVRO	RJ85
BA146-301	British Aerospace	B463
B717-200	Boeing	B712
B737-300	Boeing	B733
B737-400	Boeing	B734
B737-500	Boeing	B735
B747-400	Boeing	B744
B757-200	Boeing	B752
B757-300	Boeing	B753
B767-200	Boeing	B762
B767-300	Boeing	B763
B767-400	Boeing	B764
MD-82	Boeing	MD82
MD-83	Boeing	MD83
MD-11 të gjitha	Boeing	MD11
CL-600-2B19 (CRJ100/200/440)	Bombardier	CRJ1/CRJ2
Dornier 328-100	Dornier	D328
Dornier 328-300	Dornier	J328
Fokker 70	Fokker	F70
Fokker 100	Fokker	F100
King Air series (90/100/200/300)	Bëchcraft	BE9L BE20 B350
Hercules L-382-G-44K-30	Lockhëd	C130
SAAB 2000/SAAB SF2000	SAAB	SB20

SHTOJCË II

Përfshirjet e përmendura në pikën “F” të AUR.COM.2005 (2)

Lloji i avionit/seria/modeli	Prodhuesi	Përcaktuesi i tipit ICAO
Seria A330 200/300	Airbus	A332/A333
Global Express/5000 BD-700-1A10/1A11	Bombardier	GLEX/GL5T
CL-600-2C10 (CRJ-700)	Bombardier	CRJ7
C525C, CJ4	Cessna	C25C
C560XL (Citation XLS+)	Cessna	C56X
Falcon 2000 të gjitha	Dassault	F2TH
Falcon 900 të gjitha	Dassault	F900
EMB-500 (Phenom 100)	Embraer	E50P
EMB-505 (Phenom 300)	Embraer	E55P
EMB-135BJ (Legacy 600)	Embraer	E35L
EMB-135EJ (Legacy 650)	Embraer	E35L
EMB-145 (135/140/145)	Embraer	E135 E145, E45X
PC-12	Pilatus	PC12



ANEKS II
Mbikëqyrja
(Pjesa-SUR)

AUR.SUR.1001 Qëllimi

Kjo pjesë përcakton kërkesat për pajisjet e avionit dhe rregullat e operimit, në lidhje me përdorimin e hapësirës ajrore që mbulon kërkesat e zbatueshme për mbikëqyrjen.

KREU 1 – MBIKËQYRJA ME BASHKË-PUNIM, E NDËRVARUR

AUR.SUR.2001 Fushëveprimi

1. Ky kre zbatohet vetëm për fluturimet që operohen si trafik ajror i përgjithshëm, në përputhje me rregullat e fluturimit me instrument brenda hapësirës ajrore të Qiellit të Vetëm Evropian që është pjesë e rajonit EUR të Organizatës Ndërkombëtare të Aviacionit Civil (ICAO).

2. Pavarësisht paragrafit 1, pika AUR.SUR.2015 zbatohet për të gjitha fluturimet që operohen si trafik ajror i përgjithshëm.

AUR.SUR.2005 Kërkesat për pajisjet e avionëve

1. Operatorët e avionëve duhet të sigurojnë që:

a) avionët janë të pajisur me transponder të radarëve të mbikëqyrjes dytësore funksionale që janë në përputhje me kushtet e mëposhtme:

i. ato kanë aftësi për Mbikëqyrje Elementare në Mode S në ajër (ELS);

ii. ato kanë vazhdimësi të mjaftueshme për të shmangur paraqitjen e një rreziku operacional;

b) avionët me një masë maksimale të certifikuar ngritjeje që tejkalon 5 700 kg ose që kanë një kapacitet maksimal të shpejtësisë së vërtetë ajrore më të madhe se 250 kt, me një certifikatë individuale të vlefshmërisë ajrore të lëshuar për herë të parë më 7 qershor 1995 ose pas kësaj date, janë të pajisur me transponderë të radarëve të mbikëqyrjes dytësore funksionale që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

i. ato kanë kapacitetet për 1 090 MHz *Extended Squitter* (ES) me mbikëqyrje-transmetim automatik të varur (ADS-B) jashtë, përveç aftësive të përmendura në pikën “a”/“i”;

ii. ato kanë vazhdimësi të mjaftueshme për të shmangur paraqitjen e një rreziku operacional;

c) avionët me krahë fiks me një masë maksimale të certifikuar ngritjeje që tejkalon 5 700 kg ose që kanë një kapacitet maksimal të shpejtësisë së vërtetë ajrore më të madhe se 250 kt, me një certifikatë individuale të vlefshmërisë ajrore të lëshuar për herë

të parë më 7 qershor 1995 ose pas kësaj date, janë të pajisur me transponderë të radarëve të mbikëqyrjes dytësore funksionale që plotësojnë kushtet e mëposhtme:

i. ato kanë kapacitetet për Mbikëqyrjen e Avancuar të Mode S në ajër (EHS), përveç kapaciteteve të referuara në pikat “a”/“i” dhe “b”/“i”;

ii. ato kanë vazhdimësinë e mjaftueshme për të shmangur paraqitjen e një rreziku operacional.

2. Pikat 1/“b” dhe “c” nuk zbatohen për avionët që i përkasin njëres prej kategorive të mëposhtme:

a) avionët që fluturojnë për t’iu nënshtruar mirëmbajtjes;

b) avionët që fluturojnë për eksport;

c) avionët, aktiviteti i të cilëve do të përfundojë brenda datës 31 tetor 2025.

3. Operatorët e avionëve me një certifikatë individuale të vlefshmërisë ajrore të lëshuar për herë të parë përpara datës 7 dhjetor 2020, duhet të jenë në përputhje me pikat 1/“b” dhe “c”, duke iu nënshtruar kushteve të mëposhtme:

a) ata kanë krijuar përpara datës 7 dhjetor 2020 një program rinovimi që demonstroi pajtueshmërinë me pikat 1/“b” dhe “c”;

b) këta avionë nuk kanë përfituar nga asnjë financim i Bashkimit Evropian, i dhënë me qëllimin që këta avionë të jenë në përputhje me kërkesat e përcaktuara në pikat 1/“b” dhe “c”.

4. Operatorët e avionëve duhet të sigurojnë që avionët e pajisur në përputhje me pikat 1, 2 dhe 3, dhe me një masë maksimale të certifikuar ngritjeje që tejkalon 5 700 kg ose që kanë një kapacitet maksimal të shpejtësisë së vërtetë ajrore më të madhe se 250 kt, të operojnë me diversitet antenash.

AUR.SUR.2010 Transponderi jofunksional

Për avionët ku kapaciteti i transponderëve për të përmbushur kërkesat e përcaktuara në pikat 1/“b” dhe “c”, të pikës AUR.SUR.2005 është përkohësisht jofunksional, operatorët e avionëve do të kenë të drejtë t’i operojnë ato avionë për një maksimum prej 3 ditësh të njëpasnjëshme.

AUR.SUR.2015 Transponderi 24-bit, adresa ICAO e avionit

Operatorët e avionëve duhet të sigurojnë që në bordin e avionit që ata operojnë, çdo transponder i Mode S të operojë me një adresë avioni ICAO 24-bit që korrespondon me regjistrimin që është caktuar nga shteti në të cilin është regjistruar avioni.

**AUR.SUR.2020 Procedurat operative të mbikëqyrjes dhe trajnimit**

Operatorët e avionëve marrin masat e nevojshme për të siguruar që:

a) procedurat e tyre të operimit janë në përputhje me këtë kre dhe pasqyrohen në manualët e tyre të operimit; dhe

b) personeli që operon me pajisjet e mbikëqyrjes është informuar siç duhet në lidhje me këtë kre dhe është trajnuar në mënyrë të përshtatshme për funksionet e tyre të punës.

URDHËR

Nr. 281, datë 11.11.2024

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR NJËSITË E MATJES QË
PËRDOREN NË OPERIMET NË TOKË
DHE AJËR”³**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; nenit 84 të ligjit nr. 96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”; si dhe në zbatim të dekretit të presidentit nr. 7438, datë 1.12.1990, “Për aderimin në Konventën për Aviacionin Civil Ndërkombëtar (ICAO) dhe në protokollin për tekstin autentik tregjuhësh të kësaj Konvente”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e rregullore “Për njësitë e matjes që përdoren në operimet në tokë dhe ajër”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku**

RREGULLORE**PËR NJËSITË E MATJES QË PËRDOREN
NË OPERIMET NË TOKË DHE AJËR**

Neni 1

Përkufizimet

Termat, të cilat përdoren në këtë rregullore në lidhje me njësitë e matjes të përdorura në të gjitha aspektet e operimeve ndërkombëtare të aviacionit civil në tokë dhe ajër, kanë kuptimin e mëposhtëm:

1. Amper (A). Amperi është intensiteti i një rryme elektrike konstante, e cila, nëse mbahet në dy përçues të drejtë paralel me gjatësi të pafundme dhe të vendosur 1 metër larg njëri-tjetrit në një vakum, i cili do të prodhojë midis këtyre përçuesve një forcë të barabartë me 2×10^{-7} njuton për metër gjatësi.

2. Becquerel (Bq). Aktiviteti i një radionuklidi që ka një ndryshim spontan bërthamor për sekondë.

3. Candela (cd). Intensiteti i ndriçimit, në drejtim pingul, të një sipërfaqeje prej 1/600 000 metër katror të trupit të zi në temperaturën e ngurtësimit të platinut në një presion prej 101 325 njuton për metër katror.

4. Temperatura celcius ($^{\circ}\text{C}$) nënkupton temperaturë Celcius që është e barabartë me diferencën $t^{\circ}\text{C} = T - T_0$ mes dy temperaturave termodinamike T dhe T_0 ku T_0 është e barabartë me 273,15 Kelvin.

5. Kulombit (C) nënkupton sasinë e energjisë (ngarkesës) elektrike të transportuar në 1 sekondë nga një rrymë prej 1 amper.

6. Gradë celsius ($^{\circ}\text{C}$) nënkupton emrin e veçantë për njësinë kelvin, i përdorur për të përcaktuar vlerat e temperaturës celsius.

7. Farad (F) nënkupton kapacitetin e një kondensatori midis pllakave ku shfaqet një diferencë me fuqi 1 volt, kur ai është i ngarkuar me një sasi elektriciteti të barabartë me 1 kulomb.

8. Foot (ft) nënkupton gjatësinë e barabartë saktësisht me 0.3048 metër.

9. Gray (Gy) nënkupton energjinë e transmetuar nëpërmjet rrezatimit jonizues në një masë të materies që i korrespondon 1 xhaul për kilogram.

10. Henry (H) nënkupton induktivitetin e një qarku të mbyllur, në të cilën një forcë elektromotor

³ Kjo rregullore është në përputhje me aneksin 5, edicioni i 5-të, i Konventës për Aviacionin Civil Ndërkombëtar (ICAO).



prej 1 volt prodhohet kur rryma elektrike në qark ndryshon në mënyrë uniforme në një normë (shkallë) prej 1 amper për sekondë.

11. Hertz (Hz) nënkupton frekuencën e një fenomeni periodik në të cilin perioda është 1 sekondë.

12. Performanca njerëzore nënkupton aftësitë dhe kufizimet njerëzore të cilat kanë një ndikim në sigurinë dhe efikasitetin e operimeve aeronautike.

13. Xhaul (J) nënkupton punën e bërë, kur pika e përdorimit të një force prej 1 njuton është zhvendosur në një distancë prej 1 metër në drejtim të forcës.

14. Kelvin (K) nënkupton një njësi të temperaturës termodinamike, e cila është një fraksion $1/273.16$ i temperaturës termodinamike të pikës trefishe të ujit.

15. Kilogram (kg) nënkupton njësinë e masës së barabartë me masën e prototipit ndërkombëtar të kilogramit

16. Knot (KT) nënkupton shpejtësinë e barabartë me 1 milje nautike për orë.

17. Litër (L) nënkupton një njësi të kufizuar të vëllimit për matjen e lëngjeve dhe gazeve e cila është e barabartë me 1 decimetër kub.

18. Lumen (lm) nënkupton fluksin e dritës (shndritshëm/ndriçues) i lëshuar në një kënd të plotë prej 1 steradian nga një burim pike, duke pasur një intensitet uniform prej 1 candela.

19. Lux (lx) nënkupton dritën (ndriçimin) e prodhuar nga një fluks ndriçues prej 1 lumen e shpërndarë në mënyrë uniforme mbi një sipërfaqe prej 1 metër katror.

20. Metri (m) nënkupton distancën e përshkruar nga drita në një vakum përgjatë $1/299\,792\,458$ të një sekonde.

21. Mole (mol) nënkupton sasinë e substancës së një sistemi i cili përmban aq subjekte elementare sa janë atome në 0.012 kilogram karboni-12.

22. Milja nautike (NM) nënkupton gjatësinë e barabartë saktësisht me 1 852 metra.

23. Njuton (N) nënkupton forcën e cila kur aplikohet në një trup që ka një masë prej 1 kilogram i jep atij një përshpejtim prej 1 metër për sekondë në katror.

24. Ohm (Ω) nënkupton rezistencën elektrike midis dy pikave të një përcuesi, kur një ndryshim i vazhdueshëm me fuqi 1 volt aplikohet ndërmjet këtyre dy pikave prodhon në këtë përcues një rryme

prej 1 amper. Ky përcues nuk është burim i ndonjë force elektromotore.

25. Pascal (Pa) nënkupton presionin ose trysninë e 1 njutoni për metër katror.

26. Radian (rad) nënkupton këndin e rrafshët ndërmjet dy rrezeve të një rrethi i cili pret në perimenter një hark të barabartë me gjatësinë e rrezes.

27. Sekondë (s) nënkupton kohëzgjatjen e periudhës prej $9\,192\,631\,770$ të rrezatimit që korrespondon me ndryshimin ndërmjet dy niveleve hiperfin të formës bazë të atomit cezium-133.

28. Siemens (S), nënkupton përcueshmërinë elektrike të një përcuesi në të cilin një rryme prej 1 amper është prodhuar nga një diference fuqie elektrike prej 1 volti.

29. Sievert (Sv) nënkupton njësinë e dozës së rrezatimit që i korrespondon 1 xhauili për kilogram.

30. Steradian (sr) nënkupton këndin e ngurtë i cili duke pasur kulmin e tij në qendër të një sfere, pret një pjesë të sipërfaqes së sferës të barabartë me atë të një katrori me gjatësinë e anëve të barabartë me rrezen e sferës.

31. Tesla (T) nënkupton dendësinë e fluksit magnetik të dhënë nga një fluks magnetik prej 1 veber për metër katror.

32. Ton (t) nënkupton masën e barabartë me 1 000 kilogramë.

33. Volt (V) nënkupton njësinë e diferencës potenciale elektrike dhe të forcës (fuqisë) elektromotore e cila është diferenca e potencialit elektrik ndërmjet dy pikave të një përcuesi që mbart një rrymë konstante prej 1 amper kur fuqia e harxhuar ndërmjet këtyre pikave është e barabartë me 1 vat.

34. Vat (W) nënkupton fuqinë e cila korrespondon me prodhimin e energjisë në shkallën prej 1 xhaul për sekondë.

35. Weber (WbBB) nënkupton fluksin magnetik, i cili nëse kalon njëherë nëpër një qark, prodhon (indukton) në të, një forcë elektromotore prej 1 volti, ashtu siç do të reduktohej në zero në një shpejtësi uniforme në 1 sekondë.

Neni 2 Fusha e zbatimit

1. Kjo rregullore përmban specifikime për përdorimin e një sistemi të standardizuar të njësive matëse në operimet ajrore dhe tokësore të aviacionit civil ndërkombëtar. Ky sistem i standardizuar i



njësive matëse bazohet në Sistemi Ndërkombëtar të Njësive (SI) dhe disa njësi jo-SI që konsiderohen të nevojshme për të përmbushur kërkesat e specializuara të aviacionit civil ndërkombëtar.

2. Standardet dhe praktikat e rekomanduara të përfshira në këtë rregullore janë të zbatueshme për të gjithë aspektet e operimeve në tokë dhe ajër në aviacionin civil ndërkombëtar.

Neni 3

Aplikimi standard i njësive të matjes

3.1 Njësitë SI

3.1.1. Sistemi ndërkombëtar i njësive i zhvilluar dhe i mbajtur në Konferencën e Përgjithshme të

Matjeve dhe Peshave, subjekt i dispozitave 3.2 dhe 3.3 duhet të përdoret si sistemi standard i njësive të matjes në të gjitha fushat e operimeve në tokë dhe ajër të aviacionit civil ndërkombëtar.

3.1.2. Parashtesat dhe simbolet e listuara në tabelën 3.1 duhet të përdoren për të formuar emrat dhe simbolet për shumëfishat dhe nënfishat e njësive SI.

Shënim 1. Termi njësi SI ka për qëllim të përfshijë njësitë bazë dhe njësitë e prejardhura, si dhe shumëfishat e tyre dhe nënshumëfishat.

Shënim 2. Shihni shtojcën A për udhëzime mbi zbatimin e përgjithshëm të parashtesave.

Tabela 3.1. Parashtesat e njësive SI

Faktori i shumëfishimit Parashtesa Simboli

1 000 000 000 000 000 000	$=10^{18}$	exa	E
1 000 000 000 000 000	$=10^{15}$	peta	P
1 000 000 000 000	$=10^{12}$	tera	T
1 000 000 000	$=10^9$	giga	G
1 000 000	$=10^6$	mega	M
1 000	$=10^3$	kilo	K
100	$=10^2$	hecto	H
10	$=10^1$	deca	Da
0.1	$=10^{-1}$	deci	D
0.01	$=10^{-2}$	centi	C
0.001	$=10^{-3}$	milli	M
0.000 001	$=10^{-6}$	micro	μ
0.000 000 001	$=10^{-9}$	nano	n
0.000 000 000 001	$=10^{-12}$	pico	p
0.000 000 000 000 001	$=10^{-15}$	femto	f
	$=10^{-18}$	atto	a

3.2 Njësitë jo-SI

3.2.1. Njësitë jo-SI për përdorim të përhershëm me njësitë SI

Njësitë jo-SI të listuara në tabelën 3-2 duhet të përdoren në vend ose si shtesa të njësive SI, si njësi primare të matjes por vetëm siç specifikohet në tabelën 3-4.

Tabela 3-2. Njësitë jo-SI për përdorim me njësitë SI

<i>Sasitë specifike Në tabelën 3-4 të lidhura me</i>	<i>Njësia</i>	<i>Simboli</i>	<i>Përkufizimi</i>
Masa	Ton	T	$1\text{ t} = 10^3\text{ kg}$
Këndi i rrafshët	Gradë	$^\circ$	$1^\circ = (\pi/180)\text{ rad}$
	Minutë	'	$1' = (1/60)^\circ = (\pi/10\,800)\text{ rad}$
	Sekondë	"	$1'' = (1/60)' = (\pi/648\,000)\text{ rad}$



Temperature	Gradë celsius	°C	1 njësi °C = 1 njësi K ^{a)}
Koha	Minutë	min	1 min = 60 s
	Orë	h	1 h = 60 min = 3 600 s
	Ditë	d	1 d = 24 h = 86 400 s
	Javë, muaj, vit	—	
Vëllimi	Liter	L	1 L = 1 dm ³ = 10 ⁻³ m ³

a) Të shihet shtojca C, tabela C-2 për konvertimin

3.2.2. Njësitë alternative jo-SI të lejuara për përdorim të përkohshëm me njësitë SI

Njësitë jo-SI të renditura në tabelën 3-3 lejohen për përdorim të përkohshëm si njësi alternative matjeje por vetëm për ato njësi specifike të përcaktuara në tabelën 3-4.

Shënim. Synohet që përdorimi i njësive alternative jo-SI të listuara në tabelën 3-3 dhe të aplikuara siç tregohet në tabelën 3-4, të ndërpritet në përputhje me datat individuale të përfundimit të njësive të përcaktuara nga Këshilli i ICAO-s. Kur të përcaktohen datat përfundimtare, do të përfshihen në nenin 4.

3.3 Aplikimi (përdorimi) i njësive të veçanta

3.3.1. Aplikimi (përdorimi) i njësive të matjes për sasi të caktuara të përdorura në operimet në tokë dhe ajër në fushën e aviacionit civil ndërkombëtar duhet të jetë në përputhje me tabelën 3-4.

Shënim. Tabela 3-4 synon të ofrojë standardizimin e njësive (duke përfshirë parashtesat) për ato sasi të përdorura zakonisht në operimet ajrore dhe tokësore. Dispozitat bazë të rregullores aplikohen për njësitë që do të përdoren për sasi të që nuk janë të listuara.

3.3.2. Mënyrat dhe dispozitat për projektimin, procedurat dhe trajnimin duhet të përcaktohen për operimet në mjedise që përfshijnë përdorimin e alternativave standarde dhe jo – SI të njësive specifike të matjes ose ndryshimin ndërmjet mjediseve, duke përdorur njësi të ndryshme, duke marrë në konsideratë performancën njerëzore.

Tabela 3-3. Njësitë alternative jo-SI të lejuara për përdorim të përkohshëm me njësitë SI

Sasitë specifike në tabelën 3-4 të lidhura me	Njësia	Simboli	Përkufizimi (në terma të njësive SI)
Distanca (gjatësi)	Milje nautike	NM	1 NM = 1 852 m
Distanca (vertikale) ^{a)}	Këmbë (<i>foot</i>)	ft	1 ft = 0.304 8 m
Shpejtësia	Nyjë (<i>knot</i>)	kt	1 kt = 0.514 444 m/s

a) lartësia mbi sipërfaqen e detit referuar presionit barometrik, lartësia e një objekti mbi terren ose mbi sipërfaqen e detit, lartësia e një objekti, shpejtësia vertikale.

Tabela 3-4. Aplikimi standard i njësive të veçanta të matjes

Ref. Nr.	Sasia	Njësia primare (simboli)	Njësia alternative jo-SI (simboli)
1. Drejtim/hapësirë/kohë			
1.1	Lartësi	m	ft
1.2	Zonë	m ²	
1.3	Distanca (e gjatë) a)	km	NM
1.4	Distanca (e shkurtër)	m	
1.5	Lartësi nga niveli i detit	m	ft
1.6	Kohëzgjatja	h and min	
1.7	Lartësia	m	ft
1.8	Gjerësi gjeografike	° ' "	
1.9	Gjatësi	m	



1.10	Gjatësi gjeografike	° ' "
1.11	Këndi i rrafshët (kur kërkohet duhet të Përdoren nënndarjet dhjetore të gradës)	°
1.12	Gjatësia e pistës	m
1.13	Shikueshmëria e pistës	m
1.14	Kapaciteti i serbatorit (avionit) ^{b)}	L
1.15	Koha	s
		min
		h
		d
		javë

Ref. nr.	Sasia	Njësia primare (simboli)	Njësia alternative jo-SI (simboli)
		muaj	
		vit	
1.16	Shikueshmëria ^{c)}	km	
1.17	Volumi	m ³	
1.18	Drejtimi i erës (drejtimet e erës si për ulje dhe ngritje do të jetë shprehur në grade magnetike)	°	

2. Lidhur me masën

2.1	Densiteti ajrit	kg/m ³
2.2	Densiteti i hapësirës	kg/m ²
2.3	Kapaciteti i ngarkesës	kg
2.4	Densiteti i ngarkesës	kg/m ³
2.5	Densiteti (densiteti i masës)	kg/m ³
2.6	Kapaciteti i karburantit	kg
2.7	Densiteti i gazit	kg/m ³
2.8	Pesha bruto ose ngarkesa e nevojshme	kg
		t
2.9	Parashikimi për ngritje	kg
2.10	Densiteti linear	kg/m
2.11	Densiteti i lëngshëm	kg/m ³
2.12	Masa	kg
2.13	Momenti i inercisë	kg · m ²
2.14	Momenti i nxitimit	kg · m ² /s
2.15	Nxitimi	kg · m/s

3. Lidhur me forcën

3.1	Presioni i ajrit (e përgjithshme)	kPa
3.2	Matësi i lartësisë	hPa
3.3	Presioni atmosferik	hPa
3.4	Momenti i përkuljes	kN · m
3.5	Forca	N
3.6	Presioni i furnizimit me karburant	kPa
3.7	Presioni hidraulik	kPa
3.8	Modul elasticiteti	MPa
3.9	Presioni	kPa
3.10	Sforcimi	MPa
3.11	Tension sipërfaqësor	mN/m
3.12	Shtytje	kN
3.13	Momenti i përdredhjes	N · m
3.14	Vakum (boshllëk)	Pa

4. Mekanika

4.1	Shpejtësia në ajër ^{d)}	km/h	kt
4.2	Nxitimi (përshpejtimi) këndor	rad/s ²	
4.3	Shpejtësia këndore	rad/s	
4.4	Energjia ose puna	J	
4.5	Fuqia ekuivalente e boshtit	kW	



4.6	Frekuenca	Hz	
4.7	Shpejtësia në tokë	km/h	kt
4.8	Impakti	J/m ²	
<i>Ref. nr.</i>	<i>Sasia</i>	<i>Njësia primare (simboli)</i>	<i>Njësia alternative jo-SI (simboli)</i>
4.9	Energjia kinetike e frenimit	MJ	
4.10	Përsheptimi linear	m/s ²	
4.11	Fuqia	kW	
4.12	Norma e pjerrësisë	°/s	
4.13	Fuqia e boshtit	kW	
4.14	Shpejtësia	m/s	
4.15	Shpejtësia vertikale	m/s	ft/min
4.16	Shpejtësia e erës ^{e)}	m/s	kt
5. Rrjedha (fluksi)			
5.1	Rrjedha (Fluksi) e ajrit në motor	kg/s	
5.2	Rrjedha (Fluksi) e ujit në motor	kg/h	
5.3	Konsumi i karburantit (specifik)		
	Motorët me pistona	kg/ (kW · h)	
	Motorët me bosht-turbo	kg/ (kW · h)	
	Motorët reaktiv	kg/ (kN · h)	
5.4	Rrjedha e karburantit	kg/h	
5.5	<i>Fuel tank filling rate</i> (gravimetric)	kg/min	
5.6	Rrjedha e gazit	kg/s	
5.7	Rrjedha e lëngut (gravimetrike)	g/s	
5.8	Rrjedha e lëngut (volumetrike)	L/s	
5.9	Rrjedha e masës	kg/s	
5.10	Konsumi i vajit		
	Turbinë (motor) me gaz	kg/h	
	Motor me pistona	g/ (kW · h)	
5.11	Rrjedha e vajit	g/s	
5.12	Kapaciteti i pompës	L/min	
5.13	Ventilimi i rrjedhës së ajrit	m ³ /min	
5.14	Viskoziteti (dinamik)	Pa · s	
5.15	Viskoziteti (kinematik)	m ² /s	
6. Termodinamika			
6.1	Koeficienti i transferimit të nxehtësisë	W/ (m ² · K)	
6.2	Fluksi i nxehtësisë për njësi sipërfaqe	J/m ²	
6.3	Shkalla e fluksit të nxehtësisë	W	
6.4	Lagështia (absolute)	g/kg	
6.5	koeficienti i shpërndarjes lineare	°C ⁻¹	
6.6	Sasia e nxehtësisë	J	
6.7	Temperatura	°C	
7. Elektriciteti dhe magnetizimi			
7.1	Vëllimi (kapaciteti)	F	
7.2	Përçellshmëri	S	
7.3	Përçueshmëri	S/m	
7.4	Densiteti i rrymës	A/m ²	
7.5	Rryma elektrike	A	
7.6	Forca e fushës elektrike	C/m ²	
7.7	Potenciali elektrik	V	
7.8	Forca e elektromotorit	V	
7.9	Forca e fushës magnetike	A/m	
7.10	Fluksi magnetik	Wb	
7.11	Dendësia e fluksit magnetik	T	
7.12	Fuqia	W	
7.13	Sasia e elektricitetit	C	
7.14	Rezistenca	Ω	
8. Drita dhe rrezatimi elektromagnetik			
8.1	Shkëlqimi	lx	
8.2	Ndriçimi	cd/m ²	



8.3	Ndriçimi në dalje	lm/m ²
8.4	Fluksi i ndriçimi	lm
8.5	Intensiteti i ndriçimit	cd
8.6	Sasia e ndriçimit	lm · s
8.7	Energjia rrezatuese	J
8.8	Gjatësia e valës	m

9. Akustika

9.1	Frekuenca	Hz
9.2	Dendësia e masës	kg/m ³
9.3	Niveli i zhurmave	dBe)
9.4	Periudha (koha periodike)	s
9.5	Intensiteti i tingullit	W/m ²
9.6	Fuqia e tingullit	W
9.7	Presion i tingullit	Pa
9.8	Niveli i tingullit	dBf)
9.9	Presioni statik (i menjëhershëm)	Pa
9.10	Shpejtësia e zërit	m/s
9.11	Shpejtësia e volumit (i menjëhershëm)	m ³ /s
9.12	Gjatësia e valës	m

10. Fizika nukleare dhe rrezatimi jonizues

10.1	Sasia e përthithjes	Gy
10.2	Shkalla e sasisë së përthithjes s	Gy/
10.3	Aktiviteti radionukleik	Bq
10.4	Ekuivalenti i sasisë	Sv
10.5	Ekspozimi ndaj rrezatimit	C/kg
10.6	Shkalla e ekspozimit	C/kg · s

- a) Zakonisht siç përdoret në lundrimin ajror, përgjithësisht më e madhe se 4 000 m.
b) Të tilla si karburanti për avionët, lëngjet hidraulike, uji, vaji dhe mbajtësit e oksigjenit me presion të lartë.
c) Dukshmëria më e ulët se 5 km mund të matet në m.
d) Shpejtësia në ajër ndonjëherë në fluturim raportohet me numrin MACH.
e) Konvertim i 1 kt = 0.5 m/s është përdorur në Anekset e ICAO-s për të shfaqur shpejtësinë e erës.
f) Decibeli (dB) është një raport i cili mund të përdoret si njësi për të shprehur nivelin e presionit dhe fuqisë së zërit (tingullit). Kur përdoret është e nevojshme të specifikohet niveli i referencës.

Neni 4

Përfundimi i përdorimit të njësive alternative jo-SI

Shënim hyrës. Njësitë jo-SI të listuara në tabelën 3-3 janë mbajtur përkohësisht për përdorim si njësi alternative, për shkak të përdorimit të tyre të gjerë dhe për të shmangur problemet e mundshme të sigurisë, të cilat mund të vijnë si mungesë e koordinimit ndërkombëtar lidhur me ndërprerjen e përdorimit të tyre. Kur datat e ndërprerjes të përcaktohen nga këshilli i ICAO-së, ato do të pasqyrohen si standardet e përmbajtura në këtë nen. Pritet që përcaktimi i këtyre datave të bëhet mirë përpara ndërprerjes aktuale.

4.1. Përdorimi në operimet e aviacionit civil ndërkombëtar të njësive alternative jo-SI të renditura në tabelën 3-3 do të përfundojë në datat e përcaktuara në tabelën 4-1.

Tabela 4-1. Datat e përfundimit për njësitë alternative jo-SI

Njësitë alternative jo-SI	Data e përfundimit
Nyjë (Knot)	Nuk është përcaktuar ^{a)}
Milje nautike	
Këmbë (foot)	Nuk është përcaktuar ^{b)}

a) Nuk është përcaktuar ende një datë përfundimi për përdorimin e miljeve detare dhe nyjeve ("knot")

b) Nuk është përcaktuar ende një datë përfundimi për përdorimin e "foot".

SHTOJCA A
UDHËZIME PËR ZBATIMIN E SI-së**1. Hyrje**

1.1 Sistemi Ndërkombëtar i Njësive është një sistemi i plotë, koherent i cili përfshin tri klasa të njësive:

- a) njësitë bazë;
- b) njësitë plotësuese;
- c) njësitë e derivuara (prejardhura).

1.2 SI është i bazuar në shtatë njësi të cilat janë dimensionalisht të pavarura dhe janë të shënuara në tabelën A-1.

1.3 Njësitë plotësuese të SI-së janë të shënuara në tabelën A-2 dhe mund të konsiderohen si njësi bazë ose si njësi të derivuara.

Tabela A-1. SI njësitë bazë

<i>Sasia</i>	<i>Njësia</i>	<i>Simboli</i>
Sasia e një substance	Mol	mol
Rryma elektrike	Amper	A
Gjatësia	Metër	m
Intensiteti i ndriçimit	Candela	cd
Masa	Kilogram	kg
Temperatura termodinamike	Kelvin	K
Koha	Sekondë	s

Tabela A-2. SI njësitë plotësuese

<i>Sasia</i>	<i>Njësia</i>	<i>Simboli</i>
Këndi i rrafshët	Radian	rad
Kënd i plotë	Steradian	sr

1.4 Njësitë e derivuara SI formohen nga kombinimi i njësive bazë, njësive shtesë dhe njësive të tjera të derivuara sipas marrëdhënieve algjebrike që lidhin sasitë përkatëse. Simbolet për njësitë e derivuara janë marrë me anë të shenjave matematikore për shumëzimin, pjesëtimin dhe përdorimin e eksponentëve. Këto njësi të derivuara SI, të cilat kanë emra dhe simbole të veçanta janë të shënuara në tabelën A-3

Zbatimi specifik i njësive të derivuara të shënuara në tabelën A-3 dhe njësitë e tjera të përbashkëta me operimet e aviacionit civil ndërkombëtar janë dhënë në tabelën 3-4.

Tabela A-3. Njësitë e derivuara SI me emra special

<i>Sasia</i>	<i>Njësia</i>	<i>Simboli</i>	<i>Derivanti</i>
Sasia e përthithur (rrezatim)	Gray	Gy	J/kg
Aktiviteti i radionukloideve	Becquerel	Bq	1/s
Vëllimi	Farad	F	C/V
Përcjellshmëri	Siemens	S	A/V
Doza ekuivalente (rrezatim)	Sievert	Sv	J/kg
Potencial elektrik, diferencë potenciali, forca Elektromotore	Volt	V	W/A



Rezistencë elektrike	Ohm	Ω	V/A
Energji, punë, sasia e nxehtësisë	Joule	J	N · m
Forca	Newton	N	kg · m/s ²
Frekuenca (e një fenomeni periodik)	Hertz	Hz	1/s
Ndriçimi	Lux	lx	lm/m ²
Induktiviteti	Henry	H	Wb/A
Fluksi i ndriçimit	Lumen	lm	cd · sr
Fluksi magnetik	Weber	Wb	V · s
Dendësia e fluksit magnetik	Tesla	T	Wb/m ²
Fuqia, fluksi rrezatues	Watt	W	J/s
Presioni, shtypja	Pascal	Pa	N/m ²
Sasia e elektricitetit, ngarkesa elektrike	Coulomb	C	A · s

1.5 SI është një përzgjedhje e racionalizuar e njësive nga sistemi metrik të cilat individualisht nuk janë të reja. Avantazhi më i madh i SI-së është se për çdo masë fizike ka vetëm një njësi fizike- metri për gjatësinë, kilogrami (në vend të gramit) për peshën, sekondë për kohën etj. Nga këto njësi elementare apo bazike, njësitë për të gjitha sasitë mekanike janë të derivuara. Këto njësi të derivuara janë të përkufizuara nga marrëdhënie të thjeshta siç janë për shembull shpejtësia e barabartë me shkallën e ndryshimit të distancës, përshpejtimi i barabartë me shkallën e ndryshimit të shpejtësisë, forca është produkt i masës dhe përshpejtim, puna ose energjia është produkt i forcës dhe distancës, fuqia është puna e bërë për njësinë e kohës etj. Disa nga këto njësi kanë vetëm emra të përgjithshëm si për shembull metër për sekondë për shpejtësinë; të tjerat kanë emra të veçantë si njutoni (N) për forcën, xhaul (J) për punën ose energjinë, vat (V) për fuqinë. Njësitë e SI-së për forcën, energjinë dhe fuqinë janë të njëjta pavarësisht nëse procesi është mekanik, elektrik, kimik apo bërthamor. Forca për një njuton e aplikuar për një distancë prej një metri mund të prodhojë një xhaul nxehtësi, i cili është identik me atë çfarë prodhon një vat i fuqisë elektrike në një sekondë.

1.6 Avantazhet e SI-së, të cilat rezultojnë nga përdorimi i një njësie të veçantë për çdo masë fizike, janë ato që rrjedhin nga përdorimi i një grupi unik dhe të mirëpërcaktuar të simboleve dhe shkurtimeve. Simbolet dhe shkurtimet e tilla eliminojnë ngatërresa që mund të lindin nga praktikatat aktuale në disiplina të ndryshme të tilla, siç mund të jetë përdorimi i “b” për dy njësi, bar (njësi e presionit) dhe barn (njësi e hapësirës).

1.7 Një tjetër avantazh i SI-së është mbajtja e lidhjes dhjetore mes shumëfishave dhe nënfishave të njësive bazë për çdo masë fizike. Prefikset janë krijuar për të përcaktuar njësitë shumëfishe dhe nënfishë nga “Exa” (10^{18}) deri në “atto” (10^{-18}) për lehtësi në të shkruar dhe të folur.

1.8 Një avantazh tjetër i madh i SI-së është lidhja logjike. Njësitë mund të zgjidhen në mënyrë rastësore, por duke bërë një zgjedhje të pavarur të një njësie për çdo kategori të masave reciprokisht të krahasueshme do të na çojë në përgjithësi në shfaqjen e disa faktorëve shtesë numerikë në ekuacionet midis vlerave numerike. Është e mundur dhe më e përshtatshme që në praktikë, të zgjidhet një sistem i njësive në një mënyrë të tillë që ekuacionet midis vlerave numerike, duke përfshirë faktorët numerike, të kenë saktësisht të njëjtën formë si ekuacionet përkatëse mes sasive. Një sistem i njësive i përcaktuar në këtë mënyrë quhet koherent në lidhje (në krahasim) me sistemin e sasive dhe ekuacioneve në fjalë. Ekuacionet ndërmjet njësive të një sistemi koherent përmbajnë si faktor numerik vetëm numrin 1. Në një sistem koherent produkti ose herësi (koeficienti) i çdo dy sasive është njësia e sasisë që rezulton. Për shembull, në çdo sistem koherent, njësia e sipërfaqes rezulton kur njësia e gjatësisë shumëzohet me njësinë e shpejtësisë, njësia e shpejtësisë kur njësia e gjatësisë ndahet me njësi kohe dhe njësia e forcës kur njësia e masës shumëzohet me njësinë e përshpejtim.

Figura A-1 ilustron marrëdhënien e njësive SI.

2. Masa, forca dhe pesha

2.1 Pikënisja e SI-së nga sistemi gravimetrik i njësive metrike inxhinierike është përdorimi i dallueshëm i njësive së masës dhe forcës. Në SI, emri kilogram është i kufizuar me njësinë e masës dhe kilogram-forcë (në praktikë prapashtesa forcë shpesh ka rezultuar e gabuar) nuk duhet përdorur. Në vend të njësive



së forcës SI përdoret njutoni. Në mënyrë të ngjashme njutoni në vend të kilogram-forcës është përdorur për të formuar njësi të derivuara, të cilat përfshijnë forcën, për shembull presionin ose shtypjen (sforcimin) ($\text{N}/\text{m}^2 = \text{Pa}$), energjia ($\text{N} \cdot \text{m} = \text{J}$), dhe fuqia ($\text{N} \cdot \text{m}/\text{s} = \text{W}$).

2.2 Konfuzion i konsiderueshëm ekziston në përdorimin e termit peshë si një sasi që nënkupton ose forcë ose masë. Në përdorim të zakonshëm, termi peshë pothuajse gjithmonë nënkupton masën; kështu që kur dikush flet për peshën e një personi, madhësia (sasia) e së cilës i referohemi është masa. Në shkencë dhe në teknologji, termi peshë e një trupi zakonisht nënkupton forcën që nëse zbatohet në trup do t'i jepte një përshpejtim të barabartë me përshpejtimin lokal të rënies së lirë. Mbiemri “lokal” në frazën “përshpejtimi lokal i rënies së lirë” zakonisht nënkupton një vend në sipërfaqen e tokës; në këtë kontekst “përshpejtimi lokal i rënies së lirë” ka simbolin “g” (ndonjëherë referuar si “përshpejtimi i gravitetit”) me vlerat e vëzhguara të g-së që ndryshojnë me mbi 0.5 për qind në pika të ndryshme në sipërfaqen e tokës dhe duke u zvogëluar me rritjen e distancës nga toka.

Meqenëse pesha është forcë = masë x përshpejtim për shkak të gravitetit, pesha e një personi është e kushtëzuar nga vendndodhja e personit, ndërkohë që masa nuk është. Një person me masë prej 70 kg mund të përjetojë në tokë një forcë (peshë) prej 686 njuton ($\approx 155 \text{ lbf}$) dhe një forcë (peshë) prej vetëm 113 njuton ($\approx 22 \text{ lbf}$) në hënë. Për shkak të përdorimit të dyfishtë të termit peshë si sasi, ai duhet të shmanget nga përdorimi teknik përveç rrethanave në të cilat kuptimi është plotësisht i qartë. Kur termi përdoret është e rëndësishme të dihet se nëse masa ose forca ka për qëllim përdorimin korrekt të njësive SI, duke përdorur kilogramët për masën dhe njutonin për forcën.

2.3. Graviteti është përfshirë në përcaktimin e masës me balancë ose shkallë. Kur një masë standarde është përdorur për të balancuar masën e matur, efekti i drejtpërdrejtë i gravitetit në të dy masat anulohet, por efekti indirekt nëpërmjet shtytjes/pluskimit të ajrit ose lëngjeve të tjerë zakonisht nuk anulohet. Në përdorimin e një dinamometri, masa matet në mënyrë indirekte, pasi instrumenti i përgjigjet forcës së gravitetit. Një pajisje e tillë mund të jetë e kalibruar në njësitë e masës, nëse ndryshimi në përshpejtimin e gravitetit dhe korigjimet e pluskimit nuk janë të rëndësishme në përdorimin e tyre.

3. Energjia dhe forca rrotulluese

3.1 Produkti vektorial i krahut të forcës dhe të momentit përcaktohet gjerësisht nga njësia njuton metër. Kjo njësi për momentin e përkuljes apo forcës rrotulluese, mund të ngatërrohet me njësinë e energjisë, e cila është gjithashtu njuton metër. Nëse forca rrotulluese është shprehur si njuton metër për radian me energjinë është e qartë, pasi produkti i forcës rrotulluese dhe rrotullimi këndor është energjia:

$$(\text{N} \cdot \text{m} / \text{rad}) \cdot \text{rad} = \text{N} \cdot \text{m}$$

3.2 Nëse vektorët do të shfaqeshin, dallimi ndërmjet energjisë dhe forcës rrotulluese do të ishte i qartë, pasi orientimi i forcës dhe gjatësisë është i ndryshëm në të dyja rastet. Është e rëndësishme që të njohim këtë ndryshim në përdorimin e forcës rrotulluese dhe energjisë, gjë që sjell xhaurin të mos përdoret kurrë për forcën rrotulluese.

4. Parashtesat e SI-së

4.1 Përzgjedhja e parashtesave

4.1.1 Në përgjithësi parashtesat e SI-së duhet të përdoren për të treguar rendin e madhësisë, duke eliminuar shifrat jodomethënëse dhe duke çuar në zero fraksionet dhjetore, si dhe duke siguruar një alternativë të përshtatshme për nocionin e fuqive të të dhjetës që preferohen në llogaritje. Për shembull:

12 300 mm bëhet 12.3 m
 $12.3 \times 10^3 \text{ m}$ bëhet 12.3 km
 0.001 23 μA bëhet 1.23 nA

4.1.2 Kur shprehim një sasi me një vlerë numerike dhe njësi, mundësisht parashtesat duhet të zgjidhen në mënyrë që vlera numerike të jetë midis intervalit 0,1 dhe 1 000. Për të minimizuar shumëllojshmërinë,

duhet të përdoren parashtesat që përfaqësojnë fuqitë e 1 000. Megjithatë, në rastet e mëposhtme, mund të anashkalohet nga sa më sipër:

a) në shprehjen e sipërfaqes dhe vëllimit mund të kërkohen, parashtesat hecto, deca, deci dhe centi: për shembull, katror, hektometër, centimetër kub;

b) në tabelat e vlerave të së njëjtës sasi, ose në një diskutim rreth vlerave të tilla brenda një konteksti të caktuar, në përgjithësi është e preferueshme të përdoren shumëfisha të së njëjtës njësi;

c) për sasi të caktuara në aplikime të veçanta, zakonisht përdoret një shumëfish i veçantë. Për shembull, hektopaskali përdoret për cilësimet e lartësi-matësit dhe milimetri është përdorur për dimensionet lineare në vizatimet e inxhinierisë mekanike edhe kur vlerat shtrihen jashtë gamës 0.1-1 000.

4.2 Parashtesat në njësi të përbëra⁴

Është e rekomanduar që vetëm një parashtesë të përdoret në formimin e një shumëfishi të një njësie të përbërë. Normalisht parashtesa duhet të jetë e bashkangjitur te një njësi në numërues. Një përjashtim për këtë ndodh kur kilogrami është një nga njësitë. Për shembull:

V/m , *not* mV/mm ; MJ/kg , *not* kJ/g

4.3 Parashtesat e përbëra

Parashtesa të përbëra, të formuara nga ballafaqimi (afrimi) i dy ose më shumë parashtesave SI, nuk duhet të përdoren. Për shembull:

1 nm *not* 1 μ m; 1 pF *not* 1 μ μ F

Nëse vlerat kërkohen jashtë fushës së mbuluar nga parashtesat, ata duhet të shfaqen duke përdorur fuqitë e dhjeta të aplikuar për njësinë bazë.




Figura A-1

⁴ Një njësi e përbërë është një njësi e derivuar e shprehur në termat e dy ose më shumë njësive, që nuk është shprehur me një emër të vetëm të veçantë.



4.4 Fuqitë e njësive

Një eksponent i bashkangjitur të një simbol i cili përmban një prefiks tregon se shumëfishi ose nënshumëfishi i njësisë (njësia me prefiksin e saj) është i ngritur në fuqinë e shprehur nga eksponenti. Për shembull:

$$\begin{aligned} 1 \text{ cm}^3 &= (10^{-2} \text{ m})^3 = 10^{-6} \text{ m}^3 \\ 1 \text{ ns}^{-1} &= (10^{-9} \text{ s})^{-1} = 10^9 \text{ s}^{-1} \\ 1 \text{ mm}^2/\text{s} &= (10^{-3} \text{ m})^2/\text{s} = 10^{-6} \text{ m}^2/\text{s} \end{aligned}$$

5. Stili dhe përdorimi

5.1 Rregullat për shkrimin e simboleve të njësive

5.1.1 Simbolet e njësive duhet të jenë të shtypura në karakterin Roman (në pozicion vertikal), pavarësisht nga stili i përdorur në tekstet e tjera.

5.1.2 Simbolet e njësive janë të pandryshuara në shumës.

5.1.3 Simbolet e njësive nuk shoqërohen nga shenja e pikësimit pikë, përveç se kur përdoret në fund të fjalisë.

5.1.4 Germat e simboleve të njësive janë të shkruara me germa të vogla (cd), vetëm nëse emri i njësisë ka rrjedhur nga një emër i veçantë, në këtë rast shkronja e parë e simbolit është e madhe (W, Pa). Parashtesa dhe simbolet e njësisë ruajnë formën e tyre të përcaktuar, pavarësisht nga tipografia përreth.

5.1.5 Në shprehjen e plotë për sasinë, duhet lënë një hapësirë mes vlerës numerike dhe simbolit të njësisë. Për shembull shkruaj 35 mm dhe jo 35 mm, 2.37 lm dhe jo 2.37 lm. Kur sasia është përdorur në formën e një mbiemri, një vizë ndarëse përdoret shpesh, për shembull, 35-mm film.

Përfundim. Nuk lihet hapësirë midis vlerës numerike dhe simbolit për shkallën numerike, minutë, këndit të rrafshët si dhe gradë celsiusit.

5.1.6 Nuk përdoret hapësirë mes parashtesës dhe simboleve të njësisë.

5.1.7 Simbolet, jo shkurtesat, duhet të përdoren për njësitë. Për shembull, për amperin do të përdoret “A” dhe jo “amp”.

5.2 Rregullat për shkrimin e emrave të njësive

5.2.1 Emrat e njësive trajtohen si emra të përbashkët në anglisht. Kështu që germa e parë e njësisë nuk shkruhet me të mëdha, me përjashtim të ndonjë fjalie ose në tituj, edhe pse njësia e emërtuar mund të jetë e prejardhur nga një emër i përveçëm dhe për këtë mund të përfaqësohet si simbol me një germë të madhe (shiko 5.1.4). Për shembull, normalisht shkruhet “njuton” dhe jo “Njuton” edhe pse simboli është N.

5.2.2 Në shumës përdoren kur kërkohet nga rregullat e gramatikës dhe janë të formuara rregullisht, për shembull:

<i>Singular (njëjës)</i>	<i>Plural (shumës)</i>
lux	lux
hertz	hertz
siemens	siemens

5.2.3. Nuk ka hapësirë ose vizë ndarëse të përdorur mes parashtesës dhe emrit të njësisë.

5.3 Njësitë e formuara nga shumëzimi dhe pjesëtimi

5.3.1 Me njësitë e emrit:

Produkt, përdorni një hapësirë (e preferuar) ose vizë ndarëse:

- njuton metër ose njuton-metër.

Në rastin e vatit për orë hapësira mund të mos përdoret si më poshtë:

- Vat orë.

Koeficienti, përdorni fjalën “për” dhe jo shenjën slash:

- Metër për sekondë dhe jo metër/sekondë.

Fuqia, përdorni njësitë katrore ose kubikë të vendosura pas emrit të njësisë:

- metër katror për sekondë.



Në rastin e sipërfaqes apo vëllimit, një ndryshues mund të vendoset para emrit të njësisë:

- milimetër katror, metër kub.

Ky përjashtim vlen edhe për njësitë e derivuara duke përdorur sipërfaqen apo vëllimin:

- vat për metër katror.

Shënim. Për të shmangur dykuptimësitë në shprehjet e komplikuara, simbolet janë më të preferuar sesa fjalët.

5.3.2 Simbolet e njësisë

Produkti mund të tregohet në njërën nga mënyrat e mëposhtme:

Nm or $N \cdot m$ për njuton metër.

*Shënim. Kur përdorni për parashtesë një simbol i cili përkon me simbolin e njësisë, kujdes i veçantë duhet të tregohet për të shmangur konfuzionin. Njësia njuton metër për forcë rrotulluese duhet të shkruhet, për shembull, **Nm** ose **$N \cdot m$** për të shmangur konfuzionin me **mNn**, millinjuton.*

Një përjashtim në këtë praktikë është bërë për punën automatike të makinës së shkrimit dhe kompjuterave etj., ku pika në mes nuk është e mundur, por që mund të përdorim një pikë në vijë.

Për herësin (koeficientin) përdorni një nga shenjat e mëposhtme:

m/s ose $m \cdot s^{-1}$ ose $\frac{m}{s}$

Në asnjë rast nuk duhet të përdoret më shumë se një *backslash* në shprehje të njëjta përveç rastit kur janë futur kllapa për të shmangur dykuptimet.

Për shembull, shkruaj:

J/ (mol · K) ose $J \cdot mol^{-1} \cdot K^{-1}$ ose (J/mol)/K

por jo J/mol/K.

5.3.3 Simbolet dhe njësitë e emrave nuk duhet të përzihen në të njëjtën shprehje. Shkruani:

Xhaul për kilogram ose J/kg ose $J \cdot kg^{-1}$

por jo xhaul/kilogram ose xhaul /kg ose *xhaul* kg^{-1} .

5.4 Numrat

5.4.1 Shënuesi (indikatori) i preferuar dhjetor është një pikë në rresht (pikë), megjithatë, presja është, gjithashtu, e pranueshme. Kur shkruani numra më të vegjël se një, një zero duhet të shkruhet para pikës dhjetore.

5.4.2 Presja nuk përdoret për të ndarë shifrat. Në vend të kësaj, shifrat duhet të ndahen në grupe me nga tre, duke llogaritur nga drejtimi i presjes dhjetore nga e majta dhe e djathta, si dhe duke përdorur një hapësirë të vogël për të ndarë grupet. Për shembull:

73 655 7 281 2 .567 321 0.133 47

Hapësira në mes grupeve duhet të jetë përafërsisht sa gjerësia e shkronjës “i” dhe gjerësia e hapësirës duhet të jetë konstante edhe nëse hapësira-variabël e ndarjes është përdorur në mes të fjalëve.

5.4.3 Shenja për shumëzimin e numrave është një kryq (x) ose një pikë në mes. Megjithatë, në qoftë se pika në mes është përdorur si shenjë e shumëzimit, pika në rresht nuk duhet të përdoret si një shënues dhjetor në një shprehje të njëjtë.

5.4.4 Ngjitja e shkronjave në një simbol të njësisë si një mjet për të dhënë informacion në lidhje me natyrën e sasisë së marrë në konsideratë është e pasaktë. Kështu MWe për “megavat elektrike (fuqi)”, Vac për “volt ac” dhe kJt për “kilojoules termik (energi)” nuk janë të pranueshme. Për këtë arsye, nuk duhen bërë përpjekje për të ndërtuar ekuivalentet SI të shkurtesave “psia” dhe “psig”, të përdorura shpesh për të dalluar presionin absolut dhe relativ. Nëse konteksti lë ndonjë dyshim në lidhje me kuptimin, fjala presion duhet të jetë shprehur në mënyrë të përshtatshme. Për shembull:

“...në një presion matës prej 13 kPa”

ose

“... në një presion absolut prej 13 kPa”.



SHTOJCA B FAKTORËT E KONVERTIMIT

1. Të përgjithshme

1.1 Lista e faktorëve konvertues, e cila përfshihet në këtë shtojcë është dhënë për të shprehur përkufizimet e njësive të ndryshme të masës si shumëfisha numerike të njësive SI.

1.2 Faktorët e konvertimit paraqiten për përshtatje ndaj përpunimit kompjuterik dhe transmetimit elektronik të të dhënave. Këto faktorë janë të shkruar si një numër më i madh se 1 dhe më i vogël se 10, me gjashtë ose më pak numra pas presjes dhjetore. Ky numër ndiqet nga shkronja E (për eksponent), një simbol plus ose minus, si dhe dy shifrat të cilat tregojnë fuqinë e 10 nga të cilat numri duhet të shumëzohet për të marrë vlerën e saktë. Për shembull:

$$3.523\,907\,E - 02 \text{ është } 3.523\,907 \times 10^{-2} \text{ ose } 0.035\,239\,07 \\ \text{e ngjashme me} \\ 3.386\,389\,E + 03 \text{ është } 3.386\,389 \times 10^3 \text{ ose } 3\,386.389$$

1.3 Shenja (*) pas numrit të gjashtë të presjes dhjetore tregon se faktori i konvertimit është i saktë dhe se të gjithë numrat që vine mbrapa janë zero. Aty ku tregohen më pak se gjashtë numra pas presjes dhjetore, nuk garantohet më saktësia.

1.4 Shembuj të mëtejshëm i përdorimit të tabelave:

<i>Konvertori nga</i>	<i>në</i>	<i>Shumëzuar me</i>
forca pound per m ²	Pa	4.788 026 E + 01
inç	m	2.540 000*E – 02

Pra:

$$1 \text{ lbf/ft}^2 = 47.880\,26 \text{ Pa}$$

$$1 \text{ inç} = 0.025\,4 \text{ m (ekzaktësisht)}$$

2. Faktorë që nuk janë listuar

2.1 Faktorët e konvertimit për njësitë e përbëra të cilat nuk janë të listuara në këtë dokument mund të zhvillohen lehtësisht nga numrat e dhëna në listë me zëvendësimin e njësive të konvertuara, si më poshtë:

Shembull. Për të gjetur faktorin konvertues të lb · ft/s to kg · m/s:

Fillimisht konvertimi:

$$1 \text{ lb to } 0.453\,592\,4 \text{ kg}$$

$$1 \text{ ft to } 0.304\,8 \text{ m}$$

Më pas zëvendësoni:

$$(0.453\,592\,4 \text{ kg}) \times (0.304\,8 \text{ m})/\text{s}$$

$$= 0.138\,255 \text{ kg} \cdot \text{m}/\text{s}$$

$$\text{Pra faktori është: } 1.382\,55 \text{ E} - 01.$$

**Tabela B-1. Faktorë të konvertuar në njësi SI***(Simbole të njësive SI të dhëna në parantezë)*

<i>Konvertuar nga</i>	<i>në</i>	<i>shumëzuar me</i>
abampere	amper (A)	1.000 000 *E + 01
abcoulomb	coulomb (C)	1.000 000 *E + 01
abfarad	farad (F)	1.000 000 *E + 09
abhenry	henry (H)	1.000 000 *E – 09
abmho	siemens (S)	1.000 000 *E + 09
abohm	ohm (Ω)	1.000 000 *E – 09
abvolt	volt (V)	1.000 000 *E – 08
acre (U.S. survey)	metër katror (m ²)	4.046 873 E + 03
amper orë	coulomb (C)	3.600 000 *E + 03
are	metër katror (m ²)	1.000 000 *E + 02
atmosfera (standard)	paskal (Pa)	1.013 250 *E + 05
atmosfera (teknikisht = 1 kgf/cm ²)	paskal (Pa)	9.806 650 *E + 04
bar	paskal (Pa)	1.000 000 *E + 05
barrel (për petroleum, 42 U.S. i lëngshëm)	metër kub (m ³)	1.589 873 *E – 01
Njësi termike Britanike (Tabelë Ndërkombëtare)	xhaul (J)	1.055 056 E + 03
Njësi termike Britanike	xhaul (J)	1.055 87 E + 03
Njësi termike Britanike (termokimike)	xhaul (J)	1.054 350 E + 03
Njësi termike Britanike (39°F)	xhaul (J)	1.059 67 E + 03
Njësi termike Britanike (59°F)	xhaul (J)	1.054 80 E + 03
Njësi termike Britanike (60°F)	xhaul (J)	1.054 68 E + 03
<i>Konvertuar nga</i>	<i>në</i>	<i>shumëzuar me</i>
Btu (Tabelë Ndërkombëtare) · ft/h · ft ² · °F (k, përcueshmëri termale)	vat per metër kelvin (W/m · K)	1.730 735 E + 00
Btu (termo-kimike) · ft/h · ft ² · °F (k, përcueshmëri termale)	vat per metër kelvin (W/m · K)	1.729 577 E + 00
Btu (Tabelë Ndërkombëtare) · in/h · ft ² · °F (k, përcueshmëri termale)	vat per metër kelvin (W/m · K)	1.442 279 E – 01
Btu (termo-kimike) · in/h · ft ² · °F (k, përcueshmëri termale)	vat per metër kelvin (W/m · K)	1.441 314 E – 01
Btu (Tabelë Ndërkombëtare) · in/s · ft ² · °F (k, përcueshmëri termale)	vat per metër kelvin (W/m · K)	5.192 204 E + 02
Btu (termo-kimike) · in/s · ft ² · °F (k, përcueshmëri termale)	vat per metër kelvin (W/m · K)	5.188 732 E + 02
Btu (Tabelë Ndërkombëtare)/h	vat (W)	2.930 711 E – 01
Btu (termo-kimike)/h	vat (W)	2.928 751 E – 01
Btu (termo-kimike)/min	vat (W)	1.757 250 E + 01
Btu (termo-kimike)/s	vat (W)	1.054 350 E + 03
Btu (Tabelë Ndërkombëtare)/ft ²	xhaul per metër katror (J/m ²)	1.135 653 E + 04
Btu (termo-kimike)/ft ²	xhaul per metër katror (J/m ²)	1.134 893 E + 04
Btu (termo-kimike)/ft ² · h	vat per metër katror (W/m ²)	3.152 481 E + 00
Btu (termo-kimike)/ft ² · min	vat per metër katror (W/m ²)	1.891 489 E + 02
Btu (termo-kimike)/ft ² · s	vat per metër katror (W/m ²)	1.134 893 E + 04
Btu (termo-kimike)/in ² · s	vat per metër katror (W/m ²)	1.634 246 E + 06
Btu (Tabelë Ndërkombëtare)/h · ft ² · °F (C, thermal conductance)	vat per metër katror kelvin (W/m ² · K)	5.678 263 E + 00
Btu (termo-kimike)/h · ft ² · °F (C, thermal conductance)	vat per metër katror kelvin (W/m ² · K)	5.674 466 E + 00
Btu (Tabelë Ndërkombëtare)/s · ft ² · °F	vat per metër katror kelvin (W/m ² · K)	2.044 175 E + 04
Btu (termo-kimike)/s · ft ² · °F	vat per metër katror kelvin (W/m ² · K)	2.042 808 E + 04
Btu (Tabelë Ndërkombëtare)/lb	xhaul per kilogram (J/kg)	2.326 000 *E + 03



Btu (termo-kimike)/lb	xhaul per kilogram (J/kg)	2.324 444 E + 03
Btu (Tabelë Ndërkombëtare)/lb · °F (c, kapacitet ngrohës)	xhaul per kilogram kelvin (J/kg · K)	4.186 800 *E + 03
Btu (termo-kimike)/lb · °F (c, kapacitet ngrohës)	xhaul per kilogram kelvin (J/kg · K)	4.184 000 E + 03
calibre (inç)	metër (m)	2.540 000 *E – 02
kalori (Tabelë Ndërkombëtare)	xhaul (J)	4.186 800 *E + 00
kalori (mean)	xhaul (J)	4.190 02 E + 00
kalori (termo-kimike)	xhaul (J)	4.184 000 *E + 00
kalori (15°C)	xhaul (J)	4.185 80 E + 00
kalori (20°C)	xhaul (J)	4.181 90 E + 00
kalori (kilogram, Tabelë Ndërkombëtare)	xhaul (J)	4.186 800 *E + 03
kalori (kilogram, mean)	xhaul (J)	4.190 02 E + 03
kalori (kilogram, termo-kimike)	xhaul (J)	4.184 000 *E + 03
cal (termo-kimike)/cm2	xhaul per metër katror (J/m2)	4.184 000 *E + 04
cal (Tabelë Ndërkombëtare)/g	xhaul per kilogram (J/kg)	4.186 800 *E + 03
cal (termo-kimike)/g	xhaul per kilogram (J/kg)	4.184 000 *E + 03
cal (Tabelë Ndërkombëtare)/g · °C	xhaul per kilogram kelvin (J/kg · K)	4.186 800 *E + 03
cal (termo-kimike)/g · °C	xhaul per kilogram kelvin (J/kg · K)	4.184 000 *E + 03
cal (termo-kimike)/min	vat (W)	6.973 333 E – 02
cal (termo-kimike)/s	vat (W)	4.184 000 *E + 00
cal (termo-kimike)/cm2 · min	vat per metër katror (W/m2)	6.973 333 E + 02
cal (termo-kimike)/cm2 · s	vat per metër katror (W/m2)	4.184 000 *E + 04
cal (termo-kimike)/cm · s · °C	vat per metër kelvin (W/m · K)	4.184 000 *E + 02

Konvertuar nga	në	shumëzuar me
centimetër merkur(0°C)	paskal (Pa)	1.333 22 E + 03
centimetër uji (4°C)	paskal (Pa)	9.806 38 E + 01
centipoise	paskal sekond (Pa · s)	1.000 000 *E – 03
centistokes	metër katror për sekond (m2/s)	1.000 000 *E – 06
mil rrethor	metër katror (m2)	5.067 075 E – 10
clo	kelvin metër katror për vat (K · m2/W)	2.003 712 E – 01
cup	metër kub (m3)	2.365 882 E – 04
curie	becquerel (Bq)	3.700 000 *E + 10
ditë (mesatarisht diellor)	sekond (s)	8.640 000 E + 04
ditë (gjore ose siderike)	sekond (s)	8.616 409 E + 04
gradë (kënd)	radian (rad)	1.745 329 E – 02
°F · h · ft2/Btu (Tabelë Ndërkombëtare)	kelvin metër katror për vat (K · m2/W)	1.761 102 E – 01
(R, thermal resistance)		
°F · h · ft2/Btu (termo-kimike)	kelvin metër katror për vat (K · m2/W)	1.762 280 E – 01
(R, thermal resistance)		
dyne	njuton (N)	1.000 000 *E – 05
dyne · cm	njuton meter (N · m)	1.000 000 *E – 07
dyne/cm2	paskal (Pa)	1.000 000 *E – 01
elektronvolt	xhaul (J)	1.602 19 E – 19
EMU i kapacitetit	farad (F)	1.000 000 *E + 09
EMU i korentit	amper (A)	1.000 000 *E + 01
EMU i potencialit elektrik	volt (V)	1.000 000 *E – 08
EMU e induktivitetit	henry (H)	1.000 000 *E – 09
EMU i rezistencës	ohm (Ω)	1.000 000 *E – 09
erg	xhaul (J)	1.000 000 *E – 07
erg/cm2 · s	vat per metër katror (W/m2)	1.000 000 *E – 03
erg/s	vat (W)	1.000 000 *E – 07
ESU i vëllimit	farad (F)	1.112 650 E – 12
ESU i korentit	amper (A)	3.335 6 E – 10
ESU i potencialit elektrik	volt (V)	2.997 9 E + 02
ESU e induktivitetit	henry (H)	8.987 554 E + 11
ESU i rezistencës	ohm (Ω)	8.987 554 E + 11
faraday (bazuar në karbon-12)	coulomb (C)	9.648 70 E + 04



faraday (kimik)	coulomb (C)	9.649 57	E + 04
faraday (fizik)	coulomb (C)	9.652 19	E + 04
fathom	metër (m)	1.828 8	E + 00
fermi (femtometër)	metër (m)	1.000 000	*E – 15
fluid onz (U.S.)	metër kub (m ³)	2.957 353	E – 05
foot	metër (m)	3.048 000	*E – 01
foot (U.S. survey)	metër (m)	3.048 006	E – 01
foot i ujit (39.2°F)	paskal (Pa)	2.988 98	E + 03
ft2 katror	metër (m ²)	9.290 304	*E – 02
ft2/h (shpërndarës termik)	metër katror për sekond (m ² /s)	2.580 640	*E – 05
ft2/s	metër katror për sekond (m ² /s)	9.290 304	*E – 02
ft3 (volum; modul seksioni)	metër kub (m ³)	2.831 685	E – 02
ft3/min	metër kub për sekond (m ³ /s)	4.719 474	E – 04
ft3/s	metër kub për sekond (m ³ /s)	2.831 685	E – 02
ft4 (moment seksioni)	metër në fuqi të katërt (m ⁴)	8.630 975	E – 03
ft · lbf	xhaul (J)	1.355 818	E + 00
ft · lbf/h	vat (W)	3.766 161	E – 04
ft · lbf/min	vat (W)	2.259 697	E – 02
ft · lbf/s	vat (W)	1.355 818	E + 00
ft · poundal	xhaul (J)	4.214 011	E – 02

<i>Konvertuar nga</i>	<i>në</i>	<i>shumëzuar me</i>
rënie e lire, standarte (g)	metër për sekond në katror (m/s ²)	9.806 650 *E + 00
ft/h	metër për sekond (m/s)	8.466 667 E – 05
ft/min	metër për sekond (m/s)	5.080 000 *E – 03
ft/s	metër për sekond (m/s)	3.048 000 *E – 01
ft/s ²	metër për sekond në katror (m/s ²)	3.048 000 *E – 01
footcandle	lux (lx)	1.076 391 E + 01
footlambert	kandela për metër katror (cd/m ²)	3.426 259 E + 00
gal	metër për sekond në katror (m/s ²)	1.000 000 *E – 02
gallon (Kanadez i lëngshëm)	metër kub (m ³)	4.546 090 E – 03
gallon (U.K. i lëngshëm)	metër kub (m ³)	4.546 092 E – 03
gallon (U.S. i thatë)	metër kub (m ³)	4.404 884 E – 03
gallon (U.S. i lëngshëm)	metër kub (m ³)	3.785 412 E – 03
gal (U.S. i lëngshëm)/min	metër kub për sekond (m ³ /s)	4.381 264 E – 08
gal (U.S. i lëngshëm)/min	metër kub për sekond (m ³ /s)	6.309 020 E – 05
gal (U.S. i lëngshëm)/hp · h	metër kub për xhaul (m ³ /J)	1.410 089 E – 09
(SFC, konsum specifik i lëndës djegëse)		
gamma	tesla (T)	1.000 000 *E – 09
gauss	tesla (T)	1.000 000 *E – 04
gilbert	amper (A)	7.957 747 E – 01
grad	gradë (angular)	9.000 000 *E – 01
grad	radian (rad)	1.570 796 E – 02
gram	kilogram (kg)	1.000 000 *E – 03
g/cm ³	kilogram për metër kub (kg/m ³)	1.000 000 *E + 03
gram-force/cm ²	paskal (Pa)	9.806 650 *E + 01
hektar	metër katror (m ²)	1.000 000 *E + 04
kuaj fuqi (550 ft · lbf/s)	vat (W)	7.456 999 E + 02
kuaj fuqi (elektrike)	vat (W)	7.460 000 *E + 02
kuaj fuqi (metrik)	vat (W)	7.354 99 E + 02
kuaj fuqi (ujë)	vat (W)	7.460 43 E + 02
kuaj fuqi (U.K.)	vat (W)	7.457 0 E + 02
orë (mesatarisht diellore)	sekond (s)	3.600 000 E + 03
orë (ylore ose siderike)	sekond (s)	3.590 170 E + 03
hundredweight (njësi peshe), gjatë	kilogram (kg)	5.080 235 E + 01
hundredweight (njësi peshe), shkurtër	kilogram (kg)	4.535 924 E + 01
inç	metër (m)	2.540 000 *E – 02
inç i mërkurit (32°F)	paskal (Pa)	3.386 38 E + 03
inç i mërkurit (60°F)	paskal (Pa)	3.376 85 E + 03



inç i ujit (39.2°F)	paskal (Pa)	2.490 82 E + 02
inç i ujit (60°F)	paskal (Pa)	2.488 4 E + 02
in2	metër katror (m2)	6.451 600 *E – 04
in3 (volum; modul seksioni)	metër kub (m3)	1.638 706 E – 05
in3/min	metër kub për sekond (m3/s)	2.731 177 E – 07
in4 (moment seksioni)	metër në fuqi të katërt (m4)	4.162 314 E – 07
in/s	metër per sekond (m/s)	2.540 000 *E – 02
in/s2	metër per sekond në katror (m/s2)	2.540 000 *E – 02
kilokalori (Tabelë Ndërkombëtare)	xhaul (J)	4.186 800 *E + 03
kilokalori (mean)	xhaul (J)	4.190 02 E + 03
kilokalori (termo-kimike)	xhaul (J)	4.184 000 *E + 03
kilokalori (termo-kimike)/min	vat (W)	6.973 333 E + 01
kilokalori (termo-kimike)/s	vat (W)	4.184 000 *E + 03
kilogram-forca (kgf)	njuton (N)	9.806 650 *E + 00
kgf · m	njuton meter (N · m)	9.806 650 *E + 00
kgf · s2/m (mass)	kilogram (kg)	9.806 650 *E + 00

Konvertuar nga	në	shumëzuar me
kgf/cm2	paskal (Pa)	9.806 650 *E + 04
kgf/m2	paskal (Pa)	9.806 650 *E + 00
kgf/mm2	paskal (Pa)	9.806 650 *E + 06
km/h	metër per sekond (m/s)	2.777 778 E – 01
kilopond	njuton (N)	9.806 650 *E + 00
kW · h	xhaul (J)	3.600 000 *E + 06
kip (1 000 lbf)	njuton (N)	4.448 222 E + 03
kip/in2 (ksi)	paskal (Pa)	6.894 757 E + 06
knot (ndërkombëtar)	metër për sekond (m/s)	5.144 444 E – 01
lambert	candela për metër katror (cd/m2)	1/π *E + 04
lambert	candela për metër katror (cd/m2)	3.183 099 E + 03
lkëndy	xhaul per metër katror (J/m2)	4.184 000 *E + 04
lb · ft2 (moment i inercisë)	kilogram metër në katror (kg · m2)	4.214 011 E – 02
lb · in2 (moment i inercisë)	kilogram metër në katror (kg · m2)	2.926 397 E – 04
lb/ft · h	paskal sekond (Pa · s)	4.133 789 E – 04
lb/ft · s	paskal sekond (Pa · s)	1.488 164 E + 00
lb/ft2	kilogram për metër katror (kg/m2)	4.882 428 E + 00
lb/ft3	kilogram për metër kub (kg/m3)	1.601 846 E + 01
lb/gal (U.K. i lëngshëm)	kilogram për metër kub (kg/m3)	9.977 633 E + 01
lb/gal (U.S. i lëngshëm)	kilogram për metër kub (kg/m3)	1.198 264 E + 02
lb/h	kilogram për sekond (kg/s)	1.259 979 E – 04
lb/hp · h	kilogram për xhaul (kg/J)	1.689 659 E – 07
(SFC, konsum specific i lëndës djegëse)		
lb/in3	kilogram për metër kub (kg/m3)	2.767 990 E + 04
lb/min	kilogram për sekond (kg/s)	7.559 873 E – 03
lb/s	kilogram për sekond (kg/s)	4.535 924 E – 01
lb/yd3	kilogram për metër kub (kg/m3)	5.932 764 E – 01
lbf · ft	njuton meter (N · m)	1.355 818 E + 00
lbf · ft/in	njuton metër për metër (N · m/m)	5.337 866 E + 01
lbf · in	njuton metër (N · m)	1.129 848 E – 01
lbf · in/in	njuton metër për metër (N · m/m)	4.448 222 E + 00
lbf · s/ft2	paskal sekond (Pa · s)	4.788 026 E + 01
lbf/ft	njuton për metër (N/m)	1.459 390 E + 01
lbf/ft2	paskal (Pa)	4.788 026 E + 01
lbf/in	njuton për metër (N/m)	1.751 268 E + 02
lbf/in2 (psi)	paskal (Pa)	6.894 757 E + 03
lbf/lb (shtytje/peshë (masë) në përpjestim)	njuton për kilogram (N/kg)	9.806 650 E + 00
vit-dritë	metër (m)	9.460 55 E + 15
lkubik litër	metër (m3)	1.000 000 *E – 03
maxwell	weber (Wb)	1.000 000 *E – 08
mho	siemens (S)	1.000 000 *E + 00
mikroinç	metër (m)	2.540 000 *E – 08



mikron	metër (m)	1.000 000 *E – 06
mil	metër (m)	2.540 000 *E – 05
milje (ndërkombëtare)	metër (m)	1.609 344 *E + 03
milje (sipas statutit)	metër (m)	1.609 3 E + 03
milje (U.S. survey)	metër (m)	1.609 347 E + 03
milje (nautike ndërkombëtare)	metër (m)	1.852 000 *E + 03
milje (U.K. nautike)	metër (m)	1.853 184 *E + 03
milje (U.S. nautike)	metër (m)	1.852 000 *E + 03
mi2 (ndërkombëtare)	metër katror (m2)	2.589 988 E + 06
mi2 (studimi U.S.)	metër katror (m2)	2.589 998 E + 06
mi/h (ndërkombëtare)	metër per sekond (m/s)	4.470 400 *E – 01

<i>Konvertuar nga</i>	<i>në</i>	<i>shumëzuar me</i>
mi/h (ndërkombëtare)	kilometër per orë (km/h)	1.609 344 *E + 00
mi/min (ndërkombëtare)	metër per sekond (m/s)	2.682 240 *E + 01
mi/s (international)	metër per sekond (m/s)	1.609 344 *E + 03
millibar	paskal (Pa)	1.000 000 *E + 02
milimetër mërkuri (0°C)	paskal (Pa)	1.333 22 E + 02
minutë (kënd)	radian (rad)	2.908 882 E – 04
minutë (mesatarisht diellore)	sekond (s)	6.000 000 E + 01
minutë (vjore ose siderike)	sekond (s)	5.983 617 E + 01
muaj (mesatarisht kalendarik)	sekond(s)	2.628 000 E + 06
oersted	amper për metër (A/m)	7.957 747 E + 01
ohm centimetër	ohm metër ($\Omega \cdot m$)	1.000 000 *E – 02
ohm mil-rrethor për ft	ohm millimetër katror për metër ($\Omega \cdot mm^2/m$)	1.662 426 E – 03
ounce (avoirdupois – sistem UK peshash)	kilogram (kg)	2.834 952 E – 02
ounce (troy or apothecary-sistem peshash farmaceutik)	kilogram (kg)	3.110 348 E – 02
ounce (U.K. i lëngshëm)	metër kub (m3)	2.841 307 E – 05
ounce (U.S. i lëngshëm)	metër kub (m3)	2.957 353 E – 05
ounce-force	njuton (N)	2.780 139 E – 01
ozf · in	njuton meter ($N \cdot m$)	7.061 552 E – 03
oz (avoirdupois)/gal (U.K. i lëngshëm)	kilogram për metër kub (kg/m3)	6.236 021 E + 00
oz (avoirdupois)/gal (U.S. i lëngshëm)	kilogram për metër kub (kg/m3)	7.489 152 E + 00
oz (avoirdupois)/in3	kilogram për metër kub (kg/m3)	1.729 994 E + 03
oz (avoirdupois)/ft2	kilogram për metër katror (kg/m2)	3.051 517 E – 01
oz (avoirdupois)/yd2	kilogram për metër katror (kg/m2)	3.390 575 E – 02
parsec	metër (m)	3.085 678 E + 16
pennyweight (system peshimi Britanik)	kilogram (kg)	1.555 174 E – 03
perm (0°C)	kilogram për paskal sekond metër në katror ($kg/Pa \cdot s \cdot m^2$)	5.721 35 E – 11
perm (23°C)	kilogram për paskal sekond metër në katror ($kg/Pa \cdot s \cdot m^2$)	5.745 25 E – 11
perm · in (0°C)	kilogram për paskal sekond metër ($kg/Pa \cdot s \cdot m$)	1.453 22 E – 12
perm · in (23°C)	kilogram për paskal sekond metër ($kg/Pa \cdot s \cdot m$)	1.459 29 E – 12
phot	lumen për metër katror (lm/m2)	1.000 000 *E + 04
pint (U.S. i thatë)	metër kub (m3)	5.506 105 E – 04
pint (U.S. i lëngshëm)	metër kub (m3)	4.731 765 E – 04
poise (viskozitet absolut)	paskal sekond ($Pa \cdot s$)	1.000 000 *E – 01
pound (lb avoirdupois)	kilogram (kg)	4.535 924 E – 01
pound (troy or apothecary)	kilogram (kg)	3.732 417 E – 01
poundal	njuton (N)	1.382 550 E – 01
poundal/ft2	paskal (Pa)	1.488 164 E + 00
poundal · s/ft2	paskal sekond ($Pa \cdot s$)	1.488 164 E + 00
pound-force (lbf)	njuton (N)	4.448 222 E + 00
quart (U.S. i thatë)	metër kub (m3)	1.101 221 E – 03
quart (U.S. i lëngshëm)	metër kub (m3)	9.463 529 E – 04



rad (doza e rrezatimit të përthithur)	gray (Gy)	1.000 000 *E – 02
rem	sievert (Sv)	1.000 000 *E – 02
rhe	1 per paskal sekond (1/Pa · s)	1.000 000 *E + 01
roentgen	coulomb për kilogram (C/kg)	2.58 E – 04
sekond (kënd)	radian (rad)	4.848 137 E – 06
sekond (yjet ose sidereal)	sekond (s)	9.972 696 E – 01

<i>Konvertuar nga</i>	<i>në</i>	<i>shumëzuar me</i>
slug	kilogram (kg)	1.459 390 E + 01
slug/ft · s	paskal sekond (Pa · s)	4.788 026 E + 01
slug/ft ³	kilogram për metër kub (kg/m ³)	5.153 788 E + 02
statamper	amper (A)	3.335 640 E – 10
statcoulomb	coulomb (C)	3.335 640 E – 10
statfarad	farad (F)	1.112 650 E – 12
stathenry	henry (H)	8.987 554 E + 11
statmho	siemens (S)	1.112 650 E – 12
statohm	ohm (Ω)	8.987 554 E + 11
statvolt v	olt (V)	2.997 925 E + 02
stere	metër kub (m ³)	1.000 000 *E + 00
stilb	candela për metër katror (cd/m ²)	1.000 000 *E + 04
stokes (viskozitet kinematik)	metër katror për sekond (m ² /s)	1.000 000 *E – 04
therm	xhaul (J)	1.055 056 E + 08
ton (assay)	kilogram (kg)	2.916 667 E – 02
ton (i gjatë, 2 240 lb)	kilogram (kg)	1.016 047 E + 03
ton (metrik)	kilogram (kg)	1.000 000 *E + 03
ton (nuklear ekuivalent i TNT)	xhaul (J)	4.184 E + 09
ton (ngrirje)	vat (W)	3.516 800 E + 03
ton (regjistër)	metër kub (m ³)	2.831 685 E + 00
ton (i shkurtër, 2 000 lb)	kilogram (kg)	9.071 847 E + 02
ton (i gjatë)/yd ³	kilogram për metër kub (kg/m ³)	1.328 939 E + 03
ton (i shkurtër)/h	kilogram për sekond (kg/s)	2.519 958 E – 01
ton-force (2 000 lbf)	njuton (N)	8.896 444 E + 03
tonne	kilogram (kg)	1.000 000 *E + 03
torr (mm Hg, 0°C)	paskal (Pa)	1.333 22 E + 02
unit pole	weber (Wb)	1.256 637 E – 07
W · h	xhaul (J)	3.600 000 *E + 03
W · s	xhaul (J)	1.000 000 *E + 00
W/cm ²	vat për metër katror (W/m ²)	1.000 000 *E + 04
W/in ²	vat për metër katror (W/m ²)	1.550 003 E + 03
yard	metër (m)	9.144 000 *E – 01
yd ²	metër katror (m ²)	8.361 274 E – 01
yd ³	metër kub (m ³)	7.645 549 E – 01
yd ³ /min	metër kub për sekond (m ³ /s)	1.274 258 E – 02
vit (kalendarik)	sekond (s)	3.153 600 E + 07
vit (yjet ose siderik)	sekond (s)	3.155 815 E + 07
vit (tropikal)	sekond (s)	3.155 693 E + 07
temperaturë Celsius (t°C)	temperaturë Kelvin (tK)	tK = t°C + 273.15
temperaturë Fahrenheit (t°F)	temperaturë Celsius (t°C)	t°C = (t°F – 32)/1.8
temperaturë Fahrenheit (t°F)	temperaturë Kelvin (tK)	tK = (t°F + 459.67)/1.8
temperaturë Kelvin (tK)	temperaturë Celsius (t°C)	t°C = tK – 273.15
temperaturë Rankine (t°R)	temperaturë Kelvin (tK)	tK = t°R/1.8



SHTOJCA C

KOHHA UNIVERSALE E KOORDINUAR

1. Koha e Koordinuar Universale – (UTC) ka zëvendësuar tani “Greenwich Mean Time” (GMT) dhe është pranuar si standard ndërkombëtar për orën. Kjo është baza për matjen e kohës në shumë shtete dhe është, gjithashtu, koha e përdorur në mbarë botën për transmetimet e sinjaleve të orës që përdoren në aviacion. Përdorimi i UTC-së është rekomanduar nga organe të tilla si Konferenca e Përgjithshme e Peshave dhe Matjeve (CGPM), Komiteti Këshillues Ndërkombëtar i Radios (CCIR) dhe Konferenca Botërore e Administrimit të Radios (WARC).

2. Baza për orën UTC është koha e rrotullimit të diellit. Kjo është, e ndryshueshme në varësi, se ku ajo është matur në tokë. Një vlerë mesatare e kësaj kohe, bazuar mbi matjet në një numër vendesh në tokë, është e njohur si “Koha Universale”. Një shkallë e ndryshme kohore, bazuar në përkufizimin e dytë, është e njohur si Koha Ndërkombëtare Atomike (TAI). Një kombinim i këtyre rezultateve na jep Kohën e Koordinuar Universale. Kjo konsiston në rregullimet e nevojshme të sekondave të TAI, për të marrë një kohë sa më të saktë (gjithmonë brenda 0.5 sekondash) për Kohën Universale.

SHTOJCA D

PARAQITJA E DATËS DHE KOHËS NË TË GJITHA FORMAT NUMERIKE

1. Hyrje

Standardet ISO 2014 dhe 3307 specifikojnë procedurat për të shkruar datën dhe kohën në formën gjithënumerike.

2. Paraqitja e datës

Aty ku datat paraqiten në formën gjithënumerike, ISO 2014 specifikon se duhet të përdoret rendi sipas sekuencës vit-muaj-ditë. Elementet e datës duhet të jenë:

- Katër shifra për të paraqitur vitin, me përjashtim që në rastet kur nuk krijohen ngatërresa, shifrat e shekullit mund të hiqen. Përdorimi i shifrave të shekullit është i nevojshëm gjatë periudhës së familjarizimit me formatin e ri për të bërë të qartë, se rendi i ri i elementeve është duke u përdorur;

- dy shifrat e kodit për të paraqitur muajin;

- dy shifrat e kodit për të paraqitur ditën.

Kur është e nevojshme të ndahen elementet për t'i kuptuar më mirë nga ana vizuale, duhet të përdoret vetëm një hapësirë ose një vizë ndarëse. Për shembull, 25 gusht 1983 mund të shkruhet:

19830825 ose 830825,

ose 1983-08-25, ose 83-08-25;

ose 1983 08 25, ose 83 08 25.

Duhet theksuar se sekuenca ISO është e nevojshme vetëm kur ajo ka për qëllim që të përdorë një paraqitje në formën gjithënumerike. Paraqitjet që përdorin një kombinim të numrave dhe fjalëve mund të përdoren ende nëse kërkohet (p.sh. 25 gusht 1983).

3. Paraqitja e kohës

3.1 Kur koha duhet të shkruhet në formën gjithënumerike, ISO 3307 specifikon se duhet përdorur rendi orë-minuta-sekonda.

3.2 Orët duhet të përfaqësohen nga dy numra: nga 00 në 23 në formatin 24-orësh dhe mund të shoqërohen nga presje dhjetore pas orës, minutave dhe sekondave. Kur presjet dhjetore përdoren për kohën, duhet të shoqërohen nga numri i shifrave të nevojshme për të siguruar saktësinë e kërkuar.

3.3 Minutat duhet, gjithashtu, të përfaqësohen nga dy shifra: nga 00 në 59 të shoqëruara me presje dhjetore pas minutës ose sekondës.

3.4 Sekondat, gjithashtu, duhet të përfaqësohen nga dy shifra: nga 00 në 59 dhe të ndiqen nga presja dhjetore pas sekondës nëse është e nevojshme.

3.5 Aty ku është e nevojshme për ta kuptuar më lehtë, duhet të përdoren dy pika për të ndarë orët, minutat dhe sekondat.

Për shembull, 3 orë e 20 minuta dhe 18 sekonda të pasdites mund të shkruhet si:

152018 apo 15:20:18 në orë, minuta dhe sekonda;

ose 1520.3 ose 15:20.3 në orë, minuta dhe presje dhjetore pas minutës;

ose 15.338 në orë dhe presje dhjetore pas orës.

4. Kombinimi i datës dhe kohës në grup

Shpesh lind nevoja për një metodë uniforme për të shkruar datën dhe kohën së bashku, aty kur është e nevojshme. Në raste të tilla, sekuenca e elementeve vit-muaj-ditë-orë-minuta-sekonda duhet të përdoret. Mund të vërehet se jo të gjithë elementet duhet të jenë domosdoshmërisht të përdorshëm në çdo rast – në një përdorim tipik, për shembull, mund të përdorim vetëm elementet ditë-orë-minuta.



URDHËR

Nr. 282, datë 11.11.2024

**PËR DISA SHTESA NË URDHRIN E
MINISTRIT NR. 170, DATË 13.9.2022, “PËR
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR
PËRCAKTIMIN E KËRKESAVE DHE
PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE, QË
LIDHEN ME AERODROMET NË
REPUBLIKËN E SHQIPËRISË”**

Në zbatim të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës; të pikës 10, të nenit 54, të ligjit nr. 96/2020, “Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. Miratimin e disa shtesave në rregulloren “Për përcaktimin e kërkesave dhe procedurave administrative që lidhen me aerodromet në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me urdhrin e ministrit nr. 170, datë 13.9.2022, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij urdhri dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohet Autoriteti i Aviacionit Civil për ndjekjen dhe zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**ZËVENDËSKRYEMINISTËR
DHE MINISTËR I INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGJISË
Belinda Balluku**

Në rregulloren “Për përcaktimin e kërkesave dhe procedurave administrative që lidhen me aerodromet në Republikën e Shqipërisë”, miratuar me urdhrin e ministrit nr. 170, datë 13.9.2022, bëhen shtesat si më poshtë:

1. Në Nenin 2 “Përkufizime”, bëhet shtesat si më poshtë vijon:

“16. Vlera e klasifikimit të avionit (ACR) nënkupton një numër që shpreh efektin relativ të një avioni në sipërfaqe të shtruar për një nënkategori të specifikuar standarde.

Shënim. Numri i klasifikimit të avionit llogaritet në lidhje me pozicionin e qendrës së gravitetit (CG) që jep ngarkesën kritike në rrotat kryesore. Normalisht, pozicioni më i lartë CG i përshatshëm në masën maksimale të platformës (terren) është përdorur për të llogaritur ACN-në. Në raste të veçanta, pozicioni i CG-së përpara duhet të rezultojë në ushtrimin e ngarkesës në rrotën e hundës duke qenë më kritike.

17. Vlera e klasifikimit të fortësisë së sipërfaqes së shtruar (PCR) nënkupton një numër që shpreh kapacitetin e forcës mbajtëse të një sipërfaqeje të shtruar.”

2. Në aneksin IV, pjesa Kërkesat operacionale – Aerodromet (pjesa-ADR.OPS), nënpjesa A – Të dhënat e aerodromit (ADR.OPS.A), pas paragrafit ADR.OPS.A.057 bëhet shtesa si më poshtë vijon:

“ADR OPS.A.058 Fortësia e sipërfaqes së shtruar (e zbatueshme nga data 28 nëntor 2024)

1. Forca mbajtëse e sipërfaqes së shtruar duhet të përcaktohet nga operatori i aerodromit.

2. Forca mbajtëse e sipërfaqes së shtruar të destinuar, për avionët me masë më të madhe se 5 700 kg, duhet të vihet në dispozicion, duke përdorur vlerën e klasifikimit të avionit – vlerën e klasifikimit të sipërfaqes së shtruar (ACR-PCR), duke raportuar të gjithë informacionin e mëposhtëm:

a) vlera e klasifikimit të sipërfaqes së shtruar (PCR) dhe vlera numerike;

b) tipi i sipërfaqes së shtruar për përcaktimin e ACR-PCR;

c) kategoria e forcës së nënshtresave;

d) kategoria maksimale e lejuar e presionit të gomave ose vlera maksimale e lejuar e presionit të gomave; dhe

e) metoda e vlerësimit.

Shënim. Udbëzime për raportimin dhe publikimin e PCR-ve mund të gjenden në Manualin e Projektimit të Aerodromit (dok. 9157).

3. Vlera e klasifikimit të sipërfaqes së shtruar (PCR) duhet të tregojë se një avion me vlerë të klasifikimit të avionit (ACR) të barabartë ose më të ulët se PCR-ja e raportuar mund të operojë në dysHEME, duke iu nënshtruar çdo kufizimi mbi presionin e gomave ose masën totale të avionëve për tip/at e avionit të specifikuar.

Shënim. PCR të ndryshme mund të raportohen nëse forca e sipërfaqes së shtruar është subjekt i një ndryshimi të konsiderueshëm sezonal.

4. ACR-ja e një avioni përcaktohet në përputhje me procedurat standarde të lidhura me metodën ACR-PCR.

Shënim. Procedurat standarde për përcaktimin e ACR-së së një avioni janë dhënë në Manualin e Projektimit të Aerodromit (dok. 9157); pjesa 3. Për lehtësi, software të dedikuar mund të gjenden në website-in e ICAO-s, për llogaritjen e çdo ACR-je avioni në çdo masë në sipërfaqe të shtresës së ngurtë dhe fleksibël për katër kategoritë standarde të forcës së nënshtresës.



5. Për qëllimet e përcaktimit të ACR-së, reagimi i një sipërfaqeje piste duhet të klasifikohet si ekuivalent ndaj një ndërtimi të ngurtë ose fleksibël.

6. Informacioni mbi llojin e sipërfaqes për përcaktimin e ACR-PCR, kategoria e forcës së nënshtresave, kategoria maksimale e lejuar e presionit të gomave dhe metoda e vlerësimit duhet të raportohet duke përdorur kodet e mëposhtme:

a) Tipi i sipërfaqes për përcaktimin e ACR-PCR:

	Kodi
Sipërfaqe e ngurtë	R
Sipërfaqe fleksibël	F

b) Llojet e kategorive sipas fortësisë:

	Kodi
Fortësi e lartë: Karakterizohet nga $E = 200$ MPa dhe përfaqëson të gjitha vlerat E të barabarta ose më të larta se 150 MPa për sipërfaqet e ngurta dhe fleksibël	A
Fortësi mesatare: Karakterizohet nga $E = 120$ MPa dhe përfaqëson një game të të gjitha vlerave E të barabarta ose më të larta se 100 MPa dhe më të ulëta se 150 MPa për sipërfaqet e ngurta dhe fleksibël	B
Fortësi e ulët: Karakterizohet nga $E = 120$ MPa dhe përfaqëson një gamë të të gjitha vlerave E të barabarta ose më të larta se 100 MPa dhe më të ulëta se 150 MPa për sipërfaqet e ngurta dhe fleksibël	C
Fortësi ultra e ulët: Karakterizohet nga $E = 50$ MPa dhe përfaqëson të gjithë vlerat E më të ulëta se 60 MPa për sipërfaqet e ngurta dhe fleksibël	D

c) Kategoria maksimale e lejuar e presionit të gomave:

	Kodi
E pakufizuar: Presion pa kufizim	W
E lartë: Presioni i kufizuar deri në 1.75 MPa	X
Mesatare: Presioni i kufizuar deri në 1.25 MPa	Y
E ulët: Presioni i kufizuar deri në 0.50 MPa	Z

d) Metoda e vlerësimit:

	Kodi
Vlerësimi teknik: përfaqëson një studim specifik të karakteristikave të sipërfaqes dhe tipat e avionëve për të cilët është destinuar të përdoret kjo sipërfaqe	T
Duke përdorur eksperiencën e avionëve: që përfaqëson një njohuri të llojit dhe masës specifike të avionëve që mbahen në mënyrë të kënaqshme në përdorim të rregullt	U

Shënim. Shembujt e mëposhtëm ilustrjnë sesi të dhënat e fortësisë të sipërfaqeve raportohen sipas metodës ACR-PCR. Udhëzime të mëtejshme për këtë temë gjenden në Manualin e Projektimit të Aerodromit (dok. 9157), pjesa 3 – Sipërfaqet.

Shembull 1. Nëse forca mbështetëse e një sipërfaqeje të ngurtë, që mbështetet në një bazë të mesme fortësie, është gjykuar nga vlerësimi teknik për të qenë PCR 760 dhe nuk ka kufizim të presionit të gomave, atëherë informacioni i raportuar do të ishte:

PCR 760 /R/B/W/T

Shembull 2. Nëse forca mbajtëse e një sipërfaqeje të përbërë, që është shtrirë si një dysHEME fleksibël dhe duke u mbështetur në një nënndarje të fortë, është vlerësuar duke përdorur eksperiencën e aeroplanëve për të qenë PCR 550 dhe presioni maksimal i lejuar i gomave është 1.25 MPa, më pas informacioni i raportuar do të jetë:

PCR 550 /F/A/Y/U

Shënim. Material ndërtim i përzjer.

7. Forca mbajtëse e një sipërfaqeje të destinuar për avionët e masës së platformës (VQA) të barabartë me ose më pak se 5 700 kg do të vihen në dispozicion, duke raportuar informacionin e mëposhtëm:

- Masa maksimale e lejuar e avionëve; dhe
- Maksimumi i lejuar i presionit të gomave.

Shembull. 4 800 kg/0.60 MPa.”

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUT

SEKSIONI I TRETË

ÇËSHTJA SHKJEZI KUNDËR
SHQIPËRISË

(Kërkesa nr. 82151/17)

VENDIM

STRASBURG

24 tetor 2024

Ky është vendim përfundimtar, por mund t'i nënshtrohet rishikimit redaktorial.

Në çështjen Shkjezi kundër Shqipërisë,

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur si Komiteti i përbërë nga:

Peeter Roosma, *kryetar,*

Andreas Zünd,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë,*dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendëskancelare në detyrë e Seksionit,*

Pas diskutimit me dyer të mbyllura më 3 tetor 2024,

mori vendimin e mëposhtëm, i cili u miratua po në këtë datë:

PROCEDURA

1. Çështja vjen pas depozitimit në Gjykatë të një kërkesë kundër Shqipërisë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (Konventa), më 27 nëntor 2017.

2. Qeveria Shqiptare (Qeveria) u njoftua për kërkesën.

FAKTET

3. Detajet e kërkesës dhe informacioni në lidhje me kërkesën jepen në tabelën bashkëngjitur.

4. Më 11 mars 2014, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë urdhëroi rikthimin e kërkesës në pozicionin e saj të mëparshëm të punës në Ministrinë e Financave dhe i dha të drejtën të marrë pagat e papaguara (vendimi 2014). Ky vendim mori formë të prerë më 19 maj 2016, kur Gjykata e Lartë e refuzoi ankimitimin e Ministrisë.

5. Pas rikthimit të saj, kërkesja mori pagesën e fundit të pagave të papaguara në qershor 2020.

Kështu procedurat përmbartimore zgjatën pothuajse mbi katër vjet, nga maji 2016 deri në qershor 2020.

6. Më 14 maj 2018, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë urdhëroi Ministrinë e Financave që t'i paguante kërkeses kompensim për mosekzekutimin e plotë të vendimit të vitit 2014.

7. Ministria e ankimoi dhe më 21 shtator 2023, Gjykata Administrative e Apelit Tiranë (vendimi 2023) modifikoi shumën e kompensimit dhe la në fuqi pjesën tjetër të vendimit.

8. Pas ankimit nga Ministria e Financave, më 4 prill 2024, çështja u transferua në Gjykatën e Lartë ku është aktualisht në pritje për rishikim.

LEGJISLACIONI

I. SHKELJA E PRETENDUAR E NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS

9. Kërkesja u ankua për ekzekutimin me vonesë të vendimit 2014. Ajo u mbështet në paragrafin 1, të nenit 6 të Konventës.

10. Qeveria parashtroi që nisur nga vendimi 2023, çështja ishte zgjidhur dhe kërkesa duhej të fshihej nga lista e çështjeve të Gjykatës sipas nenit 37 § 1 (b) të Konventës.

11. Gjykata thekson se ndërsa qeveria u mbështet në vendimin 2023, ajo nuk e pranoi atë dhe e ankimoi përpara Gjykatës së Lartë ku ankimi është akoma në pritje për rishikim. Prandaj, çështja nuk është zgjidhur sepse Gjykata e Lartë mund të pranojë ankimin e qeverisë dhe të vendosë kundër kërkesës. Kështu, rrëzohet kundërshtimi i qeverisë në këtë aspekt. Gjykata nuk harron faktin që çështja, në lidhje me kompensimin për ekzekutimin me vonesë, ka qenë në pritje përpara gjykatave të brendshme për më shumë se gjashtë vjet pa zgjidhje përfundimtare.

12. Në këtë drejtim, Gjykata vlerëson se Gjykata e Lartë do të marrë parasysh gjetjet sipas këtij vendimi për të vendosur për çështjen në pritje përpara saj (krahasoni me *Sharxhi dhe të tjerët kundër Shqipërisë*, nr. 10613/16, § 197, 11 janar 2018, me referenca të mëtejshme).

13. Në lidhje me themelin, Gjykata përsërit që ekzekutimi i një vendimi të dhënë nga një gjykatë duhet të konsiderohet si pjesë e pandarë e “seancës gjyqësore” për qëllime të nenit 6. Gjithashtu, ajo i referohet praktikës gjyqësore në lidhje me mosekzekutimin ose ekzekutimin me vonesë të vendimeve të brendshme të formës së prerë (shihni *Hornsby kundër Greqisë*, nr. 18357/91, 40, *Raporte të Vendimeve* 1997 II).



14. Në çështjet kryesuese *Qufaj Co sh.p.k. kundër Shqipërisë* (nr. 54268/00, §§ 38–45, 18 nëntor 2004) dhe *Gjyli kundër Shqipërisë* (nr. 32907/07, §§ 43–47, 29 shtator 2009), Gjykata tashmë ka gjetur shkelje në lidhje me probleme të ngjashme me problemet e kësaj çështjeje.

15. Për t'ju kthyer fakteve specifike të kësaj çështjeje, Gjykata gjen se autoriteteve ju deshën më shumë se katër vjet për të ekzekutuar vendimin 2014 (shihni paragrafët 5 më sipër) dhe se ato nuk i bënë të gjitha përpjekjet e nevojshme për të ekzekutuar atë vendim në kohën e duhur.

16. Prandaj ankimi është i pranueshëm dhe zbulon shkelje të paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës.

II. ZBATIMI I NENIT 41 TË KONVENTËS

17. Duke pasur parasysh dokumentet që dispononte dhe praktikën e saj gjyqësore (shihni, në veçanti, *Qufaj Co sh.p.k.*, cituar më sipër, §§ 46–48 dhe *Gjyli*, të cituar më sipër, §§ 62–76), Gjykata e konsideron të arsyeshme dhënien e shumës së treguar në tabelën e bashkëngjitur.

PËR KËTO ARSYE, GJYKATA, UNANIMISHT:

1. *Shpall* kërkesën të pranueshme;

2. *Vendos* që kjo kërkesë zbulon shkelje të paragrafit 1, të nenit 6 të Konventës, në lidhje me ekzekutimin me vonesë të vendimit përfundimtar në favor të kërkuases;

3. *Vendos*:

a) që shteti i paditur t'i paguajë kërkuarit, brenda tre muajve, shumën e treguar në tabelën bashkëngjitur, që do të konvertohet në monedhën e shtetit të paditur me normën në fuqi në datën e shlyerjes;

b) që nga mbarimi i afatit tremujor të sipërpërmendur deri në shlyerje të paguhet kamatëvonesë e thjeshtë për shumën e mësipërme, sipas normës së njëjtë me normën marxhinale të kreditimit të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë përqindje.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 24 tetor 2024, sipas Rregullit 77 §§ 2 dhe 3 të Rregullores së Gjykatës.

Viktoriya Maradudina
ZËVENDËSKANCELARE NË
DETYRË

Peeter Roosma
KRYETAR

SHTOJCË

**Kërkesa që paraqet ankimin sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës
(mosekzekutimi ose ekzekutimi me vonesë i vendimeve të brendshme)**

Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkuarit Viti i lindjes	Legjislacioni i brendshëm përkatës	Data e fillimit të periudhës së mosekzekutimit	Data e mbarimit të periudhës së mosekzekutimit Kohëzgjatja e procedurave të ekzekutimit	Dëshmipërblimi i brendshëm	Shuma e dhënë për dëmin jopasuror për kërkuarin (në euro) ⁵
82151/17 27.11.2017	Sonila SHKJEZI 1973	Vendim i datës 11 mars 2014 i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë	19.5.2016	Qershor 2020 4 vjet dhe 11 ditë	Gjykata Administrative e Shkallës së Parë me vendimin nr. 953, datë 11.3.2014, urdhëroi Ministrinë e Financave të rikthejë kërkuarën në pozicionin e saj të mëparshëm (ose të ngjashëm) në shërbimin civil dhe t'i paguajë asaj pagat e papaguara.	2.400

⁵ Plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkuarit.



GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM
Kërkesa nr. 42684/15
Kleoniqi Sovjani
kundër Shqipërisë

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (seksioni i tretë), e mbledhur më 3 tetor 2024 si Komitet i përbërë nga:

Peeter Roosma, *kryetar*,
Andreas Zünd,
Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*,
dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendësancetare në detyrë e Seksionit*,

Duke pasur parasysh kërkesën më sipër të depozituar më 25 gusht 2015,

Duke pasur parasysh deklaratën e paraqitur nga Qeveria e paditur me të cilën i kërkon Gjykatës të cregjistrojë kërkesën nga lista e çështjeve,

Pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

PROCEDURA

1. Çështja e ka origjinën nga një kërkesë kundër Shqipërisë depozituar në Gjykatë sipas nenit 34 të Konventës për Mbrotjtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut (“Konventa”) më 25 gusht 2015 nga një shtetase shqiptare, znj. Kleoniqi Sovjani, e lindur në vitin 1930 dhe me banim në Fort Lee, Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Kërkuesja ndërroi jetë më 25 qershor 2018. Vajza e saj, znj. Elida Minga, shprehu dëshirën për të ndjekur kërkesën në vend të mamasë së saj të ndjerë.

2. Qeveria Shqiptare (“Qeveria”) u njoftua për kërkesën.

FAKTET

3. Në vitin 1995, kërkuesja mori nga qeveria disa të ashtuquajtura “bono privatizimi” d.m.th. instrumente financiare të tregtueshme me vlerë të shprehur në lek (LEK), të cilat mund të përdroreshin për të blerë pronë publike. Data e vlefshmërisë fillestare të tyre më së fundmi është shtyrë deri më 31 dhjetor 2027.

4. Më 14 nëntor 1995, kërkuesja nënshkroi një kontratë shitblerjeje me Agjencinë Kombëtare të Privatizimit (“Agjencia”) për blerjen e një prone publike (“kontrata 1995”). Sipas kontratës, ajo pagoi me para në dorë 870.000 lekë (përafërsisht 4% të çmimit të blerjes) dhe 22.153.520 lekë me bono

privatizimi (pjesa e mbetur prej 96% të çmimit të blerjes).

5. Një palë e tretë e kundërshtoi kontratën në gjykatë. Më 4 nëntor 1998, Gjykata e Apelit Korçë vendosi që kontrata ishte e pavlefshme (“vendimi 1998”), më së shumti sepse Agjencia nuk e kishte marrë parasysh të drejtën e parablerjes së paditësit në lidhje me pronën e shitur. Gjykata urdhëroi që të gjitha palët të kthehen në *status quo ante*. Më 20 korrik 1999, Gjykata e Lartë e refuzoi ankimin e kërkueses dhe në vitin 1998 vendimi u bë përfundimtar.

6. Nisur nga refuzimi i autoriteteve për të kthyer shumën e paguar sipas kontratës 1995, kërkuesi depozitoi një padi kundër pasardhësit të Agjencisë, Drejtorisë së Administrimit të Shitjes së Pronës Publike, për të kërkuar pagesën e shumës ekuivalente të të gjithë çmimit të shitjes në lek.

7. Më 2 qershor 2008, Gjykata e Rrethit Tiranë vendosi pjesërisht në favor të saj, duke urdhëruar të paditurin që t’i kthejë kërkueses shumat në të njëjtën formë që ata kishin paguar në vitin 1995, d.m.th. pjesërisht me para në dorë dhe pjesërisht me bono (“vendimi 2008”). Në mungesë të ankimit, vendimi i mësipërm u bë përfundimtar më 17 qershor 2008.

8. Më 23 dhjetor 2008, Ministria e Financave dhe Ekonomisë i ktheu kërkueses shumën prej 870.000 lekësh.

9. Në lidhje me bonot, më 25 shkurt 2009, Ministria informoi kërkuesen që nuk i kishte në dispozicion këto bono. Ministria u shpreh se priste të mblidhte bono pas privatizimit të disa pronave publike dhe atëherë do t’i transferonte bonot te kërkuesja.

10. Më 16 prill 2010, Gjykata e Rrethit Tiranë nxori një urdhër ekzekutimi në lidhje me vendimin e vitit 2008.

11. Më 16 maj 2014, Ministria informoi përmbaruesin që procesi i privatizimit ishte pezulluar dhe do të rifillonte vetëm pas miratimit të kuadrit të ri ligjor. Deri atëherë, kthimi i bonove ishte i pamundur.

12. Katër ditë më vonë, Ministria e Financave informoi Ministrinë e Drejtësisë që ajo synonte të përmbushte detyrimin e saj ndaj kërkueses; megjithatë kjo ishte e pamundur për shkak të pezullimit të procesit të privatizimit dhe mungesës së kuadrit ligjor që lejonte Ministrinë e Financave të blinte bono privatizimi në tregun privat. Ata, gjithashtu, iu referuan “mungesës së kursit zyrtar të këmbimit” të bonove. Në këto rrethana, Ministria e



Financave i kërkoi Ministrisë së Drejtësisë që të merrte masat e duhura.

13. Kërkuesja u ankua në Gjykatën Kushtetuese për pamundësinë e ekzekutimit të vendimit të vitit 2008. Në mbrojtje të saj, Ministria e Financave përsëriti problemet e lartpërmendura. Më 5 shkurt 2015, Gjykata Kushtetuese gjeti se Ministria e Financave nuk kishte bërë përpjekje të mjaftueshme për të ekzekutuar vendimin e vitit 2008 dhe prandaj ishte shkelur e drejta e kërkueses për proces gjyqësor të drejtë.

LEGJISLACIONI

14. Kërkuesja u ankua sipas neneve 6 dhe 13 të Konventës për mosekzekutimin e vendimit të vitit 2008. Gjykata vlerëson se çështja duhet të shqyrtohet sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës.

15. Gjykata së pari gjen se vajza dhe trashëgimtarja e kërkueses, znj. Elida Minga, ka një interes legjitim për të ndjekur kërkesën në vend të mamasë së saj të ndjerë (shihni *Dalban kundër Rumanisë* [DHM], nr. 28114/95, §§ 1 dhe 39, GJEDNJ 1999 VI, dhe *Ernestina Zullo kundër Italisë* [DHM], nr. 64897/01, § 37, 29 mars 2006).

16. Më tej, Gjykata vëren se, pas negociatave të pasuksesshme për zgjidhje miqësore, më 4 nëntor 2021 Qeveria paraqiti një deklaratë të njëanshme, me qëllim zgjidhjen e çështjeve të ngritura nga ankesa. Më tej, ajo i kërkoi Gjykatës të çregjistronte kërkesën në përputhje me nenin 37 të Konventës.

17. Sipas deklaratës, Qeveria shprehu keqardhje për mosekzekutimin e pjesshëm të vendimit të vitit 2008 dhe mori përsipër që të shtyjë datën e vlefshmërisë së bonove të privatizimit, si edhe të ekzekutojë plotësisht vendimin e vitit 2008. Ajo, gjithashtu, mori përsipër të paguajë 3850 (tre mijë e tetë qind e pesëdhjetë) euro për dëmin jopasuror dhe kosto dhe shpenzime, plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkueses. Këto detyrime do të përmbushen brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës. Shuma do të konvertohet në monedhën e shtetit të paditur, sipas kursit të këmbimit në datën e pagesës. Në rast të mospagimit të shumës së lartpërmendur brenda periudhës tremujore të lartpërmendur, Qeveria merr përsipër të paguajë një interes të thjeshtë nga mbarimi i kësaj periudhe deri në momentin e shlyerjes, me një normë të barabartë me normën e marxhinale të kreditimit të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë përqindjeje.

18. Kërkuesja parashtroi që ajo nuk besonte se Qeveria do të shtynte afatin e vlefshmërisë së bonove. Gjithashtu, ajo parashtroi se momentalisht kishte mundësi shumë të kufizuara për përdorimin e bonove.

19. Gjykata vëren që neni 37§1 (c) mundëson çregjistrimin e një çështjeje nga lista e saj:

“... për çdo arsye tjetër që, sipas Gjykatës, nuk justifikon vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës”.

20. Prandaj, ajo mund të çregjistrojë kërkesën sipas paragrafit 1(c) të nenit 37 bazuar në një deklaratë të njëanshme nga Qeveria e paditur edhe nëse kërkuesi dëshiron vazhdimin e shqyrtimit të çështjes (shihni në veçanti, *Çështja Tahsin Acar kundër Turqisë* (kundërshtime paraprake) [DHM], nr. 26307/95, §§75-77, GJEDNJ 2003-VI).

21. Gjykata ka krijuar praktikë gjyqësore të qartë dhe të zgjeruar në lidhje me ankimet për mosekzekutimin ose ekzekutimin me vonesë të vendimeve të brendshme (shihni, për shembull *Qufaj Co. Sh.p.k. kundër Shqipërisë*, nr. 54268/00, 18 nëntor 2004, dhe *Gjyli kundër Shqipërisë*, nr. 32907/07, 29 shtator 2009).

22. Për t'u kthyer te çështja konkrete, Gjykata thekson se data e vlefshmërisë së bonove të privatizimit është shtyrë tashmë (shihni paragrafin 3 më lart). Në lidhje me parashtrimin e kërkueses që mbeteshin shumë pak mundësi për të përdorur bonot, ky problem nuk ishte pjesë e objektit për të cilin është marrë vendimi i vitit 2008. Prandaj, nuk përbën pjesë të objektit të çështjes përpara Gjykatës.

23. Prandaj, duke pasur parasysh pranimet që përmban deklaratat e Qeverisë, si edhe shumën e propozuar të kompensimit – që është në përputhje me shumat e dhëna në çështje të ngjashme – Gjykata vlerëson që nuk justifikohet më tej vazhdimi i shqyrtimit të kërkesës (neni 37§1(c)).

24. Në përfundim, Gjykata thekson që nëse Qeveria nuk përmbush kushtet e deklaratës së saj të njëanshme, kërkesa mund të futet përsëri në listë në përputhje me paragrafin 2 të nenit 37 të Konventës (shihni *Josipović kundër Serbisë* (vendim), nr. 18369/07, 4 mars 2008).

25. Nisur nga sa më sipër, është me vend që çështja të çregjistrohet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht:

Vendos që vajza dhe trashëgimtarja e znj. Elida Minga legjitimohet për të ndjekur kërkesën në emër të mamasë së saj të ndjerë;



Mban parasysb kushtet e deklaratës së Qeverisë së paditur dhe të rregullimeve për të siguruar përmbushjen e angazhimeve të përmendura në të;

Vendos të çregjistrojë kërkesën nga lista e saj e çështjeve në përputhje me nenin 37§1(c) të Konventës.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 24 tetor 2024.

Viktoriya Maradudina **Peeter Roosma**
ZËVENDËSKANCELARE KRYETAR
NË DETYRË

GJYKATA EVROPIANE E TË DREJTAVE
TË NJERIUT
SEKSIONI I TRETË

VENDIM

Kërkesa nr. 41592/14

Nikoll Dobrozi

kundër Shqipërisë

(shihni tabelën bashkëngjitur)

Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (Seksioni i Tretë), e mbledhur më 3 tetor 2024 si Komitet i përbërë nga:

Peeter Roosma, *kryetar*,

Andreas Zünd,

Oddný Mjöll Arnardóttir, *gjyqtarë*,

dhe Viktoriya Maradudina, *zëvendëskancelare në detyrë e Seksionit*,

Duke pasur parasysb kërkesën më sipër të depozituar më 2 qershor 2014,

Duke pasur parasysb deklaratën e paraqitur nga Qeveria e paditur me të cilën i kërkon Gjykatës të çregjistrojë kërkesën nga lista e çështjeve,

Pas diskutimit, vendosi si më poshtë:

FAKTE DHE PROCEDURA

Detajet e kërkesit jepen në tabelën bashkëngjitur.

Kërkuesi u përfaqësua nga z. M. Pëllumbi, avokat i licencuar në Tiranë.

Ankimet e kërkesit sipas paragrafit 1 të nenit 6 të Konventës në lidhje me tejkalimin e kohëzgjatjes së procesit civil i janë komunikuar qeverisë shqiptare (“Qeveria”).

LEGJISLACIONI

Pas negociimit të pasuksesshëm për zgjidhje miqësore, Qeveria informoi Gjykatën që ajo

propozonte të bënte një deklaratë të njëanshme, me qëllim zgjidhjen e problemeve të ngritura në këtë ankim. Më tej, ajo i kërkoi Gjykatës të çregjistronte kërkesën në përputhje me nenin 37 të Konventës.

Qeveria pranoi tejkalimin e kohëzgjatjes së procesit civil. Ajo u ofrua që t’i paguajë kërkesit shumat e detajuara në tabelën bashkëngjitur dhe ftoi Gjykatën të çregjistrojë kërkesën nga lista e çështjeve, në përputhje me nenin 37 § 1 (c) të Konventës. Shumat e mësipërme duhet të konvertohen në monedhën e Shtetit të paditur me kursin e këmbimit të datës së pagesës dhe duhet të paguhën brenda tre muajve nga data e njoftimit të vendimit të Gjykatës. Në rast të mospagimit të këtyre shumave brenda periudhës tremujore të lartpërmendur, Qeveria merr përsipër të paguajë një kamatëvonesë të thjeshtë nga mbarimi i kësaj periudhe deri në momentin e shlyerjes, me një normë të barabartë me normën e marxhinale të kreditimit të Bankës Qendrore Evropiane gjatë periudhës së mospagimit plus tre pikë përqindjeje.

Pagesa do të përbëjë zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

Kërkuesi nuk u përgjigj.

Gjykata vëren që neni 37§1(c) mundëson çregjistrimin e një çështjeje nga lista e saj:

“... për çdo arsye tjetër që, sipas Gjykatës, nuk justifikon vazhdimin e shqyrtimit të kërkesës”.

Prandaj, ajo mund të çregjistrojë kërkesën sipas nenit 37§1(c) bazuar në një deklaratë të njëanshme nga një Qeveri e paditur edhe nëse kërkesit dëshirojnë vazhdimin e shqyrtimit të çështjes (shihni në veçanti, *Çështja Tahsin Acar kundër Turqisë* vendimi (kundërshtime paraprake) [DHM], nr. 26307/95, §§75-77, GJEDNJ 2003-VI).

Gjykata ka krijuar praktikë gjyqësore të qartë dhe të gjerë në lidhje me ankimet për tejkalimin e kohëzgjatjes së proceseve gjyqësore (shihni për shembull, *Luli dhe të tjerë kundër Shqipërisë*, nr. 64480/09 dhe 5 të tjera, 1 prill 2014 dhe *Mishgjoni kundër Shqipërisë*, nr. 18381/05, 7 dhjetor 2010).

Duke pasur parasysb pranimet që përmban deklarata e Qeverisë, si edhe shumën e propozuar për kompensim – që është në përputhje me shumat e caktuara në çështje të ngjashme – Gjykata vlerëson që nuk justifikohet më tej vazhdimi i shqyrtimit të kërkesës (neni 37§1(c)).

Nisur nga vlerësimet e mësipërme, Gjykata është e bindur që respektimi i të drejtave të njeriut, siç përcaktohet në Konventë dhe Protokollet e saj, nuk



kërkon që ajo të vazhdojë të shqyrtojë kërkesën (neni 37§1 *in fine*).

Në përfundim, Gjykata thekson që, nëse Qeveria nuk përmbush kushtet e deklaratës së saj të njëanshme, kërkesa mund të futet përsëri në listë në përputhje me paragrafin 2 të nenit 37 të Konventës (shihni *Josipović kundër Serbisë* (vendim), nr. 18369/07, 4 mars 2008).

Nisur nga sa më sipër, është me vend që çështja të çregjistrohet nga lista.

Për këto arsye, Gjykata, unanimisht:

Mban parasysb kushtet e deklaratave të Qeverisë së paditur dhe të rregullimeve për të siguruar përmbushjen e angazhimeve të përmendura në to;

Vendos të çregjistrojë kërkesën nga lista e saj e çështjeve në përputhje me nenin 37§1(c) të Konventës.

Bërë në gjuhën angleze dhe njoftuar me shkrim më 24 tetor 2024.

Viktoriya Maradudina
ZËVENDËSKANCELARE
NË DETYRË

Peeter Roosma
KRYETAR

SHTOJCË

KËRKESA QË PARAQET ANKIMIN SIPAS NENIT 6 § 1 TË KONVENTËS (Tejkalimi i kohëzgjatjes së procesit civil)

Kërkesa nr. Data e paraqitjes	Emri i kërkuarit Viti i lindjes	Emri dhe vendndodhja e përfaqësuesit	Data e marrjes së deklaratës së Qeverisë	Shuma e dhënë për dëmin jopasuror (në euro) ⁶	Shuma e dhënë për kosto dhe shpenzime (në euro) ⁷
41592/14 2.6.2014	Nikoll DOBROZI 1961	Mark Pëllumbi Tiranë	24.5.2024	1.200	250

⁶ Plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkuarit.

⁷ Plus çdo taksë që mund t'i ngarkohet kërkuarit.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2024

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 272 lekë

